



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport për Auditimin e ushtruar në subjektin “Bashkia Shkodër”

RAPORTI I AUDITIMIT

Auditim Financiar dhe Përputhshmërie

Tiranë, Prill 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-10
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit....	3-4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	4-7
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	8-10
II.	HYRJA	10-16
1.	Objektivat dhe qëllimi	10-11
2.	Identifikimi i çështjes.....	11-11
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	12-12
4.	Përgjegjësitë e audituesve.....	12-12
5.	Kriteret e vlerësimit.....	13-14
5.	Standardet e auditimit.....	14-14
7.	Metodat e auditimit.....	14-15
8.	Dokumentimi i auditimit.....	15-16
III	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	16-97
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	16-17
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	17-97
2.1	<i>Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.</i>	17-20
2.2	<i>Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.</i>	20-38
2.3	<i>Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.</i>	38-39
2.4	<i>Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.</i>	39-85
2.5	<i>Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.</i>	85-93
2.6	<i>Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV).</i>	93-97
IV	REKOMANDIME	97-108

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit dhe një informacion mbi buxhetin:

Bashkia Shkodër, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të Bashkisë Shkodër për periudhën e aktivitetit 2021-2022, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Në Raportin e Monitorimit për Buxhetin 2022 të datës 28.02.2023, të publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër dhe të dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, janë evidentuar parashikimi sipas PBA 2022 – 2024, buxheti fillestar 2022, buxheti i rishikuar 2022 dhe realizimi i buxhetit 2022. Nga përlllogaritjet e grupit të auditimit, rezulton se mosrealizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 është në vlerën 1,047,700 mijë lekë. Në vetëm 4 Programe Buxhetore rezulton që vlera e parashikuar në PBA 2022-2024 të jetë e njëjtë me vlerën e shpenzimeve parashikuar në buxhetin fillestar 2022. Ndërsa nga krahasimi i buxhetit fillestar dhe atij të rishikuar, rezulton se vetëm 1 Program Buxhetor ka vlerë të njëjtë të parashikimit.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Rëndësia e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të Bashkisë Shkodër për periudhën e aktivitetit 2021-2022, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t'i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionin nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Funkcionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Organizimi dhe vlerësimi i veprimtarisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022,
- Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe - zbatimin e kontratave të punimeve.
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
- Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV)

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

. Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të

auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 31,047 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

- Për vitin 2022, bazuar në të dhënat e sistemit të taksave dhe tarifave vendore, rezultoi se nga vlera e gjobave të vendosura janë arkëtuar 29% e tyre me një nivel të ulët arkëtimi gjë që tregon se nuk janë marrë masa shteruese për arkëtimin e gjobave të papaguara.

- Gjatë vitit 2022, janë kryer likuidime për një vendim gjyqësor për largim të padrejtë nga puna, në vlerën 924,000 lekë si shpenzim për ekzekutim të vendimit gjyqësor dhe 110,880 lekë si tarifë përmbartimore fikse rrjedhojë e vendimeve gjyqësore për largim të padrejtë nga puna, e cila përbën shpenzim pa ekonomikitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona.

- Bashkia Shkodër ka blerë për Drejtorinë Ekonomike të Arsimit një automjet dhe nga krahasimi i të dhënave mbi km e përshkuara dhe konsumin e karburantit nga automjeti i në vitin 2021 dhe 2022 rezultojnë të konsumuara 3 800 litra karburant dhe 18 671 km të përshkuara me një normë mesatare konsumi prej 20.3 litra/100 km ose + 12.5 litra më shumë, me pasojë mungesë efektiviteti në përdorimin e fondeve publike në vlerën gjithsej prej 531,861 lekë.

- Nga auditimi i zbatimit të kontratës me nr.6612/14 prot., datë 28.06.2018, me objekt “Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë Shkodër”, rezultoi se kontraktori “M...” SHPK, ka përfituar padrejtësisht 3,662,140 lekë për shërbime të pakryera.

- Shërbimi përmbartimor nuk ka ekzekutuar asnjë titull ekzekutiv për periudhën 2021 - 2022, dhe strukturat e bashkisë nuk kanë kryer veprime të mëtejshme për të përshpejtuar arkëtimin e gjobave të vendosura, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” i ndryshuar neni 31, pika 5.

- IMTV ka ekzekutuar vetëm 3 vendime për prishjen e objekteve pa leje për periudhën 2021-2022 nga 160 vendime gjithsej me argumentimin e mungesës së makinerive për prishjen e këtyre objekteve, me gjithë kërkesat e vazhdueshme për mjete që i ka bërë IKMT, e cila është shprehur për pamundësinë për të ardhur në ndihmë me mjete.

- IMTV nuk ka kryer kontrole të mjaftueshme mbi zbatimin e punimeve në objektet me leje ndërtimi për të kontrolluar nëse objektet ndërtohen në përputhje me kërkesat e lejeve të ndërtimit e të projektit teknik. Nga 34 leje të miratuara nga DPKZHT në vitin 2021 janë kryer vetëm 7 akt kontrolli dhe 2 raste të evidentuara me gjobë. Në vitin 2022, nga 35 leje të miratuara janë kryer 29 akte kontrolli për leje të lëshuara në këtë periudhë, dhe në 1 objekt janë kryer 2 akt kontrolli brenda vitin 2022.

- Nga shqyrtimi i akteve të kontrollit të miratuara të IMTV nga kryeinspektori për kontrollin e ushtruar në objektet e pajisura me leje ndërtimi, rezultoi se nuk janë kryer akte kontrolli për të gjithë lejet e ndërtimit të miratuar për periudhën 2021-2022. në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” të ndryshuar neni 12, pika 10.

- Në strukturën e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit (IMTV) mungojnë punonjës me arsim të lartë të nevojshëm profesional në fushat e inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, hidrogjeologjisë, në kundërshtim me

përcaktimet e nenit 11 të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës së ndjekur për miratimin e lejeve është konstatuar se nuk është kërkuar mendimi i të gjithë autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve për t’u siguruar se projekti, për të cilin kërkohet pajisja me leje nuk ndërhyt apo pengon zhvillimin, në respektimin e distancave nga linjat e tensionit të lartë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) për 7 raste, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 10/1 të Rregullores - Dokumentacioni për pajisjen me leje zhvillimi.

- Nga auditimi rezultojnë 6 leje ndërtimore me sipërfaqe mbi 2 000 m², për të cilat nga ana e DPKZHT janë pranuar deklarata noteriale, për të kaluar pa shpërblim 3% të sipërfaqes funksionale në favor të banesave sociale, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, i ndryshuar, neni 19, pika 1.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e-leje dhe në databazën e vendosur në dispozicion nga drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit është konstatuar se lejet e ndërtimit të miratuara janë shqyrtuar me afate të tej zgjatuara ditësh pune duke mos respektuar afatin maksimal prej 60 ditësh pune për miratimin e 25 lejeve të ndërtimit, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 44, pika 2 të ligjit nr. 107/2014. “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

- Grupi i auditimit mori në shqyrtim zbatimin e 86 kontratave për objekte civile (infrastrukturë rrugore) të filluara në vitin 2020 dhe të përfunduara në vitin 2021 dhe 2022, nga të cilat 24 kontrata ose 28 % e tyre nuk janë përfunduar në afat, por janë nënshkruar zgjatje të afateve të kontraktimit me marrëveshje midis kontraktorit, mbikëqyrësit dhe investitorit (Bashkia Shkodër).

- Gjatë zbatimit (monitorimit) të kontratës me objekt “Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë Shkodër”, me nr.11392/9 prot., datë 08.11.2021 rezultoi se zyrtarët përgjegjës nuk kanë verifikuar në mënyrë të dokumentuar zbatimin e grafikëve të punimeve mujore për realizimin e proceseve të punës, si dhe nuk kanë raportuar çdo javë tek supervizori, informacion me shkrim, për ecurinë e realizimit të grafikut të punimeve. Njësia e monitorimit të shërbimeve publike/ Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe ndjekjes të investimeve të infrastrukturës nuk ka të dokumentuar grafikun e ndërhyrjeve gjatë gjithë vitit etj., në kundërshtim me Shtojcën 7 - Formulari i termave të referencës, pika 4-Monitorimi dhe raportimi i shërbimit të dokumenteve të tenderit.

- Nga auditimi i procedurave të prokurimit ka rezultuar se janë shfaqur mangësi në hartimin e kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetet teknike, specifikimet teknike, dhe informacionin tjetër specifik i nevojshëm, në argumentimin teknik, të cilat kanë të bëjnë me harmonizimin e specifikimeve teknike të dokumenteve të tenderit dhe disponimit të fuqisë punëtore dhe makineri-pajisjeve nga ana e OE për realizimin e kontratës sipas specifikimeve teknike.

- Nga auditimi i llogarisë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm” të pasqyrave financiare të Bashkisë Shkodër për vitin 2022, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Shkodër për arkëtim ndaj të tretëve, është në vlerën 1,699,833,317 lekë dhe detyrimet mbi 5 vjet, nga viti 2006 deri 2018 janë në vlerën 837,388,471 lekë ose 49.3% të vlerës së debitorëve për vitin 2022 të cilat kanë plotësuar afatin 5 vjeçar të parashkrimit pasi nuk ka ndonjë dokumentacion nga Bashkia mbi fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese si ankimimi i detyrimit tatimor; kontrolli ose hetimi zyrtar nga administrata tatimore ose objekt i një çështjeje penale në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Neni 100 “Parashkrimi i së drejtës për fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese” 1 dhe 2.

- Sipas të dhënave të Drejtorisë së të Ardhurave, referuar planifikimit të të ardhurave, rezultojnë se janë planifikuar të ardhura nga taksa bujqësore në nivelin prej 21,736,120 lekë kur ndërkohë, për totalin e sipërfaqes së tokës bujqësore, do të duhej të ishin planifikuar 24,700,060 lekë. Mangësitë/mungesa e dokumentacionit të pronësisë së tokës bujqësore i ka shkaktuar Bashkisë Shkodër një vlerë të munguar në planifikim prej 2,963,940 mijë lekë.

- Nga krahasimi i vlerave të tavanëve buxhetore të miratuara me VKB nr. 19, datë 25.03.2021 dhe vlerave të parashikuara për vitin 2022 në PBA 2022-2024 miratuar me VKB nr. 3, datë 05.01.2022, rezultojnë diferenca me tavanet në vlerën totale prej 265,205 mijë lekë për 18 Programe buxhetore në kundërshtim me përcaktimet e pikës 126 të Udhëzimit të MF nr. 23, datë 22.01.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; pikën 20 të Udhëzimit nr. 8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”.

Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me procedurat e mbajtjes së sistemit të kontabilitetit:

- Debitorët në vlerën prej 704,798,020 lekë janë për gjoha nga IKMT, policia bashkiake dhe kamatëvonesat ose 41.5 % të totalit viti 2022 të cilat nuk janë paraqitur në llogarinë 709 “Kamatvonesat” në kundërshtim me udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 5, llogaria 709 “kamativonesat” sipas strukturës kamativonesat dallohen më vete për sistemin tatimor dhe më vete për sistemin doganor.

f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Kryetari i Bashkisë Shkodër të marrë masa për (i) hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut ku të identifikohen, analizohen, vlerësohen risqet që mund të ndikojnë në aktivitetin dhe përmbushjen e objektivave të institucionit, (ii) rishikimin periodik dy herë në vit të Regjistrit të Riskut (iii) si dhe të marrë masa për përditësimin e Rregullores së Brendshme, në përputhje me strukturën organizative, duke paraqitur në mënyrë të plotë e të saktë detyrat specifike të punonjësve, duke bërë edhe përditësime të vijueshme në rastet e ndryshimit të strukturës.

- Drejtoria e Analizës dhe e Programimit Buxhetor në bashkëpunim me Ekipet e Menaxhimit të Programeve të marrin masa për planifikimin e shpenzimeve të programeve të PBA brenda tavanëve të miratuara paraprakisht dhe në raste të veçanta të tejkalimit të tyre për shkak të kërkesave buxhetore shtesë që mund të vijnë si rezultat i arsyeve të qenësishme, të analizohet e dokumentohet arsyetimi përkatës.

- Bashkia Shkodër të marrë masa për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura në raportimet periodike në MFE, me qëllim pasqyrimin e saktë të vlerës së detyrimeve të prapambetura.

- Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial të marrin masa për pajisjen me licencën përkatëse të subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e tregimit të naftës në kushtet kur ato plotësojnë specifikimet teknike, dhe mbylljen e aktivitetit në rastet e kundërta, me qëllim ofrimin e sigurisë potenciale për pika të licencuara që përmbushin kriteret e sigurisë për tregtimin e karburanteve.

- Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me drejtoritë e tjera përkatëse në Bashkinë Shkodër dhe me institucione si Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të marrë masa për saktësimin e të dhënave lidhur me sipërfaqet e pronësisë së ndërtesave (objekt banimi dhe të tjera), me qëllim përlllogaritjen e saktë të taksës së ndërtesës që në fazën e planifikimit e më pas të realizimit.

- Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me drejtoritë e tjera përkatëse në Bashkinë Shkodër dhe me institucione si Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të marrë masa për saktësimin e të dhënave lidhur me sipërfaqet e pronësisë së tokës bujqësore dhe pajisjen me certifikatë pronësie të individëve, me qëllim përlllogaritjen e saktë të taksës së tokës bujqësore që në fazën e planifikimit e më pas të realizimit.

- Bashkia Shkodër të iniciojë fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese si ankimimi i detyrimit tatimor; kontrolli ose hetimi zyrtar nga administrata tatimore ose objekt i një çështjeje penale për arkëtimin e detyrimeve që kanë të tretët ndaj Bashkisë dhe për ato detyrime cilat kanë plotësuar afatin 5 vjeçar dhe nuk ka dokumente mbi fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese të konsiderojë procedurat për parashkrimin e së drejtës për fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese.

- Drejtoria e Financës për vitin 2023 të marrin masat për pasqyrimin e kamatvonesave në llogarinë 709 “Kamatvonesat” sipas strukturës më vete për sistemin tatimor dhe më vete për sistemin doganor.
- Bashkia Shkodër të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, dokumentimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave.
- Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, të marrë të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e procedurave të prokurim publik të cilat përkojnë me kohë të përshtatshme me objektin e prokurimit, si dhe të argumentojë teknikisht afatin real të zbatimit të kontratave në procedurën e prokurimit, për të vijuar më pas me dokumentimin e rrethanave objektive dhe të domosdoshme për ndërprerje dhe zgjatje të afatit të zbatimit të kontratave për punime civile, infrastrukturë rrugore.
- Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe nënshkrimin e kontratave përkatëse për të siguruar kalimin pa shpërbllim të 3% të sipërfaqes funksionale në favor të banesave sociale, duke garantuar zbatimin rigoroz të ligjit, në shërbim të zbutjes problemeve sociale të strehimit.
- Bashkia Shkodër, DPKZHT të marrë masat e nevojshme për plotësimin e dosjeve të lejeve me vërtetimin për riskun, si dhe për plotësimin me dokumentacionin studimor me të dhëna inxhiniero-sizmologjike dhe gjeologjike, të mendimeve të të gjithë autoriteteve, si dhe të projektit ndërtimor, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor përkatës.
- Kryetari i Bashkisë Shkodër të marrë masat e nevojshme për plotësimin e strukturës së IMTV me inspektorë me arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e inxhinierisë së ndërtimit, etj., për të rritur cilësinë kontrollit në territor, si dhe për vendosjen e masave administrative në përputhshmëri me vlerën e punimeve të kryera për shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative. Gjithashtu, të merren masat e nevojshme për përgatitjen dhe raportimin e të dhënave statistikore çdo tre muaj mbi aktivitetin e IMTV pranë IKMT.
- IMTV të marrë masa për hartimin e planeve vjetore dhe mujore të punës, si dhe të aplikohen të gjitha masat ndëshkuese ndaj kundërvajtësve, duke ndjekur të gjitha procedurat sipas parashikimeve ligjore për ekzekutimin e vendimeve të marra për prishjen e objekteve pa leje ndërtimi, duke thelluar bashkëpunimin me IMTV.
- Bashkia Shkodër të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës prej **3,662,140 lekë** të përfituar padrejtësisht nga kontraktori “M...” SHPK për shërbime të pakryera gjatë zbatimit të kontratës me nr.6612/14 prot., datë 28.06.2018, me objekt “*Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë Shkodër*”.
- Kryetari i Bashkisë Shkodër të marrë masa për analizimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore, si dhe të shmangë largimet e padrejta nga puna, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.
- Bashkia Shkodër të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve të përfshirë në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim që gjatë vlerësimit të ofertave të mbajnë në konsideratë garantimin e Autoritetit kontraktor në realizimin në afat dhe me cilësi të kontratës.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

Për drejtimin e Bashkisë Shkodër mbi auditimin e pasqyrave financiare:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Shkodër për vitin ushtrimor nga 01.01.2022 – 31.12.2022, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe

shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion:

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare vjetore paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të subjektit Bashkia Shkodër më 31 dhjetor 2022, referuar kuadrit rregullator; Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza për opinionin e pamodifikuar/pakualifikuar për auditimin financiar:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga Subjekti Bashkia Shkodër, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionin e pamodifikuar/pakualifikuar e mbështesim në faktin se; pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet mbi to, janë përfshirë në deklaratat financiare, si dhe nuk përmbajnë gabime materiale.

Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 31,047 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

U konstatuan:

- Debitorët në vlerën prej 704,798,020 lekë janë për gjoba nga IKMT, policia bashkiake dhe kamatëvonesat ose 41.5 % të totalit viti 2022 të cilat nuk janë paraqitur në llogarinë 709 “Kamatvonesat” në kundërshtim me udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 5, llogaria 709 “kamativonesat” sipas strukturës kamativonesat dallohen më vete për sistemin tatimor dhe më vete për sistemin doganor.

Për drejtimin e Bashkisë Shkodër mbi auditimin e përputhshmërisë:

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Bashkia Shkodër për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve, vendimeve rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet: a) auditimit të sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret; b) auditimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik; c) auditimit të integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, d) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’u bërë publike.

Opinion:

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e subjektit Bashkia Shkodër janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar/kualifikuar”, e shprehur kjo në bazën për opinion.

Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë

vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e opinionit të modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë. Nga evidencat e marra për veprimtarinë e Bashkisë Shkodër rezultuan:

- Për vitin 2022, bazuar në të dhënat e sistemit të taksave dhe tarifave vendore, rezulton se nga vlera e gjobave të vendosura janë arkëtuar 29% e tyre me një nivel të ulët arkëtimi.

- Gjatë vitit 2022, janë kryer likuidime për një vendim gjyqësor për largim të padrejtë nga puna, në vlerën 924,000 lekë si shpenzim për ekzekutim të vendimit gjyqësor dhe 110,880 lekë si tarifë përbarimore fikse rrjedhojë e vendimeve gjyqësore për largim të padrejtë nga puna, e cila përbën shpenzim pa ekonomikitet.

- Bashkia Shkodër ka blerë një automjet dhe nga krahasimi i të dhënave mbi km e përshkuara dhe konsumin e karburantit nga automjeti i në vitin 2021 dhe 2022 rezultojnë të konsumuara 3 800 litra karburant dhe 18 671 km të përshkuara me një normë mesatare konsumi prej 20.3 litra/100 km ose + 12.5 litra më shumë, me pasojë mungesë efektiviteti në përdorimin e fondeve publike në vlerën gjithsej prej 531,861 lekë.

- Nga auditimi i zbatimit të kontratës me nr.6612/14 prot., datë 28.06.2018, me objekt “*Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë Shkodër*”, rezultoi se kontraktori “M...” SHPK, ka përfituar padrejtësisht 3,662,140 lekë për shërbime të pakryera.

- Shërbimi përbarimor nuk ka ekzekutuar asnjë titull ekzekutiv për periudhën 2021 - 2022, dhe strukturat e bashkisë nuk kanë kryer veprime të mëtejshme për të përshpejtuar arkëtimin e gjobave të vendosura, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “*Për kundërvajtjet administrative*” i ndryshuar neni 31, pika 5.

- IMTV ka ekzekutuar vetëm 3 vendime për prishjen e objekteve pa leje për periudhën 2021-2022 nga 160 vendime gjithsej.

- IMTV nuk ka kryer kontrole të mjaftueshme mbi zbatimin e punimeve në objektet me leje ndërtimi për të kontrolluar nëse objektet ndërtohen në përputhje me kërkesat e lejeve të ndërtimit e të projektit teknik.

- Nga shqyrtimi i akteve të kontrollit të miratuara të IMTV nga kryeinspektori për kontrollet e ushtruara në objektet e pajisura me leje ndërtimi, rezulton se nuk janë kryer akte kontrolli për të gjithë lejet e ndërtimit të miratuar për periudhën 2021-2022. në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*” të ndryshuar neni 12, pika 10.

- Në strukturën e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit (IMTV) mungojnë punonjës me arsim të lartë të nevojshëm profesional në fushat e inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, hidrogjeologjisë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 11 të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007, “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*” të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës së ndjekur për miratimin e lejeve është konstatuar se nuk është kërkuar mendimi i të gjithë autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve për t’u siguruar, në respektimin e distancave nga linjat e tensionit të lartë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) për 7 raste, në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar.

- Nga auditimi rezultojnë 6 leje ndërtimore me sipërfaqe mbi 2 000 m², për të cilat nga ana e DPKZHT janë pranuar deklarata noteriale, për të kaluar pa shpërblim 3% të sipërfaqes funksionale në favor të banesave sociale, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 22/2018, “*Për strehimin social*”, i ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e-leje dhe në databazën e vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit është konstatuar se 25 lejet e ndërtimit të miratuara janë shqyrtuar me afate të tej zgjatua ditësh pune duke mos respektuar afatin maksimal prej 60 ditësh pune në kundërshtim me përcaktimet e nenit 44, pika 2 të ligjit nr. 107/2014. “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”.

- Grupi i auditimit mori në shqyrtim zbatimin e 86 kontratave për objekte civile (infrastrukturë rrugore) të filluara në vitin 2020 dhe të përfunduara në vitin 2021 dhe 2022, nga të cilat 24 kontrata ose 28 % e tyre nuk janë përfunduar në afat.

- Gjatë zbatimit (monitorimit) të kontratës me objekt “*Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në*

Bashkinë Shkodër”, rezultoi se zyrtarët përgjegjës nuk kanë verifikuar në mënyrë të dokumentuar zbatimin e grafikëve të punimeve mujore për realizimin e proceseve të punës, si dhe nuk kanë raportuar çdo javë tek supervizori, informacion me shkrim, për ecurinë e realizimit të grafikut të punimeve. Njësia e monitorimit të shërbimeve publike nuk ka të dokumentuar grafikun e ndërhyrjeve gjatë gjithë vitit etj.

- Nga auditimi i procedurave të prokurimit janë konstatuar mangësi në hartimin e kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetet teknike, specifikimet teknike, dhe informacionin tjetër specifik i nevojshëm, në argumentimin teknik, të cilat kanë të bëjnë me harmonizimin e specifikimeve teknike të dokumenteve të tenderit dhe disponimit të fuqisë punëtore dhe makineri-pajisjeve nga ana e OE për realizimin e kontratës sipas specifikimeve teknike.

- Nga auditimi i llogarisë nr. 468 “*Debitorë të ndryshëm*” të pasqyrave financiare të Bashkisë Shkodër për vitin 2022, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Shkodër për arkëtim ndaj të tretëve, është në vlerën 1,699,833,317 lekë dhe detyrimet mbi 5 vjet, nga viti 2006 deri 2018 janë në vlerën 837,388,471 lekë ose 49.3% të vlerës së debitorëve për vitin 2022 të cilat kanë plotësuar afatin 5 vjeçar të parashkrimit pasi nuk ka ndonjë dokumentacion nga Bashkia mbi fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese si ankimi i detyrimit tatimor; kontrolli ose hetimi zyrtar nga administrata tatimore ose objekt i një çështjeje penale në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, Neni 100 “*Parashkrimi i së drejtës për fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese*” 1 dhe 2.

- Sipas të dhënave të Drejtorisë së të Ardhurave, referuar planifikimit të të ardhurave, rezulton se janë planifikuar të ardhura nga taksa bujqësore në nivelin prej 21,736,120 lekë kur ndërkohë, për totalin e sipërfaqes së tokës bujqësore, do të duhej të ishin planifikuar 24,700,060 lekë duke i shkaktuar Bashkisë Shkodër një vlerë të munguar në planifikim prej 2,963,940 mijë lekë.

- Nga krahasimi i vlerave të tavanave buxhetore të miratuara me VKB nr. 19, datë 25.03.2021 dhe vlerave të parashikuara për vitin 2022 në PBA 2022-2024 miratuar me VKB nr. 3, datë 05.01.2022, rezultojnë diferenca me tavanet në vlerën totale prej 265,205 mijë lekë për 18 Programe buxhetore në kundërshtim me përcaktimet e pikës 126 të Udhëzimit të MF nr. 23, datë 22.01.2016 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*”; pikën 20 të Udhëzimit nr. 8, datë 26.02.2021 “*Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024*”.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH*”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 973/1prot., datë 02.11.2023 “*Auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Shkodër*”, ndryshuar me shkresën nr. 973/2, datë 13.12.2023 “*Njoftim për ndryshim në programin e auditimit*”, të miratuara nga Kryetari i KLSH, nga data 06.11.2023 - 29.01.2024, në subjektin Bashkia Shkodër për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2022 - 31.12.2022, u krye “*Auditim Financiar dhe Përputhshmërie*” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. G. P., *Drejtor i Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, Përgjegjës Grupi,*
2. B. Z., *Drejtor i Departamentit të Shqyrtimit, Mbikëqyrjes dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit dhe Zbatimit të Standardeve,*
3. Xh. N., *Audituese,*
4. B. H., *Audituese.*

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

Objekti dhe qëllimi i auditimit: Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2022, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Shkodër.

Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 *“Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi”*, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Shkodër, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Shkodër.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Kryetari i Bashkisë Shkodër (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Shkodër, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës

për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.¹

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Shkodër dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar je me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kutueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Shkodër është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticismin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

Kriteret e vlerësimit. Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- *Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit:* Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015,

¹ Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, neni 15

datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues”; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; Ligji nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2021”, pikat 88-125; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2022”, pikat 95-122; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

- Në fushën e mbajtjes së Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” .

- Në fushën e prokurimeve publike: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 162/202, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzim i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar; Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me

ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Në fushën e ndërtimit, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit: Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”; Ligji Nr. 107-2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve të ndërtimit”; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, e përditësuar”; VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”; Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

Standardet e auditimit. ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

Metodat e auditimit. Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periodhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*². Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

² *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të perdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

Dokumentimi i auditimit. Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reflektimit të observacioneve të subjektit nën auditim të akt-

konstatimeve, u përgatit Projektrporti i Auditimi i cili u dërgua në subjekt me shkresën nr. 973/5, datë 08.03.2024. Nga ana e Bashkisë Shkodër me shkresën nr. 973/6, datë 09.04.2024 është dërguar konfirmimi i marrjes së projektrportit dhe observacionet përkatëse. Në përfundim nga audituesit u përgatit Raporti i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm. Zanafilla Institucionale e Bashkisë në Shkodër nis në vitin 1865 dhe deri në ditët e sotme ka pësuar ndryshime të konsiderueshme strukturore, të emërtimeve, vend-ndodhjes kompetencave etj.

Bashkia Shkodër shtrihet në Veriperëndim të Shqipërisë, në një territor prej 873 km² dhe kufizohet në veri me Bashkinë e Malësisë së Madhe, në perëndim me Malin e Zi, në lindje me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Vau i Dejës dhe me Bashkinë Lezhë.

Bashkia e Shkodrës është pjesë e Qarkut Shkodër dhe përbëhet nga 11 njësi të qeverisjes vendore, (Shkodër, Rrethina Shalë, Shosh Pult, Postrinë, Guri i Zi, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, dhe Velipojë). Në përbërjen e tyre këto njësi administrative përfshijnë gjithsej një qytet dhe 93 fshatra.

Me reformën e re territoriale, popullsia e Bashkisë së Shkodrës është dyfishuar. Aktualisht kjo bashki ka 65 117 familje dhe një popullsi prej 208 618 banorë. Përqendrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodrës me 55% të popullsisë (115 215 banorë), ndërsa për sa i përket njësiteve administrative, njësia me popullsi më të madhe është ajo e Rrethinave me 26 039 banorë.

Me ndarjen e re territoriale dhe administrative ka një pozicion të tillë që mbulon zonën detare dhe bujqësore në jug të saj, gjithashtu edhe zonën më malore të Shqipërisë në veri. Në pjesën perëndimore kufizohet nga Liqeni i Shkodrës, i cili ka një rëndësi mjaft të madhe kombëtare dhe ndërkufitare në marrëdhënie me Malin e Zi. Parë pikërisht nga marrëdhëniet ndërkufitare, pozicioni i favorshëm gjeografik, mundëson lidhjet si territoriale, po ashtu edhe ekonomike dhe natyrore të Shkodrës me Malin e Zi dhe Kosovën duke e kthyer kështu në një pozicion mjaft të favorshëm strategjik për gjithë rajonin.

Bashkia Shkodër ka një sipërfaqe të konsiderueshme të tokave bujqësore me një cilësi boniteti të lartë. Tokat bujqësore të kategorisë I-IV janë të shtrira në njësitë administrative Shkodër, Velipojë, Dajçi, Bërdicë, Ana e Malit dhe Gurë i Zi. Njësitë e tjera administrative kanë një bonitet më të ulët si rrjedhojë e relievit të thyer dhe përbërjes gjeologjike të tokës.

Me zbatimin e reformës së re administrative territoriale, pyjet dhe kullotat iu transferuan Bashkisë së Shkodrës. Në këtë sipërfaqe gjenden të gjitha kategoritë e pyllit si: pyll i rrallë, pyll i dendur, shkurre të rralla, shkurre të dendura dhe livadhe e kullota natyrore. Ndërkohë në lidhje me prodhimin, mund të thuhet se në Shkodër ka një larmishmëri kulturash bujqësore të cilat prodhojnë në periudha të ndryshme kohore.

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

- a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
- b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
- ç) ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
- dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;

e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Bashkia Shkodër, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të Bashkisë Shkodër për periudhën e aktivitetit 2021-2022, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- VKB nr. 1, datë 05.01.2022 “Për miratimin e strukturës të nëpunësve dhe punonjësve të administratës dhe të institucioneve në varësi të Bashkisë Shkodër”;
- Rregullore e Brendshme e Bashkisë Shkodër, e përditësuar me Vendimin nr. 341, datë 09.07.2021, “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit”;
- Regjistri i Riskut 2022;
- Raporti Vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Dokumentacion mbi politikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Regjistrat e Riskut;
- Raportet vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Shkresat mbi ndarjen dhe delegimin e kompetencave;
- Urdhrat e krijimit të Grupit të Menaxhimit Strategjik;
- Dokumentacion mbi mbledhjet e GMS.

Nga auditimi i komponentëve të sistemit të MFK ka rezultuar:

1. Mjedisi i Kontrollit.

Sa i përket rregullores së brendshme të institucionit konstatohet se gjatë vitit 2022 Bashkia Shkodër ka funksionuar përmes rregullores së miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 96, datë 20.03.2017, “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës të Bashkisë Shkodër” dhe është përditësuar me Vendimin nr. 341, datë 09.07.2021, “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit”, por jo për ndryshimet e tjera të strukturës organizative gjatë vitit.

Nga auditimi konstatohen raste të mangësive apo mbivendosjes së detyrave përkatëse sipas pozicioneve të punës në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Shkodër si:

- Në strukturën organizative të miratuar me VKB nr. 1, datë 05.01.2022, në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit është përcaktuar pozicioni i punës “Ndihmës inspektor”, në pikën 39.7 të Rregullores së Brendshme, të ndryshuar, është parashikuar si pozicion pune, por nuk janë përcaktuar detyrat/përgjegjësitë për këtë pozicion;
- Në strukturën organizative Drejtoria e të Ardhurave ka në varësi të saj Njësinë e Inspektimit Tatimor dhe Kundërvajtjeve Administrative, ndërsa në Rregulloren e Brendshme nuk paraqiten detyra për specialistin dhe inspektorët e kësaj njësie, por paraqiten detyra/përgjegjësi për Përgjegjës/specialistin/inspektorin e Sektorit të Kontrollit, Verifikimit dhe Masave Shtrengues (sektor i cili nuk ekziston në strukturën organizative).

- Në germën c, pika 35.9 “*Detyrat/përgjegjësitë e specialistit të sektorit të burimeve njerëzore*” përcaktohet si detyrë “*asistencë ligjore në çështje të ndryshme të drejtorisë*”, detyrë e cila i takon Drejtorisë dhe Sektorit Juridik. E njëjta situatë paraqitet në germën c, pika 35.10.

- Në germën q, pika 35.6 “*Detyrat/përgjegjësitë e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore*” përcaktohet detyra e “*të administrojë dhe mirëmbajë arkivin e Bashkisë dhe të marrë masa në varësi të Ligjit për Arkivat për sistemimin e vlerave arkivore dhe dorëzimin e tij sipas afateve në Arkivin e Shtetit*”. Kjo detyrë i takon arkivistit dhe jo Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

- Me krijimin e Drejtorisë së Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të ZIN, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit (e cila ishte më parë në nivel sektori) nuk rezultojnë të jetë përditësuar Rregullorja e Brendshme për të pasqyruar ndryshimin përkatës.

Gjithashtu, referuar veprimtarisë së GMS, në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisioneve e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

2. Menaxhimi i riskut. Nga auditimi konstatohet se Bashkia Shkodër nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut dhe rezultojnë se nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit (afat 5 vjeçar), sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr. 68/2017 “*Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*”. Për vitin 2022, rezultojnë se është krijuar Regjistri i Riskut, por nuk janë përcaktuar qartë proceset e punës apo mënyra e analizimit të riskut ku mbi bazën e proceseve të punës të analizohet risku si dhe të përcaktohen hapat konkret në eliminimin e plotë të tij, apo të jetë përditësuar 2 herë në vit, referuar Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 “*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK- së dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*”. Në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar, neni 11 “*Përgjegjësia menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë*”, pika 2, citon se “*Menaxherët e tjerë të strukturave të të gjitha niveleve të njësisë publike janë përgjegjës dhe raportojnë dhe i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, për identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arrijtjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë*”. Në bazë të pikës nr. 1, neni 10, i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, NA është edhe koordinatori i riskut. Konstatohet se nuk janë dokumentuar takimet periodike (1 herë në dy muaj) të Koordinatorit të Riskut me drejtorët e drejtorive përkatëse të institucionit.

Në Bashkinë Shkodër nuk është caktuar një bilbilfryrës lidhur me riskun e mashtrimit, si dhe nuk janë përcaktuar sisteme raportimi në lidhje me shkeljet e rregullave në fuqi. Për më tepër, në Bashkinë Shkodër konstatohet mungesë e rregullave të shkruara në lidhje me procedurën që ndiqet për lëvizjet e stafit dhe mungesa e pasqyrimin të këtyre ndryshimeve si risqe në regjistrin e riskut të institucionit. Ndryshimet e shpeshta të drejtuesve apo punonjësve përkatës mund të ndikojnë potencialisht në luhajtje të kulturës dhe filozofisë së njësisë apo bashkëpunimit ndërmjet njësive, sidomos sa i përket menaxhimit të procedurave të caktuara, duke shtuar risqet me të cilat përballen njësia. Kjo përforcuar edhe nga të dhënat e vitit 2022 ku rezultojnë 61 emërimet të reja dhe 35 largimet të punonjësve.

Nga auditimi konstatohen raste të mangësive apo mbivendosjes së detyrave përkatëse sipas pozicioneve të punës në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Shkodër si: në pikën 39.7 të Rregullores së Brendshme, të ndryshuar, është parashikuar si pozicioni pune “*Ndihmës inspektor*” në IMT, por nuk janë përcaktuar detyrat/përgjegjësitë për këtë pozicion; nuk paraqiten detyrat për specialistin dhe inspektorët e Njësive të Inspektimit Tatimor dhe Kundërvajtjeve Administrative, por paraqiten detyrat/përgjegjësi për Përgjegjës/ specialistin/ inspektorin e Sektorit të Kontrollit, Verifikimit dhe Masave Shtrenguese. (*sektor i cili nuk ekziston në strukturën organizative*).

Me krijimin e Drejtorisë së Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të ZIN, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit (e cila ishte më parë në nivel sektori) nuk rezultojnë të jetë përditësuar Rregullorja e Brendshme për të pasqyruar ndryshimin përkatës. Gjithashtu, referuar veprimtarisë së GMS, në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisioneve e përhershme, të përkohshme dhe

strukturat konsultative të Bashkisë. Referuar nenit 20 të Ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, *Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit, ku përfshihet edhe struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrës, hierarkisë dhe rregullave të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.*

3. Aktivitetet e kontrollit. Në Manualin e MFK, aktivitetet e kontrollit përcaktohen si rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Shkodër, në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar përgjithësisht edhe proceset e punës.

Vlen të theksohet se Institucionet e varësisë të Bashkisë Shkodër dhe shoqëritë aksionere, nuk kanë ngritur GMS apo të kenë zhvilluar takime e të kenë diskutuar në lidhje me sistemin e kontrollit të brendshëm financiar publik duke i dokumentuar këto takime me proces verbale.

Lidhur me kontrollin e sistemeve informatike dhe teknologjike, Bashkia Shkodër bazohet në rregullat e përgjithshme të përcaktuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit por nuk ka procedura të brendshme specifike për politikën mbi sigurinë kibernetike dhe të dhënave.

Sa i takon kontrollin të Pasqyrave Financiare dhe kontabilitetit, rezulton se nuk kryhen auditime mbi këtë fushë, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, përveç auditimit të jashtëm të kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, i cili jep opinionin mbi besueshmërinë dhe paraqitjen në mënyrë të drejtë të pozitës financiare përmes pasqyrave financiare të vitit.

4. Monitorimi. Konstatohet se nuk ka monitorim mbi mangësitë që mund të shfaqë sistemi i kontrollit të brendshëm të Bashkisë, ndaj nuk ka plan menaxhimi për veprimet korrigjuese në raste të mangësive. Për më tepër, nga shoqëritë e përbashkëta ku bashkia është aksionere dhe nga ndërmarrjet në varësi të saj, Bashkia merr raportime në lidhje me vendimmarrjet e këshillave drejtues, por jo raportime periodike nga ana e këtyre shoqërive/ndërmarrjeve në varësi për performancën e veprimtarisë apo risqeve kryesore që lidhen me përmbushjen e objektivave.

Organizimi dhe vlerësimi i veprimtarisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm.

Lidhur me organizimin dhe veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Shkodër është shqyrtuar dokumentacioni i mëposhtëm:

- Plani Strategjik 2022-2024 dhe Plani Vjetor 2022 (së bashku me pasqyrat përkatëse pjesë integrale të Planit) i Njësisë së Auditit;
- Ndryshimi i Planit Vjetor 2022;
- Raporti Vjetor 2022;
- Karta e Auditimit;
- Të dhëna mbi punonjësit e Njësisë së Auditit;
- Dosje auditimi të Njësisë së Auditit në Bashkinë Shkodër.

Organizimi i Njësisë së Auditit është në nivel sektori dhe në varësi direkte nga Kryetari i Bashkisë Shkodër. Njësia e Auditit në Bashkinë Shkodër është autoriteti ligjor i krijuar sipas ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe VKM-së nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të AB në sektorin publik”, i ndryshuar. Referuar Vendimit nr. 1, datë 05.01.2022 të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, “Për miratimin e strukturës së nëpunësve dhe punonjësve të administratës dhe institucioneve të Bashkisë Shkodër”, struktura e Njësisë së Auditit (NJAB) përbëhet nga 3 (tre) punonjës: 1 (një) Përgjegjës Sektori dhe 2 (dy) specialistë. Për vitin 2022, kjo njësi rezulton me vende të plotësuara dhe nuk ka patur vakanca.

Realizimi i Planit Vjetor 2022.

Rezultoni se nga plani i vitit 2022, janë përfunduar 6 auditime dhe 2 auditime të tjera (Drejtoria e të Ardhurave dhe Ujësjellës Kanalizime sha) kanë qenë në proces në fund të vitit 2022, pra plani është realizuar në masën 75%.

Gjetje dhe rekomandimet e auditimeve të NJAB për vitin 2022.

Në kuadër të auditimeve të kryera përgjatë vitit 2022, NJA ka evidentuar gjetjet ku ndër të tjera Rezulton se për auditimin “*Detyrimet e prapambetura*” nuk janë pasqyruar gjetjet në pasqyrën përkatëse të Raportit Vjetor. Për vitin 2022, NJAB nuk ka dërguar asnjë çështje për investigim të mëtejshëm.

Rekomandimet e lëna nga DA dhe zbatimi i tyre nga subjektet e audituara

Gjatë muajit mars 2023, nga NJAB është realizuar auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve sipas programit me shkresën nr. 3579, datë 13.03.2023, ku ndërkohë, nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve, rezulton se gjatë vitit 2022 janë lënë rekomandime sipas prioritetit:

- 26 rekomandime për përmirësimin e sistemeve, ku 8 janë të pazbatuara;
- 9 rekomandime për përmirësimet të kuadrit ligjor, ku 1 është i pazbatuar;
- 24 rekomandime të karakterit organizativ, ku 5 janë të pazbatuara;
- 18 rekomandime të tjera, ku 4 janë të pazbatuara.

Përqindja më e lartë e pazbatueshmërisë së rekomandimeve paraqitet për rekomandimet mbi përmirësimin e sistemeve. Sa i takon riskut të tyre, nga 77 rekomandimet e lëna, 51 prej tyre janë konsideruar me risk të lartë, 23 me risk të mesëm dhe 3 me risk të ulët.

Lidhur me Planet e Veprimit të subjekteve të audituara, rezulton se “Sport Klub Vllaznia” dhe “Drejtoria Ekonomike e Arsimit” nuk i kanë përpiluar këto plane, ndërkohë subjektet e tjera referuar të dhënave të NJAB kanë hartuar planet e veprimit.

Shqyrtimi i dosjeve fizike të auditimit. Grupi i auditimit ka përzgjedhur disa prej dosjeve të auditimeve të zhvilluara nga NJAB përgjatë vitit 2022 me qëllim shqyrtimin e mëtejshëm të tyre, ku rezulton se reagimi i subjekteve të audituara lidhur me përvojën gjatë kryerjes së auditimit paraqet mangësi, duke mos u plotësuar nga të gjithë subjektet e audituara.

2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

Lidhur me planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit, çeljen e fondeve në fillim të vitit, kontrollit të realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura, saktësisë së realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit, vlerësimin e risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve si dhe çeljen dhe ekzekutimin e fondeve të përfituara përmes FZHR, është shqyrtuar dokumentacioni si në vijim:

- Dokumentacioni i hartimit të PBA 2022-2024, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministrinë e Linjës;
- Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;
- Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit për shpenzimet dhe të ardhurat;
- Dokumentacioni mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative;
- Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve;
- Dokumentacioni mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe saktësia e pasqyrit të ndryshimeve në shtesa dhe pakësim me planin përfundimtar;
- Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;
- Dokumente të tjera mbështetëse (baza të ndryshme të dhënash në programin “Excel”, si: për vendimet gjyqësore, për investimet, shpenzimet, të ardhurat, etj).

1.Programimi i PBA 2022-2024 dhe programimi i buxhetit vjetor 2022

Sa i takon procedurave të përgatitjes së PBA 2022-2024, rezulton se janë realizuar fazat e përgatitjes duke filluar me ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik me Urdhër nr. 23 datë 11.01.2021 të Kryetarit të Bashkisë Shkodër (Titullari i institucionit), si dhe me organizimin e mbledhjes së GMS, për secilën prej PBA-ve, për të përcaktuar tavanet e shpenzimeve sipas programeve përkatëse.

Sa i takon çështjeve kryesore për projektet dhe politikat e Bashkisë Shkodër në PBA, rezulton se koncepti kryesor është skenari policentrik i zhvillimit të territorit të kësaj Bashkie, i cili paraqitet si koncept në dy nivele, si në nivelin Bashkiak, ku për qëllime të kohezionit territorial kërkohen disa qendërsi të reja në ofrimin e shërbimeve bazë (shkollë, qendër shëndetësore, postë), ashtu dhe në nivel qyteti, ku shërbimet dhe aktivitetet duhet të shpërndahen më shumë në territor.

Nga auditimi konstatohet se përmes VKB nr. 19, datë 25.03.2021 janë përcaktuar tavanet e programeve buxhetore për PBA 2022-2024. Tavanet buxhetore paraprake të miratuara përmes VKB nr. 19, datë 25.03.2021 janë përcaktuar si tavane përfundimtare për përgatitjen e PBA 2022-2024 në mbledhjen e GMS më datë 16.07.2021, referuar shkresës nr. 12494 Prot., datë 19.07.2021 të Bashkisë Shkodër drejtuar Këshillit Bashkiak. Në Relacionin e PBA të 2022-2024 të përgatitur nga Bashkia Shkodër dhe të publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë, paraqiten të dhënat për vlerat e parashikuara për planin e vitit 2022 për secilin prej programeve ekonomike të përmendur. Nga krahasimi i vlerave të tavaneve buxhetore të miratuara me VKB nr. 19, datë 25.03.2021 dhe vlerave të parashikuara për vitin 2022 në PBA 2022-2024 miratuar me VKB nr. 3, datë 05.01.2022, rezultojnë diferenca me tavanet në vlerën totale prej 265,205 mijë lekë për 18 Programe buxhetore. Referuar pikës 126 të Udhëzimit të MF nr. 23, datë 22.01.2016 *“Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”*, përcaktohet se *“Tavanet përgatitore të programit buxhetor afatmesëm për njësitë e qeverisjes vendore për çdo program, miratohen nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe kërkesat buxhetore duhet të jenë detyrimit brenda këtyre tavaneve”*.

Pika 20 e Udhëzimit nr. 8, datë 26.02.2021 *“Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”*, përcakton se lidhur me tavanet e përgatitjes së PBA vendore *“Një tavan është kufiri i sipërm i shumës totale të parave që mund të shpenzohen ose të planifikohen për t’u shpenzuar për një qëllim të caktuar”*.

Duhet theksuar se, planifikimi i shpenzimeve të programeve buxhetore në tejkalim të tavaneve e bën procesin të mos jetë në përputhje me kriteret e vendosura, i konsideruar si shkak i mosrespektimit të udhëzimeve/VKB përkatëse për përgatitjen e PBA.

Në Raportin e Monitorimit për Buxhetin 2022 të datës 28.02.2023, të publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër dhe të dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, janë evidentuar parashikimi sipas PBA 2022 – 2024, buxheti fillestar 2022, buxheti i rishikuar 2022 dhe realizimi i buxhetit 2022. Nga përlllogaritjet e grupit të auditimit, rezulton se mosrealizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 është në vlerën 1,047,700 mijë lekë. Në vetëm 4 Programe Buxhetore rezulton që vlera e parashikuar në PBA 2022-2024 të jetë e njëjtë me vlerën e shpenzimeve parashikuar në buxhetin fillestar 2022. Ndërsa nga krahasimi i buxhetit fillestar dhe atij të rishikuar, rezulton se vetëm 1 Program Buxhetor ka vlerë të njëjtë të parashikimit. Të gjitha programet e tjera buxhetore rezultojnë të jenë rishikuar, ku situata për shpenzimet buxhetore paraqitet si në vijim:

- Diferenca mes vlerës së parashikuar së shpenzimit në PBA 2022-2024 dhe buxhetit fillestar 2022 rezulton 821,693 mijë lekë më shumë shpenzime për Buxhetin fillestar 2022;
- Diferenca mes buxhetit fillestar 2022 dhe buxhetit të rishikuar 2022 rezulton 83,078 mijë lekë më pak për buxhetin e rishikuar 2022.

Krahasimisht me Buxhetin e rishikuar 2022, rezulton se gjatë vitit 2022 shpenzimet buxhetor paraqiten me një mosrealizim prej 988,175 mijë lekë, dhe shpenzimet jashtë buxhetore me një mosrealizim prej 59,525 mijë lekë. Mosrealizimi i shpenzimeve në total paraqitet në vlerën 1,047,700 mijë lekë.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/5, datë 08.03.2024 nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 973/6, datë 09.04.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

- *Në buxhetin e vitit një burim financimi është edhe trashëgimia me destinacion që janë fonde të vitit paraardhës të papërdorura që planifikohet të trashëgohen vitin pasardhës.*

... Shpjegojmë se janë normale diferencat ndërmjet tavaneve përgatitore të buxhetit të vitit 2022 të miratuara me VKB nr. 19, 25.03.2021 dhe buxhetit të vitit 2022 të miratuar me VKB nr. 3, datë 05.01.2022 në burime financimi dhe në shpenzime sipas programeve.

- Pjesa më e madhe e ndryshimeve të shpenzimeve sipas programeve ka ardhur nga rishikimi i fondeve të trashëguara dhe shtesa e planit të buxhetit nga projektet apo nga mosalokimet nga transfertat e kushtëzuar të planifikuar nga PBA 2022-2024.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/6, datë 09.04.2024 grupi i auditimit gjykon se:

Në planifikimin e shpenzimeve të programeve të PBA brenda tavaneve të miratuara paraprakisht dhe në raste të veçanta të tejkallimit të tyre për shkak të kërkesave buxhetore shtesë duhet të kihet parasysh që ato të të vijnë si rezultat i arsyeve të qenësishme shoqëruar me dokumentacione dhe arsyetimin përkatës.

Gjykojmë se nga Bashkia Shkodër nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

Sa i takon programeve buxhetore, është bërë rishpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Qeverisja Qendrore të granteve nëpërmjet transfertës të pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve. Gjithashtu, ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer referuar disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

Gjatë vitit 2022 si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fonde të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit, por kanë qenë të bazuara në faktin e vitit paraardhës 2021.

Në total, shpenzimet buxhetore janë realizuar në masën 75% gjatë viti 2022, detajuar edhe në nivel programi në tabelën nr. 2.2.6, renditur sipas përqindjes së realizimit. Nga analiza e të dhënave, programet me realizimin më të lartë (100%) të shpenzimeve janë programet “Strehimi” dhe “Emergjencat civile”, ndërsa programi me realizimin më të ulët është “Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi” (9%). Programet të cilat paraqiten me vlerë 0 të realizimit janë “Planifikimi urban vendor”, “Fondi rezervë” dhe “Fondi i kontigjencës”.

Realizimi i treguesve buxhetorë:

Emërtimi	Plan (000/Lekë)	Fakt (000/Lekë)	Realizimi në %
Shpenzime personeli	921,701	685,999	74.43%
Shpenzime operative	1,019,735	661,440	64.86%
Shpenzime kapitale	736,005	408,201	55.46%
Total	2,677,441	1,755,640	65.57%

Burimi: Bashkia Shkodër.

Referuar të dhënave të raportuara nga Bashkia Shkodër, realizimi i treguesve buxhetorë paraqitet si në tabelën më sipër. Masa e realizimit vjetor të buxhetit kundrejt planit rezulton 66%. Shpenzimet e personelit rezultojnë të jenë realizuar në masën 74% (realizimi më i lartë), ndërsa realizimi më i ulët është për shpenzimet kapitale në masën 55%. Ndërkohë, pesha që zënë shpenzimet e personelit tek shpenzimet totale është 39%, pesha e shpenzimeve operative është 37% dhe pesha e shpenzimeve kapitale është 23%.

3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Në kuadër të zbatimit të buxhetit, për vitin 2022 është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Shkodër, lidhur me shpenzimet dhe me të ardhurat, duke mbajtur rakordimet përkatëse. Nga ana e Bashkisë Shkodër, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për secilin artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Për periudhën objekt auditimi, janë çelur fondet në Degën e Thesarit Shkodër, duke pasqyruar ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin

respektiv të realizuar me Vendim të KB, ose të diktuar nga Transferta e deleguar nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit.

Realizimi i investimeve. Grupi i auditimit konstaton se niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet në nivele të ulëta në vitin 2022, konkretisht në masën 53% (*10% më pak se realizimi i vitit 2021*).

Kjo situatë vjen si rezultat i realizimit të ulët të disa prej investimeve dhe prej mosrealizimit të investimeve të planifikuara (realizim 0 lekë) për disa programe ekonomike edhe pse janë planifikuar investime si:

- Programi ekonomik “*Shërbimet e Policisë Vendore*” planifikuar investim në vlerën 15,000 mijë lekë;
- Programi ekonomik “*Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile*” planifikuar në vlerën 16,041 mijë lekë;
- Programi ekonomik “*Menaxhimi i infrastrukturës dhe kullimit*” planifikuar në vlerën 1,031 mijë lekë;
- Programi ekonomik “*Planifikimi Urban Vendor*” planifikuar në vlerën 500 mijë lekë;
- Programi ekonomik “*Shërbime Publike Vendore*” planifikuar në vlerën 1,000 mijë lekë;
- Programi ekonomik “*Sport dhe argëtim*” planifikuar në vlerën 31,525 mijë lekë.

Përdorimi i të ardhurave. Për vitin 2022, Bashkia Shkodër ka realizuar të ardhura nga burimet e veta vendore në vlerën 970,365 mijë lekë përkundrejt planit prej 931,758 mijë lekë. Me të gjitha burimet e saj të financimit, pra përfshirë të ardhurat e veta dhe burimet e tjera, Bashkia Shkodër ka mbuluar shpenzimet për paga, shpenzimet operative, shpenzimet për transferime dhe shpenzime për investime, specifikisht:

- Shpenzimet për paga janë realizuar nga të ardhurat e veta në masën 57.45%, me transfertë të pakushtëzuar sektoriale në masën 39% dhe me transfertë të kushtëzuar në masën 3.55%.
- Shpenzimet operative janë realizuar me të ardhurat e veta në masën 83.3%, me transfertë të pakushtëzuar sektoriale në masën 15.96%, me donacione 0.38% dhe me transfertë të kushtëzuar në masën 0.37%.
- Shpenzimet për transferime janë realizuar me të ardhurat e veta në masën 7.08%, me transfertë të pakushtëzuar sektoriale në masën 3.93% dhe me transfertë të kushtëzuar në masën 89%.
- Shpenzimet për investime janë realizuar me të ardhurat e veta në masën 97.6%, me donacion 0.09% dhe me transfertë të pakushtëzuar sektoriale në masën 2.31%.

4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Fatura të likuiduara përtej afatit 30 ditor. Nga auditimi i të dhënave të dorëzuara nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Shkodër, u konstatua se për vitin 2022 janë kryer pagesa mbi afatin 30 ditor. Për faturat e evidentuara, të vonuara përtej afatit 30 ditor për paraqitje në degën e Thesarit, ku si shkak është mos paraqitja në kohë e faturave nga personat përgjegjës, është mbajtur procesverbal ndaj këtyre të fundit ose është bërë tërheqje vëmendje.

Ndërkohë, nga auditimi i Urdhër-Shpenzimeve, pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes në Degën e Thesarit Shkodër të Urdhër-Shpenzimit me dokumentacionin shoqëruar nga data e faturës së operatorit ekonomik, rezultoi se gjatë vitit 2022 janë likuiduar fatura të lëshuara që në vitet paraardhëse.

Nga auditimi ka rezultuar se gjatë vitit 2022, në sistemin e thesarit, janë shlyer përtej afatit 30 ditor në total 79 fatura me vlerë 173,341,439 lekë. Nga kjo vlerë rezultoi se 130,033,614 lekë (ose 75% e vlerës së të gjithë faturave të paguara me vonesë) janë për llogari të investimeve të trupëzuara dhe pa trupëzuara (230 dhe 231), ndërsa pjesa tjetër prej 37,307,825 lekë (ose 25%) janë paguar për llogaritë 602.

Pra, me fondet buxhetore të vitit 2022, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale, ku janë paguar 46 fatura të lëshuara në vitin 2020 dhe 2021, me vlerë 120,442,889 lekë.

Referuar Raportit të Monitorimit të Buxhetit të përgatitur nga Bashkia Shkodër e të dërguar pranë MFE me shkresën nr. 2978 Prot., datë 28.02.2023 dhe Informacionit mbi vetëvlerësimin financiar të Bashkisë Shkodër dërguar pranë MFE me shkresën nr. 2500 Prot., datë 21.02.2023, stoku i detyrimeve të prapambetura më datë 31.12.2022 paraqitet në vlerën 571,032 lekë në systemin SIFQ, të klasifikuara si shpenzime korrente, në proces gjyqësor dhe duke mos pasqyruar detyrime të prapambetura për shpenzimet kapitale.

Nga analiza e të dhënave të faturave të paguara përmes Thesarit dhe sistemit SIFQ, rezulton se për shpenzime kapitale (investime) gjatë vitit 2022 ka minimalisht 121,800,310 lekë detyrime të prapambetura (të pashlyera në kohë, të cilat përfaqësojnë faturime të vitit 2021 dhe vitit 2022, të papaguara deri në Dhjetor 2022). Këto detyrime duke u shtuar së bashku me detyrimet e prapambetura të tipit shpenzime korrente (deklaruar nga Bashkia Shkodër në Raportin në fjalë), arrijnë vlerën totale prej minimalisht 122,371,342 lekë. Statusi i gjendjes financiare nga Bashkia Shkodër është përllogaritur sipas raportit Stoku i Detyrimeve/Shpenzime totale të miratuara të NJVQV, si në vijim:

$$\frac{\text{Stoku i detyrimeve te prapambetura}}{\text{Shpenzime totale te miratuara te NJVQV}} = \frac{571,032}{2,912,272,947} = 0.02 \%$$

Type equation here.

Statusi financiar i njërive të vetëqeverisjes vendore llogaritet sipas neneve 55, 56, 57, 58, 59 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si përqindjen e detyrimeve të papaguara ndaj të tretëve, mbi shpenzimet vjetore të miratuara. Nga përllogaritjet e grupit të auditimit, raporti i cili vlerëson gjendjen financiare do të paraqitet si në vijim, edhe pse nuk e ndryshon statusin e gjendjes financiare të Bashkisë Shkodër e cila paraqitet si “pa probleme financiare”, megjithatë mund të ndryshojë renditjen e saj në listën e bashkive sipas statusit .

$$\frac{\text{Stoku i detyrimeve te prapambetura}}{\text{Shpenzime te planifikuara vjetore}} = \frac{122,371,342}{3,172,613,000} = 3.82\%$$

Mangësitë e mësipërme kanë sjellë për pasojë mosparaqitje të saktë të vlerës së stokut të detyrimeve të prapambetura në raportimet periodike, për shkak të moszbatimit të kuadrit ligjor të raportimit të detyrimeve të prapambetura dhe likuidimi i faturave përtej afatit 30 ditor.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/5, datë 08.03.2024 nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 973/6, datë 09.04.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Për kontrata investimesh të cilat janë me financim të disa viteve, me email e datës 19.11.2020 nga Dega e Thesarit Shkodër drejtuar Bashkisë Shkodër, thuhet se “Në zbatim të Udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020, në mbështetje të Ligjit nr. 48/2014, neni 7, si dhe pas konsultimit me strukturat përkatëse në MFE të kontratave me financim shumëvjeçar që institucioni juaj ka, shumat që do të likuidohen në vitet pasardhëse, nuk konsiderohen detyrim dhe si të tilla nuk do të regjistrohen në SIFQ, pasi sipas kontratës është rënë dakord me investitorin për grafikun e financimit”.

Pra, këto fatura janë regjistruar në bilanc, por nuk janë regjistruar si detyrime të prapambetura, referuar Udhëzimit të MFE nr. 37, datë 06.10.2020.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/6, datë 09.04.2024 grupi i auditimit gjykon se:

- Sa i takon faturave të likuiduara përtej afatit 30 ditor, konstatimi i grupit të auditimit konsiston në datën e pagesës së tyre krahasuar me datën e faturës, pa evidentuar arsyen e vonës së tyre. Në lidhje me kontratat e investimeve për të cilat financimi shtrihet në disa vite, referuar edhe Udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2022, fakti se me OE është nënshkruar për grafikun e financimit, nuk do të thotë që detyrimi nuk është i prapambetur krahasuar me datën e faturës së lëshuar. Sipas përcaktimit “Detyrime të prapambetura ndaj palëve të treta nënkupton të gjitha llojet e detyrimeve financiare të NJQVQ-ve të papaguara brenda 60 ditë kalendrike nga data e pagesës së specifikuar në kontratë, faturë ose sipas ligjit”. Në këtë kuadër, grafiku i financimit i nënshkruar duhet të rakordojë me planin e pagesave, ndërkohë që pagesat rezultojnë mbi 60 ditë më vonë sesa fatura e lëshuar. Pra, nënshkrimi i grafikut nuk justifikon që lëshimi i faturës dhe pagesa kanë diferencë të mëdha kohore.

- Me përllogaritjen e re të grupit të auditimit për situatën financiare të Bashkisë Shkodër, grupi i auditimit është shprehur qartësisht se edhe me këtë përllogaritje, situata financiare e Bashkisë Shkodër nuk ndryshon, pasi ajo paraqitet në gjendje të mirë financiare dhe pa probleme. Megjithatë, krahasuar me shifrën e deklaruar pranë MFE, mund të ndryshojë renditja krahasimisht me Bashkitë e tjera, pavarësisht se situata financiare nuk ndryshon.

Gjykojmë se nga Bashkia Shkodër nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

Nga auditimi i kontratave të lidhura gjatë vitit, konstatohet se rezultojnë 15 raste të lidhjes së kontratave për punë/shërbime publike pas datës 15 Tetor 2022, ku për 4 raste edhe publikimi i procedurës është bërë pas datës 15 Tetor. Vlera totale e kontratave të nënshkruara pas datës 15 Tetor të vitit buxhetor përkatës është 53,867,730 lekë. Nga krahasimi i kontratave të lidhura më sipër me PBA 2022-2024, rezulton se në 7 raste, procedurat nuk janë parashikuar në PBA, ku vlera totale e këtyre kontratave të lidhura rezulton 14,635 mijë lekë. Neni 51 i Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, citon se “Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndërmarrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor”. Referuar VKM nr. 807 datë 16.11.2016 “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore publike”, pika 1 citon se “Pas datës 15 tetor të çdo viti buxhetor, njësitë e qeverisjes së përgjithshme nuk mund të publikojnë njoftimin për prokurimin e mallrave/punëve/shërbimeve, të cilat nuk janë përfshirë në regjistrin e prokurimeve publike, deri në këtë datë” dhe pika 2 citon se “Pas datës 15 tetor, procedurat e prokurimeve publike, të parashikuara në regjistrin e prokurimeve publike, mund të fillojnë/vazhdojnë vetëm për ato projekte që janë pjesë e buxhetit tre-vjeçar, të miratuar për njësinë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme. Lidhja e kontratës në këtë rast bëhet vetëm pasi fondi të jetë vënë në dispozicion në llogarinë e autoritetit kontraktor, në buxhetin e tij, të miratuar për vitin buxhetor pasardhës”.

Lidhja e kontratave përtej datës 15 Tetor të vitit buxhetor për raste të paplanifikuara në PBA 2022-2024 rrit riskun potencial për detyrime të prapambetura dhe angazhime pa fonde buxhetore në dispozicion.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/5, datë 08.03.2024 nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 973/6, datë 09.04.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

- Në rastin e marrjes së angazhimeve që shoqërohen me nënshkrimin e kontratës për blerje dhe shërbime, nëpunësi zbatues procedon me dhënien e opinionit kur merr njoftimin për urdhrin e prokurimit, përpara njoftimit përfundimtar zyrtar për shpalljen e fituesit dhe shpalljen në buletin e prokurimeve publike.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/6, datë 09.04.2024 grupi i auditimit gjykon se:

Gjykojmë se nga Bashkia Shkodër ka sjellë argumente të qenësishme të cilat ndikojnë në konstatimet tona. Për sa më lart komentet merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

Vendimet gjyqësore. Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2022, është kryer likuidimi për një vendim gjyqësor për largim të padrejtë nga puna, përbërë nga 924,000 lekë si shpenzim për ekzekutim të vendimit gjyqësor dhe 110,880 lekë si tarifë përmbartimore fikse. Si rrjedhojë e vendimit gjyqësor për largim të padrejtë nga puna, pagesa prej 1,034,880 lekë (përbërë nga shpenzime për ekzekutim të vendimit gjyqësor dhe tarifë përmbartimore fikse), përbën shpenzim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2019 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” në pikën 60 përcakton se “Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar”. Në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” në Kreun II, neni 8 përcaktohet se “Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë”.

Mbi auditimin e burimit të krijimit të të ardhurave.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Sa i takon auditimit të burimit të krijimit të të ardhurave, planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, vlerësimi të mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve, ligjshmërisë së lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve dhe evidentimin e detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit, është shqyrtuar dokumentacioni:

- PBA 2022-2024 fillestare dhe e ndryshuar;
- Evidencat e parashikimit dhe realizimit të planit të të ardhurave për vitin 2022;
- VKB nr. 1, datë 05.10.2022, “Për miratimin e strukturës së nëpunësve dhe punonjësve të administratës dhe të institucioneve në varësi të Bashkisë Shkodër”;
- VKB nr. 25, datë 20.12.2019, “Për taksat dhe tarifatat në Bashkinë Shkodër”, dhe përditësuar me Vendimin nr. 02, datë 05.01.2022;
- Të dhëna mbi kategoritë e ndryshme (biznese/individë/institucione/etj) që janë subjekt i pagesës së taksave dhe tarifave;
- Regjistri i subjekteve debitorë për taksa dhe tarifa vendore;
- Arkëtime gjatë vitit lidhur me taksa/tarifa vendore;
- Të dhëna mbi popullsinë nga Gjendja Civile;
- Dokumentacione të tjera të lidhura me licenca, kontrata qiraje etj.

Në Bashkinë Shkodër për vitin 2022, nga të dhënat e Drejtorisë së të Ardhurave, rezultojnë 39,089 individë të cilët tarifohen për taksa dhe tarifa të plota, si dhe një kategori e cila ka lehtësira fiskale si në vijim:

- Me lehtësi fiskale si pensionistë: 7,444 individë;
- Me lehtësi fiskale si kategori që përfiton ndihmë ekonomike: 2,313 individë;
- Me status invaliditeti: 660 individë;
- Me lehtësi fiskale si kryefamiljare grua dhe fëmijë në ngarkim: 143 individë.

Ndërkohë sa i takon mënyrës së faturimit, rezulton se 45,086 abonentë tarifohen përmes agjentit tatimor Ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime SHA Shkodër, ndërsa 4,563 familje faturohen për taksa dhe tarifa vendore, por nuk kanë kontratë me UK Shkodër (në total 49,469 familje).

Sa i takon planifikimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, parashikimi për të ardhurat vendore është pjesë e parashikimeve buxhetore, duke u përgatitur fillimisht në formë relacioni nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore. Në PBA fillestare 2022-2024, të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifatat vendore janë parashikuar në vlerat:

- Të ardhura nga taksat vendore në vlerën 346,037 mijë lekë;
- Të ardhura nga taksat e ndara 127,155 mijë lekë;
- Të ardhura nga tarifatat vendore 355,259 mijë lekë.

Në PBA 2022-2024 është parashikuar që 28% e financimit të vijë nga burimet e veta vendore të Bashkisë Shkodër, në vlerën totale 896,108 mijë lekë. Me ndryshimet e PBA, vlera e planifikuar e të ardhurave të veta të Bashkisë është rritur duke arritur në vlerën 931,758 mijë lekë.

- **Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore.** Sa i takon planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, rezulton se për vitin 2022, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 931,758 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 970,365 mijë lekë ose 104%. Zërat kryesorë, që janë me tejkallim në krahasim me planin e vitit 2022 janë të ardhurat nga taksa mbi ndërtesën, taksa mbi truallin, mbi kalimin e të drejtës së pronësisë, tarifatat e pastrimit, zënia e hapësirës publike. Në realizimin e planit kanë ndikuar gjithashtu edhe realizimi i të ardhurave nga donacionet, grantet si dhe shitja e titujve të pjesëmarrjes në ndërmarrjen shtetërore “Klubi i Futbollit Vllaznia”.

Nga taksat e mësipërme, me nivel të ulët realizimi paraqitet taksa e tokës bujqësore (ku sipas të dhënave nga Drejtoria e të Ardhurave, ky nivel i ulët i realizimit vjen si rezultat i mungesës

së informacionit të plotë nga ASHK me pasojë vështirësinë e krijimit të regjistrave të saktë që lidhin pronën dhe taksapaguesin e taksës së tokës bujqësore), taksa mbi biznesin e vogël, taksa mbi rentën minerare, tarifatat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.

Në analizën e realizimit të të ardhurave sipas Njësive Administrative pjesë e Bashkisë Shkodër rezultojnë se realizimi më i lartë paraqitet në Bashkinë Qendër (121%) dhe NJA Velipojë (85%), ndërsa me realizimin më të ulët paraqiten NJA Pult (7%) dhe NJA Shosh (3%).

- Analiza e disa prej taksave dhe tarifave të aplikuara përgjatë vitit 2022 në kuadër të ligjshmërisë së mbledhjes së të ardhurave dhe arkëtimit të detyrimeve.

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për Biznesin e Vogël. Referuar të dhënave nga Drejtoria e të Ardhurave në Bashkinë Shkodër, rezultojnë se për vitin 2022 ky zë është planifikuar në vlerën 5,000 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 2,175 mijë lekë, ose 44%. Menaxhimi i kësaj takse kryhet përmes agjentit tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër. Referuar dokumentacionit të dorëzuar, rezultojnë se rakordimet kanë periodicitet mujor duke evidentuar arkëtimet, megjithatë mungojnë të dhënat lidhur me evidencat e vlerave të pritshme të arkëtimit. Për më tepër, Bashkia Shkodër nuk ka të dhëna mbi numrin e subjekteve që janë objekt i kësaj takse, numrin e subjekteve që kanë paguar këtë taksë, etj., duke ndikuar në mosplanifikimin e saktë të këtij zëri, e rrjedhimisht edhe në realizimin e ulët të tij. Për më tepër, krahasuar me vitin 2021 (në vlerën 6,974 mijë lekë), ky zë paraqitet me realizim 4,799 mijë lekë më pak edhe pse në fund të vitit 2022 rezultojnë më tepër biznese të vogla se në fillim të vitit (pra, efekti neto i shtimeve dhe çregjistrimeve të Biznesit të Vogël është +250 njësi biznesi).

Sipas Akt Rakordimit për vitin 2022 të mbajtur mes Bashkisë Shkodër dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, rezultojnë se shuma totale e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin e Biznesit të Vogël në llogarinë përkatëse të DRT Shkodër është 2,124 mijë lekë.

Të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për BV sipas Akt Rakordimeve.

Në lekë

Data Akt Rakordimi	Nr i subjekteve që kanë kryer pagesën	Për muajin	Shuma e arkëtuar gjithsej	Shuma e të ardhurave për Bashkinë (99% e Totalit)	Shuma e të ardhurave për DRT Shkodër (1% e Totalit)
08.02.2022	13	Janar	202,314	200,291	2,023
10.03.2022	22	Shkurt	536,034	530,674	5,360
14.04.2022	12	Mars	76,430	75,666	764
12.05.2022	26	Prill	225,095	222,844	2,251
10.06.2022	9	Maj	95,675	94,718	957
08.07.2022	15	Qershor	237,059	234,688	2,371
09.08.2022	16	Korrik	196,345	194,382	1,963
15.09.2022	10	Gusht	115,555	114,399	1,156
24.10.2022	13	Shtator	82,631	81,805	826
16.11.2022	9	Tetor	258,371	255,787	2,584
9.12.2022	4	Nëntor	20,000	19,800	200
18.01.2023	6	Dhjetor	100,421	99,417	1,004
		Gjithsej	2,145,930	2,124,471	21,459

Burimi: Të dhënat nga Akt Rakordimet ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe DRT Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH

Të ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme. Zëri “Të ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme” është planifikuar në vlerën 182,348 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 187,954 mijë lekë ose 103%. Kjo taksë shlyhet bashkë me detyrimet e tjera vjetore, ndërsa detyrimi për familjet llogaritet dhe shlyhet së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë të Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime SHA Shkodër, në cilësinë e agjentit tatimor. Ky zë përbëhet nga nën zërat:

- Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat (Ndërtesa banimi dhe Të tjera);
- Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore;
- Të ardhura nga taksa mbi truallin.

Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat. Sa i takon të ardhurave nga taksa mbi ndërtesat (ndërtesa banimi dhe të tjera), rezultojnë se është realizuar në vlerën 167,173 mijë lekë ose 114% e parashikimit për vitin 2022. Krahasimisht me vitin 2021 konstatohet rritje në realizimin e këtyre të ardhurave me 28,470 mijë lekë. Ndikimi më i lartë në këtë zë ka ardhur nga nënzëri përbërës

“Ndërtesa të tjera” me realizim 88,574 mijë lekë. Pra, evidentohet se ka patur rritje në të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat për qëllime biznesi, e cila mund të vijë potencialisht si pasojë e rritjes së numrit të njësisve të biznesve të reja dhe zgjerimit të aktiviteteve të bizneseve.

Nga auditimi konstatohet se lidhur me mënyrën e aplikimit të taksës së ndërtesës, referuar Paketës Fiskale në fuqi përgjatë vitit 2022 (miratuar me VKB nr. 25, datë 20.12.2019, “Për taksat dhe tarifatat në Bashkinë Shkodër”, përditësuar me Vendimin nr. 02, datë 05.01.2022), rezulton se për përlllogaritjen e saktë të saj mungojnë të dhënat dhe hartat për sipërfaqet nga ASHK. Në mungesë të këtyre të dhënave, është vendosur një sipërfaqe standarde prej 100 m² mbi të cilën janë aplikuar tarifatat (çmim/m²) për familjet. Një përlllogaritje e tillë ndikon duke favorizuar disa familje dhe penalizuar të tjerë, pasi në varësi të llojit dhe vitit të ndërtimit, sipërfaqja mund të jetë më e vogël apo më e madhe, sidomos për ndërtimet të cilat nuk janë identifikuar saktë, duke ndikuar rrjedhimisht në saktësinë e përlllogaritjes së këtyre të ardhurave që në planifikim e më pas në realizim. Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në nenin 20, pika 2 përcakton se “Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore”, ndërsa në pikën 3 të po këtij neni përcaktohet se “Brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zyrat rajonale të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme u ofrojnë bashkive dhe komunave të dhënat e regjistrimit elektronik të pasurisë”. Neni 22, pika 1 e po këtij Ligji citon se “Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës për çdo kat”.

Nga auditimi konstatohet se zëri “Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore” paraqitet me një mosrealizim prej 15,510 mijë lekë (realizuar vetëm 6,226 mijë lekë nga planifikimi prej 21,736 mijë lekë), ose me realizim 29%. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për tokën bujqësore nga Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP, për vitin 2022 rezulton se në territorin e Bashkisë Shkodër dhe NJA të saj, janë gjithsej 16,043 Ha tokë bujqësore e boniteteve të ndryshme, por vetëm 14,017 Ha rezultojnë me dokument (certifikatë) pronësie. Diferenca prej 2,026 Ha nuk rezulton të planifikohet si burim të ardhurash për shkak të mangësive/mosekzistencës së dokumenteve të pronësisë. Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në nenin 23 përcakton se “Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore në hektarë, në pronësi të taksapaguesit...”. Ndërkohë, neni 24 i po këtij ligji përcakton se “Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë dhe komunës njohin dokumentin e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”. Referuar planifikimit, rezulton se janë planifikuar të ardhura nga taksa bujqësore në nivelin prej 21,736,120 lekë, sipas të dhënave të Drejtorisë së të Ardhurave. Ndërkohë, për totalin e sipërfaqes së tokës bujqësore, do të duhej të ishin planifikuar 24,700,060 lekë. Mangësitë/mungesa e dokumentacionit të pronësisë së tokës bujqësore i ka shkaktuar Bashkisë Shkodër një vlerë të munguar në planifikim prej 2,963,940 mijë lekë.

Këto sjellin si efekt paraqitjen joreale e detyrimit për taksën e tokës bujqësore, për shkak të mangësive në bashkëpunimin mes drejtorive të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të tjera duke sjellë mungesë të të dhënave lidhur me sipërfaqet bujqësore në pronësi.

Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel. Zëri “Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel” është parashikuar në vlerën 20,500 dhe është realizuar në vlerën 18,408 mijë lekë, ose 90%. Mënyra e aplikimit të kësaj takse, vijon ndër vite tashme të aplikohet referuar Akt Konstatimeve të inspektorëve që kryejnë kontrollin në terren, në datën 5 të çdo muaji. Për vitin 2022 janë mbajtur 900 Akte Konstatimi në subjekte hoteliere/akomoduese.

Sipas Paketës Fiskale, tarifatat që duhet të përdoren në përlllogaritjen e kësaj takse janë:

- 175 lekë/natë qëndrimi/person për strukturat akomoduese Hotel me 4-5 yje;
- 70 lekë/ natë qëndrimi/person për strukturat akomoduese Hotel nën 4 yje, motel, hostel, bujtinë, si dhe çdo njësi tjetër akomoduese të ngjashme me to, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin.

Derdhja e të ardhurave për këtë taksë duhet të kryhet nga hoteli në favor të bashkisë, brenda datës

5 të muajit pasardhës. Ndërkohë, në Akt Konstatimet e mbajtura nga inspektorët e Drejtorisë së të Ardhurave, nuk evidentohet në mënyrë analitike numri i netëve së fjetjes për personat, por thjesht numri i personave. Për më tepër, në to bëhet një vetëdeklarim nga subjekti i cili duhet të derdhë të ardhurat dhe nuk paraqitet pasqyra e plotë e lëvizjes së klientit. Në këtë kuadër, nuk evidentohen kapacitetet akomoduese të strukturave hoteliere (numri i dhomave aktive, shtretërve të gatshëm për akomodim, etj). Edhe me përditësimin e Paketës Fiskale përmes Vendimit nr. 1, datë 05.01.2022, vijon që mënyra e përlllogaritjes së kësaj takse të jetë bazuar në netët e qëndrimit/person dhe jo me tarifë fikse për shtrat/netë qëndrimi, mënyrë e cila do të merrte në konsideratë në mënyrë më të saktë kapacitetin akomodues të strukturave hoteliere. Të gjitha këto mangësi, ndikojnë në saktësinë e planifikimit të të ardhurave nga taksa e fjetjes në hotel, sidomos për periudhat e flukseve turistike, e më pas edhe në realizimin e këtij zëri.

Sa i takon debitorëve (biznese) të kësaj takse, rezulton se viti 2022 është çelur me debitorë në vlerën 17,221 mijë lekë dhe janë kryer pagesa për detyrime të prapambetura në vlerën 15,270 mijë lekë dhe janë shtuar debitorë në vlerën 20,218 mijë lekë, duke rezultuar në fund të vitit 2022 me një gjendje debitorësh prej 22,169 mijë lekë. Pra gjatë vitit 2022 rezulton se janë krijuar më shumë detyrime të prapambetura sesa janë paguar për këtë taksë.

Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë. Taksa e ndikimit në infrastrukturë është planifikuar në vlerën 121,044 mijë lekë dhe është realizuar gjatë vitit në vlerën 121,182 mijë lekë, ose 100%, e përbërë nga:

- Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (realizuar 109%); dhe
- Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet në proces legalizimi (realizuar 65%).

Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet në proces legalizimi rezulton me një mosrealizim prej 8,532 mijë lekë gjatë vitit 2022. Referuar dokumentacionit dhe shkresave të dërguara nga zyra vendore e ASHK Shkodër, për vitin 2022 rezulton se janë përcjellë pranë Bashkisë Shkodër listat me emrat e individëve të cilëve u janë miratuar lejet e legalizimit për ndërtimet pa leje ndërtimi brenda territorit të Bashkisë Shkodër. Nga DVASHK Shkodër, janë dërguar dokumentet për çdo person që ka ndërtuar objekt banimi apo social ekonomik në territorin e Njësisë Administrative të Bashkisë Shkodër, ku përcaktohet edhe detyrimi për të paguar vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Referuar të dhënave të Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit për vitin 2022 rezultojnë 323 leje legalizimi për ndërtesa objekt I dhe II (ndërtesa të reja dhe ndërtesa të dyta). Sipas përlllogaritjeve, rezulton se për ndërtesat për të cilat është lëshuar leja e legalizimit gjatë 2022 duhej të ishte arkëtuar vlera prej 21,290 mijë lekë, ndërkohë nga Drejtoria e të Ardhurave gjatë vitit 2022 janë arkëtuar vetëm 15,677 mijë lekë në total.

Përlllogaritje për taksën e ndikimit në infrastrukturë lidhur me legalizimet

Në lekë

Lloji i Objektivit	Individë	Taksë e përlllogaritur
I	287	11,099,108
II	36	10,190,816
Total	323	21,289,924
Të ardhurat nga taksa për 2022		15,677,207
Diferencë e pa arkëtuar		5,612,717

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Shkodër. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Sa i takon vjeljes së këtyre të ardhurave që vijnë si rezultat i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga këto objekte, konstatohet se ka mangësi në masat e marra nga Drejtoria e të Ardhurave, duke mos marrë masa shteruese dhe duke mos arkëtuar diferencën prej 5,613 mijë lekë që vjen si rezultat i lejeve të legalizimeve të dhëna në vitin 2022.

Nga analiza e detyrimeve të prapambetura për këtë taksë, rezulton se gjatë vitit 2022 vlera prej 12,326 mijë lekë i takon shlyerjeve të detyrimeve të vitit 2022 dhe vetëm 3,351 mijë lekë janë

arkëtime për të shlyer detyrime të prapambetura ndër vite. Kështu, rezulton se për legalizimet e vitit 2022 janë arkëtuar vetëm 58% e vlerës së tyre, duke krijuar detyrim të ri të pashlyer në vlerën 8,964 mijë lekë, i cili i shtohet detyrimieve të prapambetura progresive ndër vite.

Referuar të dhënave të gjendjes civile, në qytet jetojnë thuhetse 60% e familjeve, ndërsa 40% jetojnë në NJA të territorit të Bashkisë Shkodër. Nga përllogaritjet e përafërta³ mbi taksat që duhet të ishin përllogaritur për diferencën e familjeve të pataksuara, 15,468 të tilla, rezultojnë të dhënat e tabelës më poshtë:

Përllogaritja e taksave/tarifave për familjet e pataksuara.

Lloji i taksës/tarifës	Familje të pataksuara		Tarifa sipas Paketës Fiskale		Vlera e pataksuar		Totali
	Qytet	NJA	Qytet	NJA	Qytet	NJA	
Taksë ndërtese	4,640	10,828	2,900	2,000	13,456,000	21,656,000	35,112,000
Taksë trualli	4,640	10,828	42	-	194,880	-	194,880
Tarifë pastrimi	4,640	10,828	3,450	1,950	16,008,000	21,114,600	37,122,600
Tarifë gjelbërimi	4,640	10,828	600	-	2,784,000	-	2,784,000
Tarifë ndriçimi	4,640	10,828	1,500	720	6,960,000	7,796,160	14,756,160
Total					39,402,880	50,566,760	89,969,640

Burimi: Të dhënat nga Paketa Fiskale, Gjendja Civile dhe Drejtoria e të Ardhurave, Shkodër. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Nga auditimi konstatohet se referuar të dhënave të Drejtorisë së të Ardhurave mbi kontratat familjare të lidhura me Ujësjetllës Kanalizime SHA., rezulton se janë 45,086 kontrata të lidhura, ndërkohë paguajnë tarifa vendore 4,563 familje; pra në total janë 49,649 familje të taksuara. Ndërkohë, referuar të dhënave nga Gjendja Civile, në territorin e Bashkisë Shkodër dhe NJA të saj, rezultojnë 65,117 familje⁴. Pra, nga krahasimi i të dhënave, rezulton një diferencë prej 15,468 familje të pataksuara. Nga mungesa e të dhënave të sakta lidhur me familjet dhe individët banorë të territorit administrativ të Bashkisë Shkodër si dhe referuar mosidentifikimit dhe llogaritjes së detyrimit për disa nga taksat/tarifat e parashikuara në Paketën Fiskale të përditësuar (taksë ndërtese 29 lekë/100m², taksë trualli 0.42 lekë/m², tarifë pastrim/gjelbërim/ndriçim 3450+600+1500 lekë/familje) për vitin 2022, përafërsisht paraqitet një vlerë e paplanifikuar dhe rrjedhimisht e paarkëtuar prej 85,970 mijë lekë.

Për pasojë, rezulton një paraqitje joreale e detyrimit për taksën e tokës bujqësore, për shkak të mangësive në evidentimin e saktë të familjeve dhe individëve, si rezultat i mungesës së bashkëpunimit mes drejtorive dhe institucioneve të tjera.

Lidhur me debitorët për tarifën e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit, rezulton se gjatë vitit 2022 janë shtuar më shumë debitorë sesa janë kryer pagesa për llogari të detyrimeve të prapambetura, duke çuar në gjendjen e debitorëve në fund të vitit në vlerën 220,677 mijë lekë për biznese dhe familjarë. Përbërja në fund të vitit e debitorëve është 82% si rezultat i detyrimeve të prapambetura nga tarifa e pastrimit për bizneset, 15% nga tarifa e ndriçimit për bizneset dhe 3% nga tarifa pastrim, ndriçim, gjelbërim për familjarë.

Debitorët për tarifën e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit

Në 000 lekë

Debitorë	Gjendja në 31.12.2021	Pakësime 2022	Shtesa gjatë vitit 2022	Gjendja në 31.12.2022
Tarifë Pastrimi (Biznese)	138,599	142,432	184,203	180,370
Tarifë Ndriçimi (Biznese)	25,385	39,673	47,469	33,181
Tarifë pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi (Familje)	6,520	6,796	7,402	7,126
Total	170,504	188,901	239,074	220,677

Burimi: Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër.

³ Përllogaritjet janë bazuar në faktin se pjesa më e madhe e familjeve të pataksuara mund të jetojnë në NJA, ndaj në përllogaritje është përdorur një raport prej 70% të familjeve të pataksuara si banorë të NJA dhe 30% banorë në qytet. Gjithashtu, për përllogaritjet e familjeve janë përdorur të dhënat e Gjendjes Civile të datës 01.04.2021, si të dhënat më të fundit të tyre; megjithatë shifrat mund të ndryshojnë për numrin faktik në 2022.

⁴ Të dhënat më të fundit të përditësuar të Gjendjes Civile Shkodër i përkasin datës 01.04.2021.

Të ardhura nga taksa e zënies së hapësirës publike. Për vitin 2022, rezulton se realizimi i të ardhurave që vijnë nga taksa e zënies së hapësirës publike paraqitet në masën 119%, pra janë arkëtuar të ardhura në vlerën 47,652 mijë lekë nga 40,050 mijë lekë të planifikuara.

Të ardhura nga taksa e rentës minerare. Në vitin 2022 janë parashikuar “Të ardhura nga taksa e rentës minerare” në vlerën 35 mijë lekë dhe janë realizuar vetëm 6 mijë lekë, ose ndryshe 19% e tyre. Krahasimisht me vitin 2021, këto të ardhura paraqiten në rënie me 5 mijë lekë ose 15%. Sa i takon rentës minerare, çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit. Bashkisë Shkodër i takojnë 5% e të ardhurave nga renta minerare. Për vitin 2022, përmes Akt Rakordimeve me DRT Shkodër rezulton të jenë arkëtuar 6 mijë lekë.

Të ardhura nga kontratat e qirave të pyjeve dhe kullotave. Për vitin 2022, realizimi i “Të ardhura nga kontratat e qirave të pyjeve dhe kullotave” paraqiten në vlerën 459 mijë lekë ose 24% nga vlera e parashikuar 1,900 mijë lekë. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se përgjatë vitit 2022 janë aktive kontratat e qirasë me detyrim total për vitin në vlerën 1,444 mijë lekë, në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër.

Kontratat e qirave të lidhura për sipërfaqet pyjore dhe kullosore

Nr	Ekonomia pyjore/kullosore	Ngastra, nënngastra	Shoqëria/ Subjekti	Aktiviteti	Akti miratimit (Nr. datë)	Sipërfaqja e dhënë në përdorim		Kohëzgjatja	Detyrim 2022
						ha	km		
1	Lugina e Kirit	203a	T...	Telekomuni kim	VKB nr 57 dt.30.09.2017	0.0205	0.026	5 vjet	174,334
			O...		VKB nr 69 dt.21.12.2022	0.0205	0.026	5 vjet	58,111
2	Pruemos Sheldi	104	T...	Telekomuni kim	VKB nr 57 dt.30.09.2017	0.0205	0.026	5 vjet	134,494
			O...		VKB nr 69 dt 21.12.2022	0.0205	0.11	5 vjet	45,488
3	Rosek Rrjoll	3	T...	Telekomuni kim	VKB nr 57 dt 30.09.2017	0.0205	0.35	5 vjet	134,494
			O...		VKB nr 69 dt 21.12.2022	0.0205	0.35	5 vjet	49,687
4	Lugina e Kirit	189/b	T...	Telekomuni kim	VKB nr 52 dt 19.07.2018	0.025	0	5 vjet	281,250
5	Lugina e Shales 2	31/b	T...	Telekomuni kim	VKB nr 52 dt 19.07.2019	0.025	0	5 vjet	281,250
6	Pruemos Sheldi	50/a	T...	Telekomuni kim	Ish Komuna Rrethina	0.025	0	9 vjet	281,250
			O...		VKB nr 50 dt 30.09.2021	0.025	0	5 vjet	
7	Rosek Rrjoll	3	Z... M... fermer NIPT L.....S	Kullotje bageti	VKB nr 23 dt 30.04.2018	1		10 vjet	3,750

Burimi: Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave. Bashkia Shkodër.

Për vitin 2022, sipas të dhënave të Bashkisë Shkodër janë faturuar 1,389 mijë lekë dhe janë arkëtuar 1,090 mijë lekë, duke rezultuar në gjendje të pa arkëtuar më 31.12.2022 në vlerën 299 mijë lekë.

Mbi kontratat e qirasë për subjektet me leje aktive të shfrytëzimit minerar në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër.

Referuar Regjistrimit të Lejeve Minerare, publikuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, përgjatë periudhës së auditimit, në territorin e Bashkisë Shkodër kanë patur leje aktive për të ushtruar aktivitet subjektet, si më poshtë:

Subjektet me leje aktive minerare për vitin 2022 sipas të dhënave të Regjistrit të Lejeve Minerare Aktive

Nr.	Emri i subjektit	Nipt	Nr. Leje	Data e lejes	Emërtimi i vendburimit	Lloji i Mineralit	S=km ²
1	A... K... SHPK	J.....N	882/1	24.06.2005	Postribe, Mes, Shkodër	Gur Gëlqeror	0.023
2	G... B... SHPK	L.....N	1740	10.02.2015	Baks, Postribë	Gëlqeror i mermerizuar	0.046
3	S... A... SHPK	L.....A	1799	09.05.2016	Gajtan, Guri I Zi	Gur Gëlqeror	0.025
4	B... C... SHPK	J.....B	1835	03.07.2017	Objekti Rasek	Gëlqeror i mermerizuar	0.785

Burimi: Regjistri i Lejeve Minerare Aktive, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës.

Ndërkohë, mbi situacionin e të ardhurave të gjeneruara nga dhënia në përdorim e sipërfaqeve të fondit pyjor për ushtrimin e aktivitetit minerar, Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave në Bashkinë Shkodër ka informuar se nuk ka asnjë kontratë të lidhur me subjektet që ushtrjnë aktivitetin në territorin administrativ, duke arsyetuar se:

1. Ligji nr. 9385/2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, nuk parashikon që njësitë e qeverisjes vendore të lidhin kontratë për dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore për ushtrimin e aktivitetit në fushën e minierave;

2. Neni 17 i këtij ligji parashikon se pjesët e fondit pyjor kombëtar që kërkohen nga subjekte apo organe të qeverisjes vendore për veprimtari minerare e gjeologjike hiqen nga fondi pyjor dhe Kadastra Kombëtare e Pyjeve.

Me anë të shkresës nr. 6298 prot., datë 21.04.2021, Kryetari i Bashkisë Shkodër ka dërguar pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit kërkesën për ndryshim/heqje nga fondi pyjor, bashkëlidhur VKB nr. 21, datë 25.03.2021, mbi vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor i sipërfaqes që disponon “S... A...” SHPK. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nuk ka përgjigje nga ministria përgjegjëse për mjedisin.

Subjekti “B... C...” SHPK i është drejtuar Ministrisë me anë të shkresës së datës 02.11.2017 me kërkesën për heqje nga fondi pyjor. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nuk ka përgjigje nga ministria përgjegjëse për mjedisin.

3. Ligji i ri nr. 57/2020 “Për pyjet” nuk parashikon që bashkitë të lidhin kontratë me subjekte për shfrytëzim gurore dhe VKM nr. 559/2022 “Për tarifën në sektorin e pyjeve” nuk parashikon tarifa për dhënien në përdorim të fondit pyjor për aktivitetin e guroveve.

Subjektet që kanë ushtruar aktivitet të shfrytëzimit të guroveve sipas të dhënave të Bashkisë Shkodër.

Nr.	Emërtimi i subjektit	Lloji i aktivitetit	NIPT	Ekonomia Pyjore	Statusi juridik i parcelës	Leje shfrytëzimi	Periudha e zbatimit të kontratës	Sipërfaqe në përdorim	Kërkesë për heqje nga fondi pyjor
1	B... C... SHPK	Shfrytëzim minerar	J.....B	Ekonomia Kullosore "Rosek-Rrjoll"	Inventar i Pronave Bashkia Shkodër sipas VKM nr. 433/2016	Nr. 1835, datë 30.06.2017	25 vjet	0.785 km ²	Shkresë e subjektit drejtuar MIE me nr. 261/17-11 Prot., datë 02.11.2017
2	S... A... SHPK	Shfrytëzim minerar	L.....A	Ekonomia Pyjore "Pruemos/Sheldi"	Inventar i Pronave Bashkia Shkodër sipas VKM nr. 433/2016	Nr. 1799, datë 06.05.2016	25 vjet	0.025 km ²	Shkresë e Bashkisë Shkodër drejtuar MMT me nr. 6298 Prot., datë 21.04.2021

Burimi: Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave. Bashkia Shkodër.

Bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 9385/2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, heqja nga fondi pyjor, për pyjet dhe tokat me bimësi pyjore me sipërfaqe mbi 1 ha e deri në 100 ha bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Ndaj, grupi i auditimit konstaton se në mungesë të një Vendimi të Këshillit të Ministrave që përjashton sipërfaqet nga fondi pyjor, sipërfaqet do të vijojnë të mbeten pjesë e fondit pyjor. Për më tepër, nga analiza e të dhënave të Regjistrit

të Lejeve Minerare Aktive dhënë nga MIE, lejet për 4 subjektet e cituara datojnë në vitet 2005, 2015, 2016, 2017, përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet”.

Shtojca nr. 2 e VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, (në fuqi gjatë vitit 2022 deri në hyrjen në fuqi të VKM nr. 559/2022) përcaktonte, ndër të tjera, tarifën për përdorimin e sipërfaqeve të fondit pyjor e kullor publik, për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, sipas kohëzgjatjes së kontratës, si më poshtë:

1 vit – 540,000 lekë/ ha/ vit;

2-5 vjet – 495,000 lekë/ ha/ vit;

6-10 vjet – 440,000 lekë/ ha/ vit.

Në zbatim të përcaktimeve të mësipërme dhe bazës ligjore në fuqi deri në 29.07.2022, Bashkia Shkodër duhet të kishte lidhur kontrata me subjektet operuese, nga ku do të ishin gjeneruar të ardhura nga dhënia në përdorim e fondit pyjor për kryerjen e aktivitetit minerar.

Të ardhura të mundshme të gjeneruara vjetore për kontratat e qirave

Nr.	Subjekti	Sip. (ha)	Vlera/ vit (Sip*440,000) (në lekë)
1	“A... K...” SHPK	2.3	1,012,000
2	“G... B...” SHPK	4.6	2,024,000
3	“S... A...” SHPK	2.5	1,100,000
4	“B... C...” SHPK	78.5	34,540,000
TOTALI			38,676,000

Burimi: Grupi i auditimit, KLSH.

Në këtë kuadër, për periudhën kur VKM nr. 391, datë 21.06.2006 ka qenë në fuqi, Bashkia Shkodër, për shkak të mungesës së kontratave të qirasë, ka shkaktuar të ardhura të munguara, tashmë të paarkëtueshme, duke qenë se me hyrjen në fuqi të VKM nr. 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike dhe prodhimet drusore e jo drusore pyjore, si dhe mënyrën e procedurën e mbledhjes së tyre”, nuk parashikohen tarifa për shfrytëzimin e fondit pyjor për aktivitetin e nxjerrjes së materialeve inerte.

Të ardhura nga tarifën e licencave të transportit dhe të naftës. Gjatë vitit 2022 zëri “Të ardhura nga licencat e transportit” paraqitet në vlerën 1,513 mijë lekë me një realizim prej 108%, ndërsa zëri “Të ardhura nga tarifën për dhënie licence për tregtimin e naftës” paraqitet në vlerën 17,649 mijë lekë me një realizim prej 80%. Krahasimisht me vitin 2021, të ardhurat nga licencat e naftës (hidrokarbure) paraqiten në rritje prej 2,112 mijë lekë.

Nga auditimi konstatohet se referuar të dhënave të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës dhe Drejtorisë së të Ardhurave, rezulton se në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër kryejnë aktivitet të tregtimit të karburantit gjithsej 43 subjekte. Nga këto, për vitin 2022 kanë licencë aktive për tregtimin e karburanteve 15 subjekte që operojnë në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër, ku vetëm gjatë vitit 2022 janë lëshuar 6 licenca të reja. Pjesa e mbetur prej 28 subjektesh, nuk kanë licencë aktive për tregtim. Referuar VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, Kreu II, pika 1, germa b, përcaktohet se “Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësisive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, ...”.

Nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës në 30.03.2022 dhe 24.16.2022 janë dërguar njoftimet drejt subjekteve të palicencuara për t’u paraqitur pranë zyrave të Bashkisë Shkodër për të aplikuar për pajisjen me licencën e tregtimit me pakicë të karburanteve, dhe për dijëni edhe drejt Inspektoriatit Shtetëror Teknik Industrial. Gjithashtu, u janë dërguar shkresa Policisë Bashkiake dhe Drejtorisë së të Ardhurave në Bashkinë Shkodër, lidhur me ndjekjen e rrugëve ligjore deri në pajisjen me licencë të 28 subjekteve të cilët nuk janë paraqitur pranë Bashkisë Shkodër pas njoftimit të tyre. Në pikën 1 të nenit 15 të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe

nënprodukteve të tyre” citohet se “Stacionet e shitjes së karburanteve lejohen të ushtrjnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë pajisur nga organi kompetent me autorizimin përkatës, sipas këtij ligji, me kusht që ndërtimi i instalimeve dhe funksionimi i tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë të jenë në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara nga ministria”. Në pikën 15.1, Kreu II i VKM nr. 970, datë 02.12.1999, e ndryshuar, citohet se “Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrjnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë”. Referuar pikës 9 të Kreut II të së njëjtës VKM citohet “Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera”.

Mangësitë e mësipërme janë një risk potencial në ushtrimin e aktivitetit nga subjekte të cilat nuk plotësojnë kriteret përkatëse dhe kushtet teknike, si dhe mungesë e mundësisë së ushtrimit e kontroleve të herëpashershme nga strukturat përgjegjëse. Shkaku konsiderohet se janë mangësitë në marrjen e masave shteruese dhe bashkëpunimin ndërinstitucional për të gjitha subjektet që nuk zotërojnë licencën e tregtimit deri në aplikimin e tyre për licencën përkatëse dhe përfitimin e saj.

Pasqyra e subjekteve që ofrojnë shërbimin e tregtimit të karburanteve.

Nr	Subjekti	NIPT	NJA	Licenca për vitin 2022
1	"K..." SHPK	J.....P	Rrethinat	Pa licence
2	"K..." SHPK	J.....P	Shkodër Lagje 3	30.07.2020 - 28.10.2023
3	"K..." SHPK	J.....P	Shkodër Lagje 1	11.07.2019 - 10.07.2024
4	"O..." SHPK	J.....I	Shkodër Lagje 3	01.01.2022 - 31.12.2026
5	"O..." SHPK	J.....I	Shkodër Lagje 2	04.02.2019 - 03.02.2024
6	"A..." SHPK	J.....O	Shkodër Lagje 1	Pa licence
7	"K... B..." SHPK	J.....C	Rrethinat	Pa licence
8	"D..." SHPK	J.....L	Rrethinat	03.06.2020 - 02.06.2025
9	"G..." SHPK	J.....J	Dajç, Shkodër	01.03.2022 - 28.02.2027
10	"A..." SHPK	J.....T	Shkodër Lagje 5	07.08.2019 - 06.08.2024
11	"N..." SHPK	K.....J	Guri i Zi	Pa licence
12	"L..." SHPK	K.....I	Shkodër Lagje 1	Pa licence
13	D... GJ...	K.....R	Velipojë	Pa licence
14	"G... C..." SHPK	K.....T	Shkodër Lagje 2	Pa licence
15	"G... C..." SHPK	K.....T	Shkodër Lagje 1	09.12.2019 - 08.12.2024
16	"G... C..." SHPK	K.....T	Shkodër Lagje 4	Pa licence
17	"G... C..." SHPK	K.....T	Bërdicë, Shkodër	18.04.2022 - 17.04.2027
18	"G... C..." SHPK	K.....T	Bërdicë	18.04.2022 - 17.04.2027
19	"G... C..." SHPK	K.....T	Ana e Malit	Pa licence
20	"G... C..." SHPK	K.....T	Shkodër Lagje 2	01.01.2021 - 31.12.2025
21	"L..." SHPK	K.....C	Shkodër Lagje 4	Pa licence
22	"L..." SHPK	K.....C	Shkodër Lagje 1	04.11.2018 - 03.11.2023
23	"L..." SHPK	K.....C	Shkodër Lagje 5	22.09.2019 - 21.09.2024
24	"A... P..." SHPK	K.....T	Ana e Malit	Pa licence
25	O... O...		Postribë	24.06.2022 - 23.06.2027
26	"D..." SHPK	K.....T	Shkodër Lagje 1	Pa licence
27	"D..." SHPK	K.....T	Ana e Malit	Pa licence
28	"D..." SHPK	K.....T	Rrethinat	Pa licence
29	"K..." SHPK	K.....D	Postribë	17.04.2023 - 17.04.2024
30	"I..." SHPK	K.....J	Rrethinat	Pa licence
31	"L... T..." SHPK	L.....A	Velipojë	Pa licence
32	"J... L..." SHPK		Postribë	Pa licence
33	"A..." SHPK	L.....G	Bërdicë	Pa licence
34	"A..." SHPK ⁵	L.....G	Shkodër Lagje 1	Pa licence
35	K... ⁶	L.....J	Bërdicë	Pa licence
36	A... O...	L.....P	Velipojë	Pa licence
37	G... O...	L.....D	Shkodër Lagje 1	Pa licence
38	R... P...	L.....P	Shkodër Lagje 1	Pa licence
39	J... A...	L.....D	Shkodër Lagje 1	Pa licence
40	J... A...	L.....D	Rrethinat	Pa licence
41	K... ⁷	L.....A	Rrethinat	Pa licence
42	D... P... ⁸	L.....S	Shkodër Lagje 1	Pa licence

⁵ Zëvendësuar me subjektin D...-A..., pa licencë

⁶ Zëvendësuar me subjektin Rr... M..., pa licencë

⁷ Zëvendësuar me subjektin G... F..., pa licencë

⁸ Zëvendësuar me subjektin D... P..., pa licencë

43	G... P...	M.....K	Guri i Zi	Pa licence
----	-----------	---------	-----------	------------

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Në total, për 43 subjektet, janë faturuar 18,233 mijë lekë dhe janë arkëtuar 17,033 mijë lekë. Lidhur me subjektet debitorë për vitin 2022, rezulton se 4 prej tyre kanë lidhur akt marrëveshje për pagesën, ndërsa 5 prej tyre vijnë të jenë ende debitorë.

Subjektet debitorë për tregtimin e hidrokarbureve dhe masat e marra

Nr.	Subjekti	Statusi	Shënime
1	"A..." SHPK	Debitor	Padi në Gjykatë
2	"A... P..." SHPK	Debitor	-
3	"I..." SHPK	Likuiduar pjesërisht	Akt marrëveshje 2023
4	"L... T..." SHPK	Likuiduar pjesërisht	Akt marrëveshje 2023
5	"J... L..." SHPK	Likuiduar pjesërisht	Akt marrëveshje 2023
6	G... O...	Debitor	Pagesë me këste
7	G... O...	Likuiduar pjesërisht	Akt marrëveshje 2023
8	R... P...	Debitor	Nuk ka respektuar akt marrëveshjen
9	K....	Debitor	Nuk ka respektuar akt marrëveshjen

Burimi: Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër.

Ndërsa për subjektet e pajisura me licencë, nga të dhënat e Drejtorisë së të Ardhurave rezulton se për vitin 2022 janë faturuar 13,200 mijë lekë, të cilat janë arkëtuar 100%.

Të ardhura nga shfrytëzimi i hapësirave të plazhit. Për vitin 2022, rezulton se janë 60 kontrata aktive për shfrytëzimin e stacioneve të plazhit, për 55 subjekte, sipas parcelave të ndryshme dhe sipërfaqes së marrë nën shfrytëzim. Nga të dhënat e Drejtorisë së Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve, rezulton se për vitin 2022 janë faturuar 37,830 mijë lekë detyrime dhe janë paguar 100% e tyre.

Të dhëna mbi kontratat aktive për shfrytëzimin e stacioneve të plazhit

Në lekë

	Numër subjektsh	Sipërfaqe (m ²)	Niveli i tarifës	Detyrimi	Paguar
	39	63,350	490 lekë/m ² /sezon	30,603,420	30,603,420
	16	20,647	350 lekë/m ² /sezon	7,226,450	7,226,450
Total	55			37,829,870	37,829,870

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve, Bashkia Shkodër. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Të ardhura nga kontratat e qirave të aseteve. Sa i takon aseteve të Bashkisë Shkodër, nga të dhënat e Drejtorisë Juridike rezultojnë kontrata 6 kontrata qiraje si më poshtë:

Kontratat e qirave të aseteve të Bashkisë Shkodër.

Nr.	Qiramarrësi	VKB për pëlqimin e dhënies me qira	Kontrata	Sip (m ²)	Detyrimi (lekë/muaj)	Detyrimi për vitin	Arkëtuar për vitin
I	Kontrata nën 200 m ²						
1	"B... T..." SHA.	VKB nr. 59, datë 30.09.2017	Nr. 18533 Prot., datë 12.12.22	7.5	1,305	15,660	15,660
2	"B... V..." SHPK	-	Nr. 535 Prot., datë 12.01.2022	12.0	2,088	25,056	25,056
3	"R... P... I..." M.B. PF	VKB nr. 25, datë 20.04.2021	Nr. 10035 Prot., datë 20.06.2022	27.0	4,698	56,376	56,376
4	S.Sh. PF	VKB nr. 33, datë 30.07.2020	Nr. 782 Prot., datë 17.01.2022	155.0	26,970	323,640	323,640
5	B.H. PF	VKB nr. 61, datë 06.12.2021	Nr. 1434 Prot., datë 30.03.2022	40.0	6,960	83,520	83,520
II	Kontrata mbi 200 m ²						
6	Shoqëria "F..."	VKB nr. 16, datë 09.10.2019	Nr. 20746 Prot., datë 22.11.2021	1,131	99,000	13,572	13,572
	Total					502,164	502,164

Burimi: Drejtoria Juridike, Bashkia Shkodër.

Për këto kontrata qiraje është përlogaritur detyrim për vitin 2022 në vlerë 502,164 lekë, arkëtuar

100% për vitin.

Për vitin 2022, bazuar në të dhënat e sistemit të taksave dhe tarifave vendore, Policia Bashkiake ka vendosur 1,004 gjoba në vlerë totale 1,287 mijë lekë. Nga këto gjoba të vendosura, janë arkëtuar 645 mijë lekë, ose ndryshe 29% e tyre. Arkëtimet e gjobave të vendosura ndaj individë përfaqësojnë 17% të gjobave të vendosura ndaj tyre, ndërsa arkëtimet nga bizneset përfaqësojnë 45% të gjobave të tyre. Në këtë kuadër, paraqitet një nivel i ulët i arkëtimit të tyre, pra nuk janë marrë masa shteruese për arkëtimin e gjobave të papaguara. Mbështetur në nenin 13 të Ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar, “Për shkeljet e vërejtura punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës kanë të drejtë të gjobitin në vend personat përgjegjës në masën 500 deri në 5000 lekë. Kundërvajtësit janë të detyruar të paguajnë gjobën brenda 5 ditëve nga data e dhënies. Për çdo ditë vonesë gjoba paguhet me kamatë 2 për qind. Me kalimin e afatit njëmuajor, gjoba vilet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin “Për kundërvajtjet administrative”; duke vijuar me përcaktimin e bërë në pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, si dhe Kreun IV.3.8 në Paketën Fiskale të Bashkisë Shkodër.

Këto sjellin mangësi në arkëtimin e gjobave të vendosura duke shkaktuar të ardhura të munguara, për shkak të moszbatimit të kuadrit ligjor të fushës dhe mos ndjekjes së procedurave shteruese për arkëtimin plotësisht të gjobave.

Gjoha të Policisë Bashkiake

		Gjoha të vendosura	Gjoha të arkëtuara	Gjoha të pa arkëtuara
Individë	Në numër	1,004	180	824
	Në vlerë (lekë)	1,287,000	220,000	1,067,000
Biznes	Në numër	107	37	70
	Në vlerë (lekë)	938,560	425,560	513,000
TOTAL	Në numër	1,111	217	894
	Në vlerë (lekë)	2,225,560	645,560	1,580,000

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

Ndër vite, nga mos pagesa e gjobave të Policisë Bashkiake janë krijuar detyrime të prapambetura në formën e gjobave të papaguara dhe kamatëvonesave. Gjatë vitit 2022, rezulton se janë krijuar detyrime të prapambetura për vitin në vlerën 513 mijë lekë për bizneset dhe 9,301 mijë lekë për individë (gjoba dhe kamatëvonesa në këtë rast), rreth 3.26% e detyrimit total të krijuar gjatë vitit për taksa dhe tarifa vendore. Duke qenë se gjatë vitit për gjobat e Policisë Bashkiake janë arkëtuar gjithsej 775 mijë lekë, rezulton se për detyrimet e prapambetura progresive ndër vite janë arkëtuar 129 mijë lekë.

Ndërsa, sa i takon Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit rezulton se gjatë vitit 2022 janë vendosur në total 43 gjoba në vlerë 121,824 mijë lekë dhe janë arkëtuar 1,550 mijë lekë ose ndryshe 1.3%. Niveli i arkëtimit të gjobave të vendosura për individë është 0.3% ndërsa niveli i arkëtimit për gjobat e IMT ndaj bizneseve është 18.7%.

Gjobat e vendosura nga IMT

Emërtimi	Njësia	Gjoha të vendosura	Gjoha të arkëtuara	Gjoha të pa arkëtuara
Individë	Në numër	37	6	31
	Në vlerë (lekë)	115,674,000	400,000	115,274,000
Biznes	Në numër	6	5	1
	Në vlerë (lekë)	6,150,000	1,150,000	5,000,000
TOTAL	Në numër	43	11	32
	Në vlerë (lekë)	121,824,000	1,550,000	120,274,000

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH.

Për vitin 2022 janë krijuar detyrime të prapambetura (gjoba dhe kamatëvonesa) në vlerën 115,274 mijë lekë për individët dhe 5,000 mijë lekë për bizneset, ose ndryshe 51% e detyrimit total të krijuar gjatë vitit për taksa dhe tarifa vendore. Për detyrimet e prapambetura progresive

rezulton se janë arkëtuar gjithsej 1,867 mijë lekë, pasi të ardhurat totale nga gjobat e IMT gjatë vitit 2022 rezultojnë 3,417 mijë lekë.

Debitorët e taksave dhe tarifave vendore. Lidhur me debitorët përgjatë vitit 2022 për taksa dhe tarifa vendore, nga të dhënat e Drejtorisë së të Ardhurave paraqitet situata si më poshtë:

Të dhëna mbi kategoritë e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore

Në 000 lekë

Lloji i njësisë	31.12.2021	Pakësime	Shtesa	31.12.2022	Në % ndaj totalit
BIZNESE	777,461	851,757	834,114	759,818	44.75%
Taksë ndërtese	111,483	119,917	154,455	146,021	8.60%
Taksë tabelle	6,534	13,670	14,377	7,241	0.43%
Taksë pastrimi	138,599	142,432	184,203	180,370	10.62%
Taksë ndriçimi	25,385	39,673	47,469	33,181	1.95%
Tatimi i biznesit të vogël	11,052	-	-	11,052	0.65%
Taksë hoteli	17,221	15,270	20,218	22,169	1.31%
Të tjera	467,187	520,795	413,392	359,784	21.19%
FAMILJARE	775,803	54,889	217,207	938,121	55.25%
Taksë e tokës bujqësore	586	280	265	571	0.03%
Taksë pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi	6,520	6,796	7,402	7,126	0.42%
Taksë ndërtese	3,282	2,204	2,840	3,918	0.23%
Të tjera	765,415	45,609	206,700	926,506	54.57%
TOTALI	1,553,264	906,646	1,051,321	1,697,939	100.00%

Burimi: Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër.

Problematika lidhur me situatën e debitorëve dhe arkëtimit të detyrimeve të tyre.

Nga analizimi i të dhënave, konstatohet se gjatë vitit janë krijuar më shumë debitorë të rinj (në vlerë) sesa janë pakësuar, duke arritur të mblidhen më pak të ardhura dhe të gjenerohen detyrime nga ana e subjekteve biznese apo familje. Shtesa më e madhe e detyrimeve është nga familjarët, të cilët përbëjnë 55.25% të vlerës totale të debitorëve. Nga auditimi konstatohet se për vitin 2022 janë krijuar debitorë të rinj si biznese në vlerë 122,377 mijë lekë ndërsa progresivi i debitorëve biznese deri në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 759,818 mijë lekë.

Sa i takon individëve/familjarëve rezulton se gjatë vitit 2022 janë krijuar debitorë të rinj në vlerën 178,946 mijë lekë dhe progresivi i debitorëve deri më 31.12.2022 paraqitet në vlerë 938,121 mijë lekë. Në total, debitorët deri në 31.12.2022 të të dyja kategorive (biznese dhe individë) paraqiten në vlerë totale 1,697,939 mijë lekë. Në këtë kuadër, rezulton se nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave nuk janë marrë masa shteruese për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura ndër vite të debitorëve si dhe rezulton shtim i debitorëve më shumë sesa pakësim i tyre. Referuar Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 4 përcakton se “Bashkitë dhe organet tatimore të pushtetit qendror i ushtrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre fiskale për taksat vendore, në përputhje me ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, e çdo akt tjetër detyrues për sistemin tatimor në Republikën e Shqipërisë, për aq sa këto të fundit nuk bien në kundërshtim me këtë ligj dhe meligjin “Për vetëqeverisjen vendore”. Ndërsa neni 34, i po këtij Ligji citon se “Shkeljet e dispozitave për taksat e tjera vendore, që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënimet përkatëse përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Neni 12 i Ligjit nr. 168/2017 “Për financiar e Vetëqeverisjes Vendore” përcakton se “Njësitë e vetëqeverisjes vendore krijojnë, mbajnë dhe përditësojnë Regjistrin e Personave Fizikë dhe Juridikë që kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifat vendore, sipas kategorisë së detyrimeve tatimore...”

Këto kanë sjell efekt në krijimin e detyrimeve të prapambetura përgjatë vitit 2022 dhe mungesë e arkëtimit të debitorëve të krijuar gjatë viteve në vlerën totale 1,697,939 mijë lekë, për shkak të mos marrjes së masave shtrënguese për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura lidhur me taksat dhe tarifat vendore.

Arkëtime dhe debitorë për vitin 2022.

Në lekë

Emërtimi	Detyrim i lindur gjatë vitit (A)	Pakësime (B)	Debitorë për 2022 (C)	Detyrime të papaguara (%) (C)/(A)
----------	----------------------------------	--------------	-----------------------	-----------------------------------

2022	741,805,601	(619,429,034)	122,376,567	16.50%
Gjobë IMT 2022	6,150,000	(1,150,000)	5,000,000	81.30%
Kamatëvonesë	353,820	(231,601)	122,219	34.54%
Gjopa P. Bashkiake biznes	938,560	(425,560)	513,000	54.66%
Infrastruktura Ndërtim të reja	94,053,927	(93,225,267)	828,660	0.88%
Bashkia Shkodër 2022	640,309,294	(524,396,606)	115,912,688	18.10%
Total debitorë biznes 31.12.22	833,873,284	(851,757,084)	759,818,141	
2022	211,098,716	(32,152,575)	178,946,141	84.77%
Gjobë IMT 2021	115,674,000	(400,000)	115,274,000	99.65%
Policia Bashkiake individ 2022	1,287,000	(221,000)	1,066,000	82.83%
Kamatëvonesa IMT	33,903,900	-	33,903,900	100.00%
Kamatëvonesa Gj. Polici Bashkiake	8,257,000	(22,040)	8,234,960	99.73%
Legalizime	30,695,176	(12,326,177)	18,368,999	59.84%
Tarifa e Çerdheve	4,937,029	(4,552,570)	384,459	7.79%
Tarifa e kopshteve	9,840,275	(8,646,388)	1,193,887	12.13%
Individ debitorë 2022	6,504,336	(5,984,400)	519,936	7.99%
Total debitorë familje 31.12.22	217,206,968	(54,889,103)	938,120,848	
Total debitorë (biznes + familje) 31.12.22	1,051,080,252	(906,646,187)	1,697,938,989	

Burimi: Të dhënat nga Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

Nga auditimi i llogarisë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm” të pasqyrave financiare të Bashkisë Shkodër për vitin 2022, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Shkodër për arkëtim ndaj të tretëve, është në vlerën 1,699,833,317 lekë duke përfshirë detyrime si më poshtë:

- Detyrime mbi 10 vjet, nga viti 2006 deri 2013 në vlerën 174,834,692 lekë ose 10.3% të vlerës së debitorëve kur sipas pasqyrave përmblendhëse të debitorëve për këtë periudhë gjatë vitit 2022 nuk është arkëtuar asnjë vlerë.
- Detyrime mbi 5 vjet, nga viti 2014 deri 2018 në vlerën 652,553,779 lekë ose 38.4% të vlerës së debitorëve kur sipas pasqyrave përmblendhëse të debitorëve për periudhën e mësipërme gjatë vitit 2022 është arkëtuar vlera 3,136,357 lekë ose 0.5% e vlerës së vitit 2021.
- Detyrime të krijuara nga viti 2019 në vlerën 142,880,777 lekë ose 8.4% të vlerës së debitorëve kur sipas pasqyrave përmblendhëse të debitorëve për periudhën e mësipërme gjatë vitit 2022 është arkëtuar vlera 8,535,772 lekë ose 5.6% e vlerës së vitit 2021.
- Detyrime të krijuara nga viti 2020 në vlerën 127,126,208 lekë ose 7.5% të vlerës së debitorëve kur sipas pasqyrave përmblendhëse të debitorëve për periudhën e mësipërme gjatë vitit 2022 është arkëtuar vlera 14,230,988 lekë ose 10% e vlerës së vitit 2021.
- Detyrime të krijuara nga viti 2021 në vlerën 299,220,825 lekë ose 17.6% të vlerës së debitorëve kur sipas pasqyrave përmblendhëse të debitorëve për periudhën e mësipërme gjatë vitit 2022 është arkëtuar vlera 120,270,046 lekë ose 28% e vlerës së vitit 2021.
- Detyrime të krijuara nga viti 2022 në vlerën 303,217,036 lekë ose 17.8% të vlerës së debitorëve.

Sa shihet nga të dhënat sipas pasqyrës rezulton se detyrime deri në një vit janë 303,217,036 lekë ose 17.8% kurse diferenca prej 1,396,616,281 lekë janë për një periudhë mbi një vit.

Detyrimet e mësipërme janë pasqyruar në përputhje me udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c” “Njësitë e qeverisjes së përgjithshme që janë të ardhurat në kontabilitet sipas paragrafit 21, administrojnë të drejtat për tu arkëtuar dhe debitorët e njësisë si më poshtë:

Për konstatimin paraprak të të drejtave për tu arkëtuar debitorët përkatëse të klasës 4 (411/468) “debitorë të ndryshëm dhe kreditohet llogaria 470 “llogari në pritje – të ardhura për tu marrë”.

- Detyrimet mbi 5 vjet, nga viti 2006 deri 2018 janë në vlerën 837,388,471 lekë ose 49.3% të vlerës së debitorëve për vitin 2022 të cilat kanë plotësuar afatin 5 vjeçar të parashkrimit pasi

nuk ka ndonjë dokumentacion nga Bashkia mbi fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese si ankimi i detyrimit tatimor; kontrolli ose hetimi zyrtar nga administrata tatimore ose objekt i një çështjeje penale në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “*për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, Neni 100 “*Parashkrimi i së drejtës për fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese*” 1. E drejta për fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese, sipas këtij kreu, parashkruhet brenda 5 viteve nga data kur detyrimi tatimor i papaguar duhet të kryhej. 2. Afati i parashkrimit, i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, ndërpritet gjatë periudhës: a) së ankimimit të detyrimit tatimor; b) kur detyrimi tatimor është objekt i një kontrolli ose hetimi zyrtar nga administrata tatimore; c) kur detyrimi tatimor është objekt i një çështjeje penale.

- Debitorë në vlerën prej 704,798,020 lekë janë gjoba nga IKMT, policia bashkiake dhe kamatëvonesat ose 41.5 % të totalit viti 2022 të cilat nuk janë paraqitur në llogarinë 709 “Kamatvonesat” në kundërshtim me udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 5, llogaria 709 “*kamatvonesat*” sipas strukturës kamatvonesat dallohen më vete për sistemin tatimor dhe më vete për sistemin doganor.

Llogaria nr. 401-404 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” është në vlerën 124,641,314 lekë. Detyrimet e prapambetura deri në dhjetor 2022 janë 3.93% e shpenzimeve totale të miratuara në Bashkinë e Shkodrës, duke dëshmuar për një situatë normale financiare. Situata është nën mesataren e vëzhguar mes të gjitha bashkive (8.7%) dhe nën treguesin e totalit të njërive vendore (6.28%). Shpenzimet totale të miratuara janë 3,172,613,000 lekë kurse detyrimet e prapambetura janë 173,041,522 lekë (48,400,208 + 124,641,314) = 3.93%.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/5, datë 08.03.2024 nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 973/6, datë 09.04.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

- *sqarojmë se kamatëvonesat sipas rekomandimit janë pasqyruar në llog. 709 “kamatëvonesat” kjo sipas shkresës nr. 6286 prot. Datë 27.03.2024 dërguar degës së thesarit.*

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/6, datë 09.04.2024 grupi i auditimit gjykon se:

Gjykojmë se nga Bashkia Shkodër ka sjellë argumente të qenësishme të cilat ndikojnë në konstatimet tona. Për sa më lart komentet merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

Nga auditimi ka rezultuar se, janë hartuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022. Mbas miratimit në sistem të regjistrat nga APP, me shkresa përcjellëse janë dërguar në Degën e Thesarit, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi mbështetur në VKB përkatëse “*Mbi miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Shkodër*”. Gjithashtu në të gjitha rastet e shtesave dhe pakësimeve është dërguar regjistri përkatës. Në këto regjistra janë pasqyruar shtesat dhe ndryshimet e bëra sipas VKB –ve përkatëse.

NJP dhe NZ, kanë vepruar në përputhje me VKM, nenin 4 “*Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik*”, pika 1. Dërgimi i regjistrat të parashikimeve në APP, është bërë brenda afateve të përcaktuara në VKM nr. 914, neni 4, pika 3, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, në nenin 3, pika 6.

Nga auditimi ka rezultuar se gjatë periudhave ka patur ndryshim të regjistrat të parashikimeve, për të cilat është bërë buxhetimit i tyre. Të gjitha ndryshimet janë hedhur në SPE, referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 4, pika 4, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, në nenin 3, pika 7.

Për kryerjen e auditimit mbi disponimin e fondeve dhe angazhimin e tyre për kryerjen e procedurave të prokurimit publike për periudhën objekt auditimi, nga Grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Buxheti i viteve 2021-2022, miratuar me Vendimeve të KB nr. 26, datë 30.12.2019 (për vitin 2020) dhe nr. 03, datë 05.01.2022 (për vitin 2022) me ndryshimet e mëvonshme;
- Plani përfundimtar (fillestar me ndryshime);
- Realizimi i Buxhetit të periudhës 2021-2022;
- Regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike, periudha 01.01.2021 – 31.12.2022;
- Regjistri i realizimeve të prokurimeve publike, periudha 01.01.2021 – 31.12.2022.

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, janë nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifatat vendore, të ardhura të tjera, donacione dhe të ardhura që trashëgohen.

Në mënyrë tabelore të dhënat mbi procedurat e prokurimeve për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2022, paraqitet si më poshtë vijon.

Mbi realizimin e prokurimeve periudha 01.01.2021 – 31.12.2022

Lloji i procedurës	Nr. Proc	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Fondi total i kursyer pa TVSh	% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit
Hapura	119	921,283,278	557,575,421	363,707,857	39
Kërkesë me propozim	39	174,329,740	150,518,697	23,811,043	14
Negocim pa shpallje	2	127,497,176	126,072,929	1,424,247	1
Blerje bileta (marrëveshje kuadër)	4	2,298,166	321,990	1,976,176	86
Blerje me vlera të vogla	78	28,809,046	20,812,584	7,996,462	28
Shuma procedura sipas llojit	242	1,254,217,406	855,301,621	398,915,785	32
Procedura sipas objektit	Nr.	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	% ndaj total lloje	
				Fond limit	Kontratës
Ne fushën e ndërtimeve	97	759,633,755	491,697,358	61	57
Në shërbime/ blerje, etj.	145	494,583,651	363,604,263	39	43
Procedura te vlerësuara për auditim	Nr.	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	% ndaje total lloje	
				Fond limit	Kontratës
Hapura	10	228,940,834	214,276,698	25	38
Kërkesë me propozim					
Shuma vlerësuar për auditim	10	228,940,834	214,276,698	25	38

Burimi: Të dhëna të Bashkisë Shkodër, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga Bashkia Shkodër, për periudhën 01.01.2021–31.12.2022, parashikimi dhe realizimi i prokurimeve publike është kryer vetëm pasi janë vënë në dispozicion fondet buxhetore. Nuk kanë rezultuar tejkalime të planit të buxhetit të miratuar, veprime në përpunime me LPP, me VKM nr. 807, datë 16.11.2016 “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore”, me UMF nr. 2 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Kapitulli III “Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike”; “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike”, pika nr. 140, dhe me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 40 “Shpenzimet”, pika 3. Sipas të dhënave të pasqyrës mësipërm, konstatohet se 61% e fondeve janë adresuar për investime, kryesisht riparim rrugësh dhe 39% e fondit janë adresuar për blerje dhe shërbime të tjera.

1. Për auditimin mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit publik me objekt “Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë Shkodër” 2021, si dhe zbatimi i kontratës mëparshme dhe kësaj kontrate.

Për këtë procedurë dhe zbatim kontrate u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë :

1. Dosja e dokumentacionit fizik të procedurës së prokurimit “Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë Shkodër” 2021;

2. Sistemi i Prokurimit Elektronik (SPE) të bashkisë Shkodër, për këtë procedurë prokurimi;
3. Informacion dhe dokumentacion nga bashkia mbi realizimin e kontratës së “Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë Shkodër” 2018-2021 dhe 2021 - 2024;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Procedura e prokurimit me objekt: “Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë Shkodër”, me burim financimi buxhetin e bashkisë, me fond të parashikuar 102,990,833 lekë, me fond limit dhe fond të preventivuar 102,951,380 lekë pa TVSH, ka objekt të kontratës ”Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë e Shkodrës”, me afat 36 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Hartimi i preventivit për 12 muaj dhe jo për gjithë periudhën e ofrimit të shërbimit prej 36 muaj, duke e shumëzuar shumën e preventivit vjetor me 3 vite ka sjellë për pasojë rrezikun e interpretimit të gabuar në zbatim të saj dhe mospërputhje me specifikimet teknike. Para së gjithash, preventivi përgatitet për gjithë periudhën (siç është vepruar në tenderin e periudhës 2018 - 2021), pasi i përgatitur në këtë mënyrë mbi baza vjetore, kuptohet që sasi të ngelen të pandryshuara në secilin prej tre viteve dhe trefishohen vlerat. Por kjo nuk është e tillë për:

- Mbjelljen e drurëve dekorativë, pasi sipas specifikimeve teknike janë përcaktuar 200 copë në vit, çka do të thotë 600 gjithsej;
- Mbjelljen e shkurreve dekorative sipas specifikimeve teknike janë parashikuar të mbillen 120 copë në vit, çka do të thotë se do të jenë 360 gjithsej.

Hartuesit e fondit limit nuk i janë referuar specifikimeve teknike për sasinë e zëvendësimit dhe shtimit të stolave dekorativë dhe zëvendësimit dhe shtimit koshave. Kjo pasi, sipas pikës 14 dhe 15 të specifikimeve teknike të DT, është parashikuar mesatarisht vendosja e 70 copë stola të rinj dhe 70 kosha sipas planit të miratuar nga njësia e monitorimit të shërbimeve publike pa përcaktuar afatin një vjeçar si në rastet e cilësuara më sipër, çka do të thotë se këto sasi janë për një periudhë tre vjeçare.

Sipas procesverbalit për llogaritjen e fondit limit dhe përgatitjen e specifikimeve teknike nr.11392 prot., datë 06.07.2021 nga personat përgjegjës për llogaritjen e fondit limit Ing. F.K. dhe specialist B.F., për secilin proces pune janë hartuar analizat e kostos për njësi shërbimi dhe grafikët e punës sipas proceseve. Në bazë të situatës së gjelbërimit për llogaritjen e vlerës limit të kontratës, çmimet për njësi të volumeve të shërbimit në preventivin e propozuar për zërat 10, 11, 12, 14, 15 çmimet janë marrë nga Manuali i MPPRRRT sipas VKM nr.629, datë 15.07.2015 ndërsa për zërat e tjerë janë hartuar analiza çmimesh, duke marrë parasysh VKM nr.1025, datë 16.02.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, ndërsa për zërat 19 dhe 20, çmimet janë marrë nga testimi i tregut, sipas procesverbalit për testimin e tregut datë 09.06.2021.

Në dosje ndodhet preventivi për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta për periudhë 36 mujore (referoju Aneks1), i përgatitur dhe i firmosur nga ing. F.K. dhe specialisti B.F., me 20 zëra shërbimesh, me tregues për njësi, sasi, çmim dhe vlerë për një periudhë 12 mujore në shumën prej 34,317,127 lekë; TVSH vjetore 20 % në vlerën prej 6,863,425 lekë, dhe shumë vjetore me TVSH 41,180,552 lekë; shuma tre vjeçare pa TVSH 102,951,380 lekë, TVSH 20% për tre vite në vlerën 20,590,276 lekë, me shumën gjithsej të fondit limit për 3 vite prej 123,541,656 lekë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të analizave të kostos të hartuara për njësi shërbimi, rezulton se normat e punës janë marrë nga “Libri i normave për sektorin e gjelbërimit” i Ministrisë së Ekonomisë Komunale viti 1989, në një kohë që bashkia Shkodër e ka realizuar në mënyrë të suksesshme një kontratë të tillë për një periudhë trevjeçare 2018-2021.

Në këtë mënyrë personat përgjegjës për llogaritjen e fondit limit Ing. F.K. dhe specialist B.F., nuk kanë zbatuar nenin 76, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pasi në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, nuk i janë referuar çmimeve të kontratës së mëparshme të realizuara nga vetë autoriteti kontraktor (germa “b” e nenit). Gjithashtu, nuk mund të konsiderohen çmime zyrtare ato që burojnë nga Libri i normave për sektorin e gjelbërimit” i Ministrisë së Ekonomisë Komunale të vitit 1989 ku kanë kaluar disa dekada në zhvillimin teknologjik dhe ekonomik. Për më tepër që, autoriteti kontraktor mund t’i referohet një ose më shumë alternativave në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes të sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në dosje janë vendosur analizat nga An-1 deri në An-12, të nënshkruara nga hartuesit ing. F.K. dhe specialisti B.F., ku në secilën prej tyre, janë llogaritur shpenzimet për punëtori, mbi bazën e pagës orare, rendimentit orar, numrit të ndërhyrjeve për secilin proces pune, shpenzimet gjithsej për punëtori dhe shtuar 16.7 % kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore; shpenzime transporti, materiale, dhe mbi shumën e këtyre treguesve janë llogaritur shpenzime plotësuese 4 %, dhe pastaj mbi shumën e rezultuar është llogaritur 10% fitim. Totali i këtyre shpenzimeve i pjesëtuar me sasinë përkatëse të zërave të preventivit ka përcaktuar çmimin për njësi.

Në fund të analizave të përgatitura është cituar “Normat e punës janë marrë nga “*Libri i normave, për sektorin e gjelbërimit*”, i Ministrisë së Ekonomisë Komunale, viti 1989”, me përjashtim të An-8-Mirëmbajtje e stolave dekorativë.

Nga shqyrtimi i 12 analizave për procese pune të ndryshëm të këtij preventivi të përgatitura nga ing. F.K. dhe specialisti B.F., përcaktimi i rendimentit orar (Normat e punës) sipas “*Libri i normave për sektorin e gjelbërimit*” i Ministrisë së Ekonomisë Komunale, viti 1989”, pas një periudhe mbi 30 vjeçare me një ndryshim të ndjeshëm të pajisjeve teknologjike për operimin e proceseve të punës dhe për rrjedhojë dhe të rendimentit orar, ka sjellë për pasojë mangësi në argumentimin e fondit limit, me efekt në rritjen e pa bazuar të tij.

Në këtë mënyrë, edhe procesverbali mbi llogaritjen e fondit limit dhe përgatitjen e specifikimeve teknike nr.11392 prot., datë 06.07.2021, duke cilësuar se janë bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 76, duke ju referuar çmimeve të botuara nga INSTAT, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim, nuk qëndron, pasi për 12 analiza shpenzimet për punëtorinë të cilat përbëjnë 60% të fondit limit, nuk janë të referuar në institucione apo dokumentacion të njohur ligjrisht.

Sipas këtij procesverbali, preventivi ka rezultuar me fond limit 102,951,379 lekë pa TVSH, dhe më pas janë përcaktuar specifikimet teknike dhe nënshkruar nga personat përgjegjës për llogaritjen e fondit limit ing. F.K. dhe specialisti B.F.

Në fund të preventivit është cilësuar se për zërat e shërbimeve 10, 11, 12, 14 dhe 15 janë sipas manualit të VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” i ndryshuar. *Personat përgjegjës për llogaritjen e fondit limit për këtë kontratë shërbimi kanë vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 15, pika 3 germa (c) të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi preventivat janë pjesë e informacionit specifik të kontratave për punë dhe jo për kontratat e shërbimeve.*

Për zërat 10, 11 dhe 12, përkatësisht: Mbjellje drurë dekorativ (në lulishte dhe gjelbërim rrugor); Mbjellje shkurre dekorative (oleandër) dhe F.V Lule sezonale, referenca në manualin e çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, nuk është e plotësisht e saktë, pasi nuk ka përputhje të kërkesave teknike të veçanta për secilin rast, pasi është mbjellje jo vetëm në gjelbërim rrugor por edhe në lulishte.

Për zërat e shërbimeve 14 dhe 15 përkatësisht: “*Shërbimi i mirëmbajtjes së rrugës së Kalasë (shkulje rrënjëve bimëve të vogla)*” me çmim manuali 34 lekë/m²/vit, dhe “*Shërbim i mirëmbajtjes së rrugës së Shirokës dhe bregut të Liqenit, (prerje bimë të vogla)*” me çmim manuali 14 lekë/m²/vit, referenca në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 i ndryshuar, nuk është e saktë, pasi manuali i referohet punimeve të shpyllëzimit në punimet e ndërtimit të rrugëve, dhe jo të shërbimit të mirëmbajtjes rrugore për të cilin është marrë në referencë për përcaktimin e fondit limit.

Në rastin e specifikimeve teknike të Shërbimit të mirëmbajtjes së rrugës së Kalasë (shkulje rrënjëve bimëve të vogla) nuk është përcaktuar gjatësia e rrugës, por vetëm sipërfaqja gjithsej prej 9 440 m², për 5 ndërhyrje në vit, si dhe tek specifikimet teknike nuk cilësohet shkulja e

rrënjëve të bimëve të vogla, por “mirëmbajtja dhe shërbimi që i bëhet gjelbërimit të kësaj zone”, pra ka mospërputhje të specifikimeve teknike me përlogaritjet e fondit limit dhe me ndikim në këtë të fundit. Për më tepër që në periudhën 2018 - 2021, kësaj sipërfaqeje i janë shkukur rrënjët e bimëve të vogla 15 herë.

Shërbim i mirëmbajtjes së rrugës së Shirokës dhe bregut të Liqenit (prerje bimë të vogla)-zëri 15 i preventivit, sipas manualit teknik të punimeve të ndërtimit, iu referohet bimëve të vogla me diametër Ø -10 cm, gjë e cila është ezauruar edhe në kontratën e periudhës 2018-2021 pasi ky proces pune është kryer 18 herë, duke penguar rritjen bimëve të vogla me diametër deri në 10 cm.

Referuar specifikimeve teknike në DT, për këtë rrugë “Ndërrhyrja e cila do të realizohet në mirëmbajtjen e 4 km gjatësi lineare përmban këto procese:

a-Pastrimi i të gjithë rrugës pedonale të biçikletave gjatë bregut të liqenit, duke e pastruar nga barërat që dalin në mes të pllakave dhe anash bordurave të trotuareve. Është llogaritur që të bëhen gjashtë ndërhyrje gjatë gjithë vitit për këtë shërbim, sipas një grafiku të detajuar të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

b-Pastrimi i bregut të liqenit dhe anash rrugës prej shkurreve të vogla dhe bimësisë së lartë. Kjo sipas grafikut të drejtorisë së shërbimeve Publike për ndërhyrje dy herë në vit.”

Në këtë tender, krahasuar me atë të periudhës 2018-2021, është shtuar dhe zëri 16 “Pastrimi i bregut të liqenit (pjesa ujore) prej pa pastërtive, alga, mbeturina druri, plastike etj.”, me sipërfaqe 20 000 m², në vlerën e fondit limit 1,266,000 lekë (pa TVSH). Sipas specifikimeve teknike “Duke marrë në konsideratë pa pastërtitë e mëdha që mbliidhen në breg të liqenit, si dhe algat që krijohen prej ujit, mbetje druri e plastike, bëhet e domosdoshme pastrimi i bregut të ujit. Është parashikuar që ky shërbim të kryhet në një gjatësi prej 1 km dhe në thellësi uji deri në 20 metra. Ky shërbim do kryhet 2 here në vit. Shërbim do të kryhet në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, sipas një grafiku të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, për vendin e shërbimit dhe kohën e kryerjes së këtij shërbimi.”

Gjithashtu, në analizën për këtë zë An-11 të përgatitur nga ing. F.K. dhe Specialisti B.F., janë parashikuar shpenzime me lundër për afrimin në breg të mbetjeve, në një kohë që nuk është përfshirë në kapacitetin teknik disponimi i këtij mjeti nga OE pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Në preventiv, krahasuar me atë të periudhës 2018 - 2021, është shtuar zëri 19: “Zëvendësim dhe shtim stolash dekorativ”, me fond limit 5,607,000 lekë për tre vite, i cili nuk ka qenë në kontratën e mëparshme, me specifikime teknike: “Krahas mirëmbajtjes së stolave dekorativ është parashikuar të bëhet zëvendësimi i stolave të amortizuar ose të dëmtuar rëndë, si dhe plotësimi i tyre në hapësirat e lulishteve ku mungojnë në qytet dhe Njësitë Administrative. Parashikohen mesatarisht vendosja e 70 copë stola të rinj sipas planit të miratuar nga njësia e monitorimit të shërbimeve publike /Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes të Investimeve të Infrastrukturës dhe llojit që do të përcaktohet në lulishten përkatëse.”

Vendosja e këtij zëri, duke cilësuar zëvendësimin e stolave të amortizuar, kur për periudhën 2018 -2021 për 319 stola janë shpenzuar mesatarisht 7,070 lekë për copë për mirëmbajtje në tre vjet, në një kohë që sipas studimit të tregut të bërë nga specialistët e mësipërm një stol dekorativ, furnizim dhe vendosje kushton 26,000 lekë. Për zërin e mirëmbajtjes së stolave dekorativë në specifikimet teknike të tenderit të vitit 2021 cilësohet: “Në pjesën më të madhe të sipërfaqeve të gjelbra (lulishte) krahas elementeve të tjerë janë vendosur edhe stola dekorativ për çlodhjen e qytetarëve do të bëhet mirëmbajtja e tyre. Këto stola janë të ndërtuar me konstruksion metalik dhe me ndenjësë e mbështetëse druri, si dhe me konstruksion betoni dhe ndenjësë druri. Është llogaritur që çdo vit të bëhet riparimi i tyre. Riparimet konsistojnë në elementet metalike dhe ato të drurit mbasi ka dëmtime të tyre dhe në kushtet atmosferike të këqija struktura e dërrasës ka nevojë për riparime dhe lyerje me bojë vaji. Do të mirëmbahen gjatë gjithë vitit 464 copë stola dekorativ”.

Në preventiv vijojnë shpenzimet e mirëmbajtjes së stolave dekorativë, numri i të cilëve në këtë tender është 464 nga 369 që ishte në kontratën e periudhës 2018-2021, pra me një sasi shtesë

prej 95 stola të rinj për mirëmbajtje pa një dokumentacion mbështetës dhe justifikues se si janë shtuar dhe nga kanë ardhur këto asete.

Mirëmbajtja e 464 copë stolave dekorativë, si dhe zëvendësimi dhe shtimi i tyre me të rinj për gati gjysmën e tyre (210 copë) në mungesë të një plani vendosjeje të tyre, ka sjellë për pasojë mungesë saktësie në përllogaritjen e nevojave për këtë zë shërbimi të ofrimit të gjelbërimit, duke shtuar këtu të njëjtën çështje dhe për koshat e mbeturinave.

Në kapacitetet teknike në DT nuk është parashikuar për OE pjesëmarrës në tender disponimi i punëtorëve të specializuar për kryerjen e riparimeve të stolave dekorativë, duke sjellë për pasojë mungesën e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike, buxhetit të bashkisë.

Në dosje ndodhet një procesverbal i datës 09.06.2021 mbi testimin e tregut për shërbimin *“Zëvendësim dhe shtim stolash dekorativ dhe kosha të vegjël për lulishte”* nga komisioni i ngritur me Urdhrin e brendshëm nr.31, datë 12.01.2020 *“Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e specifikimeve teknike, testimin të tregut, llogaritjes së fondit limit, hartimit të preventivave, marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve, ndjekjes së zbatimit të kontratave për procedurat e prokurimit publik, me çmimet për tre subjekte: “M...” SHPK, “K... k...” dhe “F...” SHPK,”* të firmosur nga komisioni ing. F.K. dhe specialisti B.F., shoqëruar me ofertat pa datë të këtyre subjekteve.

Sipas preventivit për zërat 19 dhe 20, përkatësisht *“Zëvendësim dhe shtim stolash dekorativ”* dhe *“Zëvendësim dhe shtim koshash”*, çmimet mesatare janë vendosur sipas testimin të tregut nga ofertat e tre subjekteve, për të cilat nuk janë shoqëruar me projekt secili prej tyre, nuk është përcaktuar në se stolat do të jenë me konstrukcion metalik apo betoni, si dhe pa shqyrtuar më parë në se e kanë ose jo pjesë të aktivitetit të ligjshëm prodhimin dhe montimin e stolave dekorativ dhe të koshave. Për më tepër, dhe OE i shpallur fitues ka rezultuar se gjatë testimin të tregut ka dhënë çmimet përkatësisht 32,200 lekë dhe 5,000 leke dhe në ofertë ka sjellë çmimin 26,000 lekë dhe 4,500 lekë, duke e bërë një proces formal vendosjen e kësaj vlere në preventiv, me pasojë mungesë efektiviteti në përdorimin e fondeve publike. Këto veprime dhe mos veprime të grupit të punës për llogaritjen e fondit limit nuk janë në përputhje me kërkesat e nenit 76, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, pasi nuk mund të konsiderohet studim i tregut, një ofertë malli e marrë e pabazuar në specifikimet teknike, projekte dhe sasinë që kërkohet.

Sipas specifikimeve teknike, në pikën 1. Mirëmbajtja e Sipërfaqeve të gjelbra, Proceset e punës: pika 1.k është përcaktuar: *“Luftimi i sëmundjeve(spërkatje): Është një proces që realizohet gjatë muajve maj – qershor dhe ka për qëllim luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve në lulet shumë vjeçare, shkurret, bordurat e gjelbra. Përdoret dhe për luftimin e insekteve të ndryshme për të ruajtur bimësinë dekorative. Spërkatja realizohet dhe në raste të tjera për luftimin e barërave të këqija në sipërfaqet e barit aty ku ka zhvillim të madh të barërave që duhen hequr.”* rezulton se nuk janë parashikuar që OE pjesëmarrës të disponojë teknikën përkatëse, si dhe punonjës të specializuar për kryerjen e këtij shërbimi.

Në analizën 12- Mirëmbajtja e sipërfaqeve ujore (shatërvani), në shpenzimet materiale është përfshirë shpenzimet për ujë për 1 200 m³ për 1 000 m² sipërfaqe për larje me ujë me presion, në një kohë që operatorit ekonomik në kapacitetet teknike nuk i është kërkuar disponimi i autobotit, *por vetëm e një cisterne jo më pak se 2 m³.*

Një zë i rëndësishëm në përbërje të analizave të mirëmbajtjes së lulishteve është transport mbeturina deri në 5 km, i cili është preventivuar në shumën 2,102,500 lekë. Vendosja e këtyre shpenzimeve është e pa argumentuar për efekt të distancës deri në 5 km, pasi nuk është përcaktuar një vend-depozitimi i këtyre mbetjeve.

Në dosje ndodhet procesverbali me nr.1048/6 prot., datë 23.03.2021 për inventarizimin e të gjithë sipërfaqeve të gjelbëra, lulishteve ekzistuese në qytet dhe atyre të reja që janë futur në shërbimin e mirëmbajtjes së gjelbërimit, elementëve të tjerë të lulishteve dhe numrit të pemëve të gjelbërimit rrugor, me 3 pasqyra: sipërfaqet e lulishteve, gjelbërimi rrugor dhe stola e kosha, nënshkruar nga komisioni prej 9 anëtarësh.

Nga krahasimi i sipërfaqeve të gjelbër të inventarizuara në vitin 2021, sipas Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Shkodër nr. 266, datë 17.03.2021, konkretizuar me procesverbalin me nr.1048/6 prot., të datës 23.03.2021 në të cilin janë vlerësuar të gjitha sipërfaqet ekzistuese funksionale të gjelbërta në Shkodër, me të dhënat Raportit teknik të vitit 2018- rezultatet e inventarizimit të dala nga Urdhri i Kryetarit të Bashkisë Shkodër nr. 752, datë 06.10.2017 “Për inventarizimin e sipërfaqeve të gjelbërta dhe gjelbërimit rrugor”, rezultojnë sipërfaqe të cilat nuk janë në eficiencë në vitin 2021, megjithëse janë paguar për shërbime gjatë zbatimit të kontratës 2018-2021, si më poshtë.

Tabela nr. 2.4.2 Sipërfaqet e gjelbëra që nuk kanë rezultuar në eficiencë në mars 2021

Në m²

Emërtimi	Sipërfaqja gjithsej	Sipërfaqja në eficiencë	Paguar 2018-2021	Sipërfaqja paguar më tepër
Për lulishten “Pazar 1” (pas Bixhistenit)	7,408	7,000	7,408	+ 408
Për lulishten “Pazar 3”	6,343	5,800	6,343	+ 543
Për lulishten “Pazar 2”	5,935	-	5,935	+ 5,935
Për lulishten “Gjimnazi 28 Nëntori”	3,235	2,000	3,235	+ 1,235
Lulishte “Zogu i I” përballë bustit Esat Gjyli	571	400	571	+ 171
Lulishte pas pallatit kinez (në afërsi të TV1)	1,242	1,000	1,242	+ 242
Brezi ndarës “Bulevardi Bujar Bishanaku”	-	-	856	856
Lulishte Perash (hyrje rruga e Qaf-hardhisë)	560	-	560	560
Lulishte Sarrreq	190	-	190	190
Lulishte blloku i pallateve rruga Faik Konica	467	350	467	117
Lulishte rruga “7 shaljanët”	800	400	800	400
Lulishte stacioni i trenit	1,090	-	1,090	1,090
Lulishte busti Pashko Vasa	970	582	970	388
Lulishte Vaso Kadia	900	-	900	900
Gjithsej m ²				13,035

Burimi: Të dhëna të dosjes së tenderit të përfunduar nga grupi i auditimit të KLSH

Duke marrë për bazë observacionin e subjektit, dërguar me shkresën nr.16048/28 prot., datë 05.02.2024 nga z. F.K. dhe z. B.F., protokolluar në KLSH me nr. 973/4 prot., datë 05.02.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë: *Në lidhje me konstatimin e diferencës së sipërfaqes efektive të lulishteve në vitin 2021 me ato të vitit 2018 prej 13 035 m², nuk ka të bëjë me llogaritjen e dëmit ekonomik, pasi volumet dhe prioritetet përcaktohen nga autoriteti kontraktor, saktësia është në përgjegjësi të komisioneve të inventarizimit, si dhe pagesat e realizuara janë monitoruar dhe verifikuar sipas ligjshmërisë në përputhje me kushtet e kontratës”, për sipërfaqen e mësipërme prej 13,035 m² e cila nuk ka rezultuar në eficiencë në vitin 2021, grupi i auditimit e merr në konsideratë për pagesat e kryera për shërbimet e dy viteve të para të kontratës, dhe konsideron dëm ekonomik pagesat e kryera për vitin e fundit të kontratës.*

Pra pagesat e kryera për sipërfaqen gjithsej 13.035 m², e detajuar si në vijim: 6 886 m² sipërfaqe tip A, 1 235 m² e tipit B dhe 4 914 m² tipi C, me shpenzime faktike për m² për një vit respektivisht 187, 223 dhe 247 lekë, e cila nuk ka rezultuar në eficiencë në muajin mars të vitit 2021, në total prej **2,773,323 lekë** pa TVSH dhe **3,327,988 lekë** me TVSH konsiderohen dëm ekonomik.

Nga krahasimi i procesverbaleve për përcaktimin e numrit të drurëve dekorativë për ofrimin e shërbimeve në lulishte dhe rrugorë për tenderin e vitit 2021 me atë të vitit 2018, rezulton si më poshtë: Numri i drurëve dekorative të mbjellë dhe shërbyer 2018-2021

Në copë

Emërtimi	2018 -2021	2021	Diferenca
<i>Drurë dekorative në lulishte</i>			
Tipi A	381	641	260
Tipi B	962	1,128	166
Tipi C	277	691	414
Gjithsej	1,620	2,460	840
<i>Drurë dekorative në rrugë</i>			

Tipi 1	2,471	2,986	515
Tipi 2	1,823	1,824	1
Tipi 3	2,049	1,980	(69)
Gjithsej	6,343	6,790	447
Mbjellje 2018-2021	1,381		
Totali	7,724	9,250	1,287

Burimi: Të dhëna të dosjes së tenderit të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Duke i konsideruar mbjellje të reja 840 copë drurë dekorativë në lulishte dhe 515 drurë dekorativë të gjelbërimit rrugor Tipi 1 (0-5 m), rezulton se mbjelljet gjithsej në periudhën 2018 - 2021 kanë rezultuar 1 355 copë nga 1 381 copë të paguara, pra 26 copë më pak (1 381 - 1 355).

Në këtë mënyrë kontraktori "M..." SHPK ka përfituar padrejtësisht për shërbim të pakryera në mbjelljen e pemëve (26 x 10.710 lekë/copë=278,460 + TVSH 20%) për kontratën e periudhës 2018-2021 shumën gjithsej prej **334,152 lekë me TVSH**, e cila përbën dëm ekonomik.

Procedura e prokurimit

Raporti teknik, i strukturuar mbi synimet afatmesme të përmirësimit të shërbimit, vlerësimin e sipërfaqeve të gjelbera që kanë nevojë për mirëmbajtje, monitorimin e shërbimit etj., pa datë është nënshkruar nga ing. F.K. dhe specialisti B.F.

Specifikimet teknike, pa datë janë punuar nga ing. F.K. dhe specialisti B.F., dhe nënshkruar vetëm nga specialisti B.F.

Urdhri i prokurimit nr.639, datë 06.07.2021, me nr.11392/1 prot., ka përcaktuar objektin, fondin limit, financimet sipas viteve, llojin e procedurës, njësinë e prokurimit me përbërje E.D., D.K. dhe B.F., e cila më pas ka mbajtur Procesverbalin me nr.11392/2 prot., datë 08.07.2021. Njësia e prokurimit ka mbajtur Procesverbalin me nr.11392/2 prot., datë 08.07.2021, për argumentimin e realizimit të procedurës me një kontratë, pasi objekti i procedurës është "Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në bashkinë e Shkodrës" Marrëveshje kuadër-me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 36 muaj.

Dokumentet e tenderit në shqip dhe anglisht janë hedhur në sistem më datë 09.07.2021, për datë të zhvillimit të tenderit 12.08.2021.

Urdhri për ngritjen e KVO nr.640, datë 06.07.2021, me nr.1392/4 prot., ka përcaktuar përbërjen: A.Ç., A.L. (jurist) dhe M.M. (specialist i fushës).

Në raportin përmbledhës të datë 07.09.2021, me nr.11392/6, cilësohet se kanë marrë pjesë tre OE:

1. "R..." SHPK me vlerë të ofruar 92,428,860 lekë;
2. "M..." SHPK me vlerë të ofruar 102,656,964 lekë;
3. "P... S..." SHPK i cili nuk ka paraqitur ofertë.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. "R..." SHPK pasi: nuk ka aktivitetin në fushën e veprimtarisë, nuk plotëson kapacitetin teknik për përvojën e mëparshme dhe drejtuesin teknik etj.
2. "P... S..." SHPK pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument.

Mbi këtë bazë, pas dy fazave është përcaktuar OE më i suksesshëm "M..." SHPK duke propozuar shpalljen fitues me vlerë të ofruar 102,656,964 lekë.

Më datë 08.09.2021 ka dërguar ankesë OE "R..." SHPK, marrë nga titullari AK më datë 09.09.2021, kthyer përgjigje më datë 10.09.2021, me cilësimin që është jashtë afateve të ankimit, duke i dërguar informacion dhe KPP në këtë datë për ankesën. KPP i është dërguar informacion dhe me datë 17.09.2021 me dokumentacionin e kërkuar. KPP ka marrë vendimin nr.755/2021 në mbledhjen e datës 13.10.2021 duke mos pranuar ankesën e OE "R..." SHPK, dërguar në bashki më datë 18.10.2021

Kontrata e sipërmarrjes është nënshkruar më datë 08.11.2021, me nr.11392/9 prot., me OE "M..." SHPK.

Në tenderin e kësaj procedure prokurimi datës 12.08.2021 kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “R...” SHPK me NUIS J.....Q me vlerë të ofruar 92,428,860 lekë pa TVSH

2. Operatori ekonomik “M...” SHPK me NUIS J.....Q dhe vlerë të ofruar 102,656,964 leke pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “P... S...” SHPK, i cili nuk ka paraqitur ofertë

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “R...” SHPK për arsye se: nuk ka plotësuar kriterin e kualifikimit, për mungesën e fushës së veprimtarisë, mungesën e shërbimeve të ngjashme, mungesë CV etj.

2. Operatori ekonomik “P... S...” SHPK për arsye se nuk ka paraqitur asnjë dokument

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, është identifikuar operator ekonomik i suksesshëm “M...” SHPK me vlerë të ofruar 102,656,964 lekë pa TVSH.

Në shtojcën 8, kreu 2 -Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3- Kapaciteti teknik, çështja 2.3.5 është përcaktuar: “*Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit të gjelbërimit i cili duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të gjelbërimit shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: a) Diplomë në inxhinieri Mjedisi ose Inxhinieri Pyjesh; b) CV përkatëse dhe c) Kontrate pune*”. Meqenëse shërbimet e preventivuar janë të karakterit mjedisor (lulishte, shkurre dhe pemë) dhe bujqësor, nuk ka qenë e nevojshme dhe as e domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës diplomë në inxhinieri pyjesh, por diplomë në inxhinieri mjedisi ose në agronomi.

Nga dokumentet e dorëzuara nga OE i shpallur fitues “M...” SHPK rezulton se drejtuesi teknik S.H. është në të njëjtën kohë dhe inxhinier pyjesh, fakt që të çon në dyshimin e arsyeshëm, se nga ana e specialistëve që kanë përgatitur kriteret e veçanta të kualifikimit është parazgjedhur fituesi.

Në shtojcën 8, kreu 2 -Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3- Kapaciteti teknik, çështja 2.3.8 është përcaktuar: “*Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore për realizimin e kontratës prej minimalisht 50 persona për muajin e fundit.*” Në dokumentet e dorëzuara në sistem nga OE fitues “M...” lidhur me listë-pagesat prill-korrik rezulton se në muajin prill, maj dhe qershor ka përkatësisht 25, 26 dhe 27 punonjës, në muajin korrik janë regjistruar 50 punonjës, aq sa janë në kërkesat e kapacitetit teknik në DT, nga të cilët 23 prej tyre kanë 2-6 ditë pune, fakt i cili e forcon dyshimin e arsyeshëm se kriteret e veçanta të kualifikimit janë përgatitur posaçërisht për OE fitues.

Në plotësim të kërkesave të Shtojcës 8 të DT, kreu 2 -Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3- Kapaciteti teknik, çështja 2.3.5, OE fitues me anë të deklaratës së administratorit S.H., ka përcaktuar se Drejtues teknik i punimeve do të jetë Ing. Pyjesh S.H., pra në të njëjtën kohë administratori është edhe drejtuesi teknik i zbatimit të kontratës së shërbimeve.

Në plotësim të kërkesave të Shtojcës 8 të DT, kreu 2 -Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3- Kapaciteti teknik, çështja 2.3.6: “*Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik për te paktën 3(tre) muajt e fundit si më poshtë:*

- 1 (një) Inxhinier Pyjesh

- 1 (një) Agronom.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

• *Kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV.*

• *Listë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhura nga punësimi të konfirmuara nga organet tatimore për të paktën 3(tre) muajt e fundit. Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor”, OE fitues për stafin teknik për 1 inxhinier pyjesh, ka paraqitur kontratën individuale të punës të datës 04.01.2010, ndërmjet punëdhënësit “M...” SHPK dhe punëmarrësit (në cilësinë e drejtuesit teknik) z. S.H., e nënshkruar nga Punëdhënësi “M...” SHPK (firma S.H.) dhe*

punëmarrësi Drejtues teknik Ing. S.H., duke firmosur kontratë me veten e vet edhe si administrator edhe si drejtues teknik.

Pra, administratori i OE të shpallur fitues “M...” SHPK z. S.H. është në të njëjtën kohë Drejtues teknik i punimeve edhe i punësuar në stafin teknik në cilësinë e inxhinierit të pyjeve.

Nga sa më sipër, KVO për OE të shpallur fitues “M...” SHPK ka konsideruar plotësim të kriterëve të dy pozicioneve: drejtues teknik dhe inxhinier pyjesh në stafin teknik nga një person: administratori, drejtuesi teknik dhe inxhinieri i pyjeve z. S.H.

Në plotësim të pikës 2.3.7: “Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për të paktën 3(tre) muajt e fundit, si më poshtë:

- Lulishtar 10 (dhjetë)
- Punëtor të trajnuar për punime në lartësi profile krasitje 3 (tre)
- Punëtor të trajnuar për punime në prezencë uji 1 (një)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratë pune e vlefshme
- Dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

• Listë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhura nga punësimi të konfirmuara nga organet tatimore për 3(tre) muajt e fundit). Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor.” Për 10 (dhjetë) punonjës të specializuar/të kualifikuar “Lulishtar” për të paktën 3(tre) muajt e fundit, ka paraqitur në SPE Certifikatë të sigurimit teknik nga T...- Trupë certifikuese për 10 punonjës me datë testimi 09.08.2021 dhe datë skadence 08.08.2022. Nga faqja zyrtare e kësaj trupe <https://t.../rreth-nesh/> rezulton se: “Trupa “T...” SHPK, është trupë certifikuese e akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, si organizëm certifikimi personeli që certifikon personelin elektrik për përdorimin e pajisjeve elektrike në përputhje me Standardin S SH EN ISO/IEC 17024:2012 ...”.

OE i shpallur fitues për punëtor të trajnuar për punime në lartësi profile krasitje E.B., H.H. dhe R.D., dhe punëtori i trajnuar për punime në prezencë uji B.B. (për punimet e ndërtimit), me certifikata trajnimi në gjuhën angleze të përkthyer të njëjta të periudhës 09-10.10.2017, si dhe për verifikim është vendosur webpage zyrtar i institucionit trajnues: www.easicc.com/er/22training, por kjo faqe nuk gjendet, pasi nuk është e disponueshme.

Në plotësim të pikës 2.3.9: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: (ndër të tjera): Mjet teknologjik grirëse pemësh dhe shkurresh, copë 1”, me këto karakteristika:

Pesha e mjetit	2 ton max
Aftësi grirëse	Maksimumi diametër 10 cm
Rrotat e mjetit	Duhet të jenë rrota të mëdha të cilat të mund të lëvizin lirisht në territore rurale.
Viti i prodhimit	Jo më poshtë se viti 2005

Për këtë OE i shpallur fitues, ka paraqitur faturën tatimore elektronike të blerjes të datës 09.08.2021, për makinë bluarje BC 90, copë 1 (një) shoqëruar me foto që rezulton e markës “Zanon” e vitit 2020 me peshë 175 kg, pa të dhëna për aftësinë grirëse. Nga kërkimi në internet në faqen zyrtare të prodhuesit, rezulton se aftësia grirëse është për drurë me diametër deri në 9 cm, duke mos plotësuar karakteristikat teknike në këtë drejtim për aftësi grirëse maksimumi me diametër 10 cm.

Në këtë pikë është kërkuar dhe “Cisterna për vaditje jo me pak se 2 m³, copë 1”, në një kohë që janë planifikuar ujitje të luleve me tuba dhe ujitje e barit me tuba përkatësisht 30 herë dhe 100 herë të një sipërfaqeje prej 111 631 m², çka do të thotë se kapaciteti teknik i kërkuar nuk është i argumentuar për realizimin e shërbimit të vaditjes. Për plotësimin e këtij kriteri OE i

shpallur fitues ka paraqitur faturë të vitit 2012 të një cisterne pa vëllim me vlerë 15,000 lekë, si dhe dy foto cisternash (metalike dhe plastike), si dhe faturë të vitit 2018 cisterne CC 1 000 litra (pra 1 m³) me vlerë 13,200 lekë, duke mos plotësuar kërkesat e tenderit për 1 cisternë jo më pak se 2 m³, si dhe pa mundur të realizojë specifikimet teknike për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëra, për vaditjen e barit në periudhën e verës, e cila realizohet nëpërmjet vaditjes me tuba, me sprucator dhe në ato vende ku mungon uji.

Gjithashtu, në Analizat nga An-1 deri te Analiza An-3 është vendosur procesi i punës “Ujitje e barit me tuba”, por në kapacitetin teknik të OE pjesëmarrës nuk është përfshirë disponimi i autobotit për realizimin e kësaj lloji ujitjeje.

Në kushtet kur OE pjesëmarrës “M...” SHPK ka drejtuesin teknik njëkohësisht të punësuar në stafin teknik inxhinier pyjesh; 10 punonjës të specializuar/kualifikuar me certifikatë të sigurimit teknik për përdorimin e pajisjeve elektrike dhe jo lulishtarë; trajnimi i tre punëtorëve për punime në lartësi profile krasitje dhe një punëtor për punime në prezencë uji për punime ndërtimi (dhe jo pastrimi), nuk verifikohen në webpage-n zyrtar të institucionit trajnues, pasi nuk është e disponueshme; mjeti teknologjik grirës pemësh dhe shkurresh nuk ka aftësi grirëse deri në 10 cm; si dhe nuk disponon cisternën për vaditje jo me pak se 2 m³, nuk përmbush të gjitha kërkesat për kualifikim. KVO e përbërë nga M.M., A.Ç. dhe A.L. ka vepruar në kundërshtim me pikën 2, të nenit 82 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 të ndryshuar e cila përcakton: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim...”. Pra KVO ka kualifikuar OE “M...” SHPK i cili nuk i përmbushur kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në kundërshtim të germës “b” të pikës 2 të nenit 93 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 të ndryshuar, KVO nuk i ka propozuar titullarit të AK anulimin e procedurës së prokurimit, pasi nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme.

C. Monitorimi dhe zbatimi i kontratës

Referuar Shtojcës 7 - Formulari i termave të referencës, pika 4-Monitorimi dhe raportimi i shërbimit, rezulton se Bashkia Shkodër nuk ka realizuar në mënyrë të dokumentuar monitorimin e shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra përmes specialistëve dhe inspektorëve në terren, pasi Grupi i monitorimit në bashki ka përgjegjësi për monitorimin e cilësisë dhe sasisë të shërbimit në të gjithë territorin e bashkisë.

Inspektorët e rajoneve dhe përfaqësuesit e njësisë nuk kanë verifikuar në mënyrë të dokumentuar zbatimin e grafikëve të punimeve mujore për realizimin e proceseve të punës, si dhe nuk kanë raportuar çdo javë tek supervizori, informacion me shkrim, për ecurinë e realizimit të grafikut të punimeve.

Veç sa më sipër, nuk është vënë në dispozicion dokumentacion për numrin dhe llojet e pemëve dhe shkurreve dekorative dhe plani i vendosjes, i miratuar nga njësia e monitorimit në përshtatje me llojin e drurëve ekzistues në rrugë dhe lulishte, sipas kërkesave të pikës 8 të specifikimeve teknike. Nuk disponohet grafiku u shërbimit të mirëmbajtjes së rrugës së Kalasë që duhej të jepej nga njësia e monitorimit të shërbimeve publike/ Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes të Investimeve të Infrastrukturës, sipas kërkesave të pikës 11 të specifikimeve teknike në DT.

Njësia e monitorimit të shërbimeve publike/ Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe ndjekjes të investimeve të infrastrukturës nuk ka të dokumentuar grafikun e ndërhyrjeve gjate gjithë vitit për shërbimin e mirëmbajtjes së rrugës së Shirokës dhe bregut të liqenit, sipas kërkesave të pikës 12 të specifikimeve teknike të DT, si dhe planin e vendosjes së stolave dekorativë dhe koshave të vegjël për mbetje, pikat 14 dhe 15 të specifikimeve teknike të DT.

Si konkluzion, në përcaktimin e fondit limit janë përdorur Normat e punës sipas “*Libri i normave për sektorin e gjelbërimit*” i Ministrisë së Ekonomisë Komunale, viti 1989, i cili është një dokument që nuk merr parasysh zhvillimet teknologjike dhe ekonomike të dekadave të mëvonshme; janë përdorur referenca në manualet teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit kur kushtet nuk janë të njëllojta; si dhe studimi tregut në përcaktimin e çmimit nuk është ezauruar plotësisht, duke vepruar në kundërshtim me nenin 76 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar;

- Ka mangësi në harmonizimin e specifikimeve teknike të dokumenteve të tenderit dhe disponimit të fuqisë punëtore dhe makineri-pajisjeve nga ana e OE për realizimin e kontratës sipas specifikimeve teknike;

- KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “M...” SHPK në kushtet që nuk ka përmbushur të gjitha kërkesat në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 82 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar;

- Monitorimi i kontratës nr.11392/9 prot., datë 08.11.2021 për periudhën 2021-2022 ka shfaqur mangësi në dokumentimin e monitorimit të saj në kundërshtim me Shtojcën 7 - Formulari i termave të referencës, pika 4-Monitorimi dhe raportimi i shërbimit të dokumenteve të tenderit.

- Nga zbatimi i kontratës ofrimi i shërbimit të gjelbërimit për periudhën 2018-2021, në mars të vitit 2021 kanë rezultuar 13 035 m² sipërfaqe gjelbërimit jo në eficiencë, gjë që do të thotë se kontraktori “M...” SHPK ka përfituar padrejtësisht 3,327,988 lekë, si dhe 334,152 lekë për 26 drurë dekorativë që rezultojnë të pambjella, pra gjithsej 3,662,140 lekë me TVSH.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/5, datë 08.03.2024 nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 973/6, datë 09.04.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

- KVO ne rastin që do skualifikonte shoqërinë M... sh.p.k me arsyetimin se drejtuesi ligjor është edhe drejtues teknik apo inxhinier zbatimi do duhej të përcaktonte bazën ligjore ku do mbështetej ky pretendim i saj prandaj për sa kohe nuk ka një baze ligjore që ndalon këtë fakt skualifikimi i ofertuesit do konsiderohej i padrejte dhe abuziv dhe ne kundërshtim me LPP.

- Ne lidhje me mjetin teknologjik të paraqitur nga ofertuesi ku ju citoni që ne baze të kërkimeve ne faqen zyrtare të kompanisë që e ka prodhuar rezulton se aftësia grirëse për drurë dhe shkurre është max 9 cm , kjo gjë plotëson plotësisht kriterin e kërkuar me aftësi grirëse max 10 cm, pasi ne DST nuk është kërkuar minimumi 10 cm por max 10 cm që nënkupton që makina grirëse mund të ketë aftësi grirëse nga 1cm deri në 10 cm dhe që normalisht nuk e përjashton por e përfshin masën 9 cm.

- Operatori ekonomik M... ka paraqitur dy fatura tatimore shitjet që disponon dy cisterna vaditje njëra me kapacitet 1000 l dhe tjetra nuk e ka të përcaktuar kapacitetin por jemi në kushtet kur KVO mund ti kishte kërkuar ofertuesit sqarime në lidhje me kapacitetin e cisternës pasi nuk është e përcaktuar në fature dhe jo ta skualifikonte atë.

- Për konstatimin se katalogët e paraqitur nga operatori K... G... sh.p.k. i shpallur fitues nuk plotësojnë karakteristikat teknike për të qene katalog komentohet se:

- ne procedurën e prokurimit të zhvilluar me date 09.09.2021 operatori K... G... sh.p.k. ka paraqitur katalog malli për të tre automjetet, ne ndryshim nga hera e pare e anuluar duke paraqitur katalog për automjetin Auto veturë Fuoristrade për Policinë Bashkiake me të dhëna fikse mbi specifikimet teknike ne ndryshim nga hera e pare dhe automjetin Autoveturë 6+1 për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.

- Ndërsa fakti që ne specifikime teknike nuk është përcaktuar konsumi i karburantit mendojmë se kemi të bëjmë me një automjet të përdorur dhe janë kërkuar karakteristikat baze që të çojnë në vlerësimin e çmimit të tregut ndërsa sasia e konsumit të karburantit për automjetin behet në momentin që merret në dorezim dhe mbahet procesverballi i konsumit nga një komision i veçantë i ngritur me urdhër të kryetarit.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se ky komision nuk ka ne përbërje të tij specialiste të fushës të cilët mund të kenë dijeni për specifikimet teknike të automjeteve.

- Komisioni i marrjes ne dorëzim ka verifikuar të dhënat teknike të përcaktuara në certifikatën e origjinës së mallit dhe katalogun të ofertuesit të ngarkuar ne sistem për të pare përputhshmërinë e të dhënave teknike me ato të deklaruara në tender. Për të bere matjen e konsumit real ne kushte pune me ngarkesë etj të automjetit duhej ngritur një komision tjetër për të bere matjen e harxhimit faktik të karburantit. Nuk është detyre e komisionit të marrjes ne dorëzim të mallit për të bere matjen dhe për sa kohe kjo detyre nuk është e shprehur ne urdhrin e brendshëm për marrjen në dorëzim të mallit.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/6, datë 09.04.2024 grupi i auditimit gjykon se:

- Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se OE "M..." SHPK është shpallur fitues nga KVO në kundërshtim me kërkesat e DT pasi nuk plotëson kriteret në vijim: pozicionet e drejtuesit teknik dhe inxhinierit të pyjeve në stafin teknik janë të parqitura për një person që është administratori i shoqërisë; trajnimi i tre punëtorëve për punime në lartësi profile krasitje dhe një punëtor për punime në prezencë uji për punime ndërtimi (dhe jo pastrimi), nuk verifikohen në webpage-n zyrtar të institucionit trajnues sepse nuk ekziston, si dhe certifikatat e kualifikimit për "lulishtar" janë nga organizëm certifikimi personeli që certifikon personelin elektrik për përdorimin e pajisjeve elektrike; mjeti teknologjik grirës pemësh dhe shkurresh nuk ka aftësi grirëse deri në 10 cm por deri në 9 cm; si dhe nuk disponon 1 cisternë për vaditje jo me pak se 2 m³. Pra, KVO ka vepruar në kundërshtim me pikën 2, të nenit 82 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Gjykojmë se nga Bashkia Shkodër nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/5, datë 08.03.2024 nga subjekti "M..." shpk janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 973/7, datë 15.04.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

- Në bazë të kërkesës që i kanë paraqitur Bashkisë Shkodër për të marrë informacion mbi praktikën e auditimit të KLSH në këtë bashki, mbi mangësitë procedurale në procedurën e prokurimit "Ofrimi i Shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë Shkodër" për periudhën 2021-2024"

Në këtë observacion cilësohet se pretendimet e konstatuara në Raportin e KLSH dhe në Aktin e konstatimit përkatës nuk qëndrojnë: lidhur me përllogaritjen e fondit limit pasi nuk ka as manuale të posaçme dhe as referenca të tjera ligjore; vlerësohet se ka një harmonizim të plotë të specifikimeve teknike me fuqinë punëtore dhe makineritë dhe koherencë me grafikun e shërbimit; KVO ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe ligjore procedurën e prokurimit; monitorimi i kontratës është bërë në mënyrë permanente dhe në përputhje të plotë me dispozitat e kontratës së nënshkruar nga palët; është vlerësuar gabim nga grupi i auditimit mungesa e eficiencës në sipërfaqen prej 13035 m², pasi janë shtuar në mënyrë periodike këto sipërfaqe, si dhe nuk ka ndonjë akt tjetër shkresor për inventarizimin e tyre, duke cilësuar në fund që konstatimi i grupit të auditimit nuk qëndron.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti "M..." SHPK dërguar me shkresën nr. 973/7, datë 15.04.2024 grupi i auditimit gjykon se:

Kontraktori "M..." SHPK nuk është cilësuar me përgjegjësi lidhur me përllogaritjen e fondit limit; as për mungesën e harmonizimit të plotë të specifikimeve teknike me fuqinë punëtore dhe me makineritë; as për veprimtarinë e KVO në vlerësimin e procedurës së prokurimit; si dhe as për mangësitë e monitorimit të kontratës nr.11392/9 prot., datë 08.11.2021 për periudhën 2021-2022 në drejtim të monitorimit. Kjo pasi nuk është detyrë dhe përgjegjësi e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në një procedurë konkurrimi, as e OE të shpallur fitues, as e Kontraktorit nënshkruar që rezulton sipas procedurës së prokurimit.

Megjithëse është analizuar në mënyrë të detajuar në dokumentet e raportimit të auditimit, sjellim në vëmendje se, nga krahasimi i sipërfaqeve të gjelbëra të inventarizuara në vitin 2021, sipas Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Shkodër nr. 266, datë 17.03.2021, konkretizuar me procesverbalin me nr.1048/6 prot., të datës 23.03.2021 në të cilin janë vlerësuar të gjitha sipërfaqet ekzistuese funksionale të gjelbërta në Shkodër, me të dhënat Raportit teknik të vitit 2018- rezultatet e inventarizimit të dala nga Urdhri i Kryetarit të Bashkisë Shkodër nr. 752, datë 06.10.2017 "Për inventarizimin e sipërfaqeve të gjelbërta dhe gjelbërimit rrugor", për ofrim shërbim gjelbërimi, rezultojnë sipërfaqe të cilat nuk janë në eficiencë në vitin 2021, megjithëse janë paguar për shërbime gjatë zbatimit të kontratës 2018-2021 në madhësinë prej 13035 m², duke sjellë për pasojë përfitimin e padrejtë të kontraktorit "M..." SHPK në shumën 3,662,140 lekë për shërbime të pakryera. Në kontratën e nënshkruar, nuk janë parashikuar sipërfaqe të reja, si dhe në situacionet e paguara nuk janë zëra shpenzimesh për sipërfaqe të reja të gjelbëruara.

Gjykojmë se subjekti "M..." SHPK nuk ka sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

2. Për auditimin mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit publik me objekt "Blerje automjete" 2021.

Për auditimin e kësaj procedure prokurimi u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë :

1. Dosja e dokumentacionit fizik të procedurës së prokurimit "Blerje automjete" 2021;
2. Sistemi i Prokurimit Elektronik (SPE) të bashkisë Shkodër, për këtë procedurë prokurimi;
3. Informacion dhe dokumentacion mbi funksionimin e automjeteve pas realizimit të kontratës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

A. Nga shqyrtimi i dosjes së kësaj procedure prokurimi:

Nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit është dërguar kërkesa për angazhim me nr.73 prot., datë 24.02.2021, bazuar në fishën e buxhetit për vitin 2019, regjistrin të parashikimeve të vitit 2021, vlera e shpenzimit 2,500,000 lekë; specifikimet teknike janë përgatitur dhe nënshkruar nga V.Sh. dhe E.S.; llogaritja e fondit limit me Urdhër të Drejtorit të Drejtorisë më datë 24.02.2021 me vlerën 2,083,333 lekë nga komisioni me përbërje: E.S., Gj.Gj. dhe A.D. sipas citimit të tyre bazuar në eksperiencën e vitit të kaluar, por që nuk ka bashkëlidhur të dokumentuar kontratat e mëparshme; preventiv për blerje automjeti me vlerë 2,083,333 lekë, preventivuar nga M.V. dhe miratuar nga Drejtori A.A., me cilësimin: “çmimet janë marrë nga testimi i tregut”, por që nuk është e dokumentuar; si dhe nga cilat subjekte; një fletë preventivi e firmosur nga M.V., por e paplotësuar.

Në llogaritjen e fondit limit, si nga ana e komisionit, ashtu edhe nga ana e preventivuesit nuk janë dokumentuar dhe argumentuar mënyrat e llogaritjes së fondit limit, pasi sipas tyre janë referuar studimit të tregut, por nuk i ka të dhënat e argumentuara, krahas preventivit të nënshkruar dhe të pa firmosur, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2 të nenit 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 të ndryshuar: “Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.”

Nga Policia Bashkiake, kërkesa për angazhim me nr.2096/8 prot., datë 11.06.2021 është bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak (VKB) nr.83, datë 20.12.2018, shkresën e Kryetarit të bashkisë nr. 867 prot., datë 18.01.2021, për procedurat e prokurimit, të cilat nuk janë zhvilluar në vitin 2020, vlera e shpenzimit 2,000,000 lekë; specifikimet teknike janë përgatitur nga A.E. në të cilën nuk është përfshirë konsumi i karburantit, një nga treguesit e rëndësishëm të specifikimeve teknike; llogaritja e fondit limit më datë 11.06.2021 me vlerën 1,660,000 lekë nga komisioni me përbërje: A.E., S.Sh dhe F.V., duke cilësuar se: “pas specifikimeve teknike dhe sasisë, vendosi të marrë për bazë çmimet e testimit të tregut për përcaktimin e çmimit mesatar”, duke vendosur në vijim një tabelë me çmim mesatar 1,660,000 lekë nga tre oferta nga K. G, P. dhe A., dhe asgjë tjetër; preventiv për blerje automjeti me vlerë 2,083,333 lekë, preventivuar nga A.E., me cilësimin: “çmimet janë marrë nga testimi i tregut”, por që nuk është e dokumentuar si dhe nga cilat subjekte; një fletë preventivi e firmosur nga A.E., por e paplotësuar.

Veprimi i llogaritjes së fondit limit, pa një dokument që është ngarkuar në cilësinë e specialistit të fushës nga titullari i AK, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 59 të VKM Nr. Nr. 914, datë 29.12.2014 të ndryshuar, si dhe pikën 2 të këtij neni, pasi nuk është argumentuar përlllogaritja e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse është kërkesa për angazhim me nr.2106/8 prot., datë 19.06.2021, bazuar në VKB nr.83, datë 20.12.2018, vlera e shpenzimit 2,800,000 lekë; specifikimet teknike janë përgatitur dhe nënshkruar nga M.B., J.H. dhe H.M. me datë 07.06.2021; llogaritja e fondit limit më datë 14.06.2021 me vlerën 2,330,000 lekë nga komisioni me përbërje: A.E., S.Sh. dhe F.V., duke cilësuar se: “pas specifikimeve teknike dhe sasisë, vendosi të marrë për bazë çmimet e testimit të tregut për përcaktimin e çmimit mesatar”, duke vendosur në vijim një tabelë me çmim mesatar 2,330,000 lekë nga tre oferta nga K. G., P. dhe A. dhe asgjë tjetër; preventive për blerje automjeti me 2,330,000 lekë, preventivuar nga H.M., me cilësimin: “çmimet janë marrë nga testimi i tregut”, por që nuk është e dokumentuar si dhe nga cilat subjekte; një fletë preventivi e firmosur nga H.M., por e pa plotësuar, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 të ndryshuar, pasi nuk është dokumentuar marrja e çmimeve të tregut.

Urdhri i prokurimit nr.599 ka dalë më datë 23.06.2021 për blerje automjeti me fondin limit 6,073,333 lekë pa TVSH, me detajimin: Drejtoria Ekonomike e Arsimit me fond limit 2,083,333 lekë; Policia Bashkiake 1,600,000 lekë dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse 2,330,000 lekë, procedurë e hapur e thjeshtuar, me Njësi Prokurimi (NJP): E.D, D.K. dhe H.M.

Procesverbali i NJP i datës 23.06.2021 mbi hartimin e dokumentacionit të tenderit, bazuar në dokumentacionin e mësipërm të përgatitur nga strukturat e mësipërme, me afat hapjen e ofertave më datë 26.07.2021, ora 10.

Në dosje ka një ndryshim të dokumenteve të tenderit, referuar rekomandimeve të dhëna nga monitorimi i APP, për të cilat nuk duhet të përmendet asnjë markë, dhe për këtë arsye tenderi është shtyrë për më datë 03.08.2021, ora 10, dhe kanë ndryshuar specifikimet teknike për automjetin e Drejtorisë Ekonomike të Arsimit.

Në raportin përmbledhës të datës 17.08.2021, të përgatitur nga KVO për këtë procedurë prokurimi, cilësohet se në procedurën e prokurimit të datës 03.08.2021 ka marrë pjesë një operator ekonomik (OE): “K... G...” SHPK, i cili nuk plotëson kushtet, *pasi nuk ka paraqitur katalogun e mallit për automjetin Autoveturë Fuoristrade për policinë bashkiake dhe automjetin Autoveturë 6+1 për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore*, duke i propozuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor anulimin e procedurës se prokurimit.

Me Urdhrin e prokurimit nr.791, datë 23.08.2021 Zv/Kryetari T.D. me vendim delegimi, ka caktuar të njëjtin NJP dhe të njëjtin fond limit. Më datë 27.08.2021 NJP ka mbajtur Procesverbalin për hartimin e dokumentacionit të tenderit, më datë të hapjes së ofertave 09.09.2021, ora 10.

Urdhri për ngritjen e KVO nr.798 ka dalë më datë 24.08.2021 për tenderin e datës 09.09.2021 me përbërje: F.Sh., A.Sh. dhe M.B., ky i fundit ka zëvendësuar V.M., firmosur nga Zv/Kryetari T.D. me vendim delegimi.

Në raportin përmbledhës të kësaj procedure prokurimi të datës 20.09.2021, të përgatitur nga KVO, cilësohet se në procedurën e prokurimit të datës 09.09.2021 ka marrë pjesë një operator ekonomik (OE): “K... G...” SHPK, i cili me ofertën 6,058,833 lekë plotëson kriteret e kërkuara në DT, duke i propozuar titullarit të AK shpalljen fitues për këtë procedurë prokurimi.

B. Nga shqyrtimi i kësaj procedure në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) rezulton se:

Dokumentet e tenderit janë hedhur në sistem më datë 14.07.2021 dhe publikuar më datë 15.07.2021 për procedurën e prokurimit: Procedurë e hapur e thjeshtuar-Mallra “Blerje automjeti”, me fond limit 6,073,333 lekë, datë zhvillimit të tenderit 26.07.2021, ora 10:00, për blerjen e tre automjeteve: për Drejtorinë Ekonomike e Arsimit, Policisë Bashkiake dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe shërbimeve Mbështetëse, përkatësisht: 2,083,333 lekë, 1,660,000 lekë dhe 2,330,000 lekë (Shtojca nr.6-Formulari i sasisë dhe grafiku u i lëvrimin).

Tenderi fillimisht është shpallur për t’u zhvilluar më datë më datë 26.07.2021, ora 10, por me ndryshimin e dokumenteve të tenderit, sipas sugjerimit të monitorimit të APP është shtyrë për t’u zhvilluar më datë 03.08.2021. Në këtë procedurë prokurimi ka marrë pjesë një OE “K. G.” SHPK, me ofertë 6,058,833 lekë.

Sipas vlerësimit në sistem konstatohet se më datë 10.08.2021, znj. A.Sh. ka vlerësuar se nuk i plotëson kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit, pika 1 e Shtojcës 8, ndërsa dy anëtarët e tjerë e kanë vlerësuar se e plotëson këtë kriter: “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë me të dhënat teknike për automjetet që oferton. Katalogu duhet të jetë në gjuhën angleze ose i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën shqipe. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga automjetet që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo automjeti me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse automjeti i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e automjeteve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre.*”, duke anuluar tenderin.

Nga auditimi në SPE për tenderin e zhvilluar më datë 03.08.2021, të anuluar për shkaqet e mësipërme rezulton se për katalog OE i vetëm ka sjellë dokumentet si më poshtë:

- *Deklarata e garancisë dhe katalogu*, i cili përmban deklaratën e garancisë së riparimit të defekteve për 24 muaj dhe shtojcën 5- Formulari i specifikimeve teknike, i cili plotësohet nga

AK, dhe që për automjetin e Drejtorisë Ekonomike të Arsimit i referohet specifikimeve teknike të pandryshuara, në të cilin përmendet dhe modeli “Pick Up Trendline 2.0 TDI 103 kw 4MOTION”, i cili është në anglisht dhe në shqip pjesë-pjesë, i vulosur nga OE.

Për katalog ka sjellë dokumentin:

- K... Amarok, Katalog, për kodin S6BA...X4, për modelin Amarok Trendline 2.0TDI 103kw 4MOTION, në shqip disa të dhëna teknike dhe në anglisht pajisjet standarde, të cilat përputhen plotësisht, fjalë për fjalë me specifikimet teknike të përgatitura nga V.Sh. dhe E.S. për Drejtorinë Ekonomike të Arsimit, të cilat janë paraqitur në DT pa ndryshime të datës 22.07.2021 Shtojca nr. 1 për modifikimin e specifikimeve teknike, për këtë mjet, në të cilin ndodhet një foto automjeti Volkswagen Tirana.
- Specifikimet teknike të printuara për SUV Fuoristrade, shoqëruar me një foto “Land Rover Range Rover”, nga e cila nuk mund të përcaktohet asnjë nga specifikimet teknike;
- Deklaratë të datës 26.07.2021 me të cilën z. B.Ll. në cilësinë e Administratorit të OE “K. G.” SHPK deklaron nën përgjegjësin e tij të plotë që në plotësim të pikës 2 në kapacitetin teknik (2.3) se katalogët mund të verifikohen në faqen e web-it: <https://www.vw.com/en.html> dhe sipas specifikimeve të bashkëngjitur kësaj deklaratë.

Nga auditimi në SPE për tenderin e zhvilluar më datë 09.09.2021 ka marrë pjesë vetëm një OE “K. G.” SHPK (OE i mëparshëm) i kualifikuar dhe i shpallur fitues, për katalog ka paraqitur në sistem:

- Specifikimet teknike-SUV njëlloj si në tenderin e anuluar të datës 03.08.2021;
- Specifikimet teknike PickUp njëlloj si në tenderin e anuluar të datës 03.08.2021, duke shtuar specifikimet teknike të printuara, të cilat nuk përkojnë me ato të cilësuar si katalog në disa prej treguesve si kapaciteti i serboratorit, konsumit të karburantit etj.
- Specifikimet teknike për automjetin 6+1, dhe për katalog është paraqitur K. Amarok, Katalog, për kodin SBJT..., për modelin Cady Maxi 2.0TDI në shqip disa të dhëna teknike dhe në anglisht dhe shqip pajisjet standarde, si dhe një foto automjeti;
- Deklaratë të datës 09.09.2021 me të cilën z. B.Ll. në cilësinë e Administratorit të OE “K.G.” SHPK deklaron nën përgjegjësin e tij të plotë që në plotësim të pikës 2 në kapacitetin teknik (2.3) se katalogët mund të verifikohen në faqen e web-it: <https://www.vw.com/en.html> dhe sipas specifikimeve të bashkëngjitur kësaj deklaratë.

OE ka vijuar të paraqesë shtojcën 5- Formulari i specifikimeve teknike, i cili plotësohet nga AK, dhe që për automjetin e Drejtorisë Ekonomike të Arsimit i referohet specifikimeve teknike të pandryshuara, në të cilin përmendet dhe modeli “Pick Up Trendline 2.0 TDI 103 kë 4MOTION”, i cili është në anglisht dhe në shqip pjesë-pjesë, i vulosur nga OE.

Asnjëri nga dokumentet e mësipërme nuk plotësojnë kushtet e të qenit katalogë, në kuptimin sipas kërkesës në DT, pasi katalogu në vetvete është një listë, zakonisht me fotografi të produkteve që një kompani prodhon, që në këtë rast OE nuk është as shitës i autorizuar. Për më tepër, që në faqen e web-it: <https://www.vw.com/en.html> është e pamundur që të verifikohen katalogët.

Nga sa më sipër konstatohet se: 1. Specifikimet teknike për automjetin e Drejtorisë Ekonomike të Arsimit të përgatitura nga V.Sh. dhe E.S. të paraqitura fillimisht në DT, përputhen plotësisht, me të dhënat teknike fikse dhe tekstualisht me ofertën e OE të vetëm pjesëmarrës të kësaj procedure. Po kështu, automjeti për policinë bashkiake, me vit prodhimi minimumi 2007, përputhet me ofertën e OE të vetëm pjesëmarrës dhe të shpallur fitues, është për vitin 2007.

2. OE pjesëmarrës i vetëm, i kualifikuar dhe i shpallur fitues “K. G.” SHPK, nuk ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT, Shtojca 7, Kreu 2- Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika -2.3 Kapaciteti teknik, çështja 2, pasi nuk ka paraqitur katalogë me të dhënat teknike për automjetet që oferton; nga dokumentet e hedhura në sistem për katalogë janë edhe në gjuhën angleze të pa përkthyer në gjuhën shqipe; nuk markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga automjetet që oferton sipas modelit të deklaruar dhe nuk markohen edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT; nuk përmbajnë karakteristikat teknike të çdo automjeti me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse automjeti i ofruar plotëson kërkesat e specifikimeve

teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit; si dhe heq mundësinë e krahasimit të përputhshmërisë së specifikimeve teknike të markës dhe modelit të ofertuar të katalogut e automjeteve dhe specifikimeve teknike në DT.

Kështu, për automjetin e Policisë Bashkiake, nëpërmjet fotos nuk është e mundur të përcaktohet viti i prodhimit, cilindrata, fuqia motorrike, lloji i karburantit, numri i vendeve etj.

Ndërsa për automjetin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, nga dokumenti i cilësuar katalog nga ofertuesi nuk mund të përcaktohet në se plotësohen specifikimet teknike lidhur me konsumin e karburantit, sistemin e drejtimit, kategorinë ambientale etj., pasi nuk ka të dhëna.

KVO e përbërë nga F.Sh., A.Sh. dhe M.B. ka vepruar në kundërshtim me pikën 2, të nenit 82 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 të ndryshuar. “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;
- ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe
- iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit“, pasi ofertuesi është shmangë nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit.

Në kundërshtim të gurmës (b) të pikës 2 të nenit 93 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 të ndryshuar, KVO nuk i ka propozuar titullarit të AK anulimin e procedurës së tenderimit, duke e konsideruar se nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme.

B. Të tjera

B.1 Procesverbalit i marrjes në dorëzim për automjetin Autoveturë Volkswagen Cady 6+1 mban datën 19.11.2023, protokolluar më datë 23.11.2021 dhe është nënshkruar nga H.M, P.M. dhe A.E. dhe magazinieri A.C., dhe nga ana e tjetër përfaqësuesi i subjektit “K. G.” SHPK, sipas të cilëve nuk kanë rezultuar mospërputhje me specifikimet teknike dhe mjeti është marrë në dorëzim.

Në mungesë të një katalogu të mirëfilltë, ky komision e ka pasur të pa mundur të përcaktojë konsumin e karburantit për cikël urban, extra urban dhe për ciklin e kombinuar, përkatësisht 6 litra, 3.9 litra dhe 4.7 litra për 100 km; kategorinë ambientale Euro 6; shpejtësinë maksimale 240 km/orë etj.

B.2 Grupi i auditimit të KLSH kërkoi të dhëna dhe dokumentacion mbi konsumin e karburantit dhe km e përshkuara në vitin 2021 dhe 2022 nga automjeti i Drejtorisë Ekonomike të Arsimit, i cili është marrë në dorëzim nga komisioni me përbërje: V.Sh., E.S. dhe A.Sh., sipas procesverbalit të datës 13.10.2021, dhe fletë hyrjes nr.19 të po kësaj date, brenda afatit 10 ditore të përcaktuar në kontratën nr.412 prot., datë 04.10.2021. Ky komision nuk është shprehur sipas katalogut të cilësuar si të tillë nga ofertuesi, por sipas specifikimeve teknike të prokurimit, duke mos garantuar nëse automjeti i marrë në dorëzim është në përputhje me treguesit e katalogut të automjetit të ofertuar.

Grupi i auditimit kërkoi të dhëna mbi km e përshkuara dhe konsumin e karburantit nga automjeti i Drejtorisë Ekonomike të Arsimit me targë AB...ES në vitin 2021 dhe 2022 dhe rezulton si më poshtë.

Të dhëna për konsumin e karburantit për AB...ES për vitet 2021-2022

Mjeti	2021			2022			Mesatarja 2021 dhe 2022	Sipas spec teknike	Difer me-spec teknike
	Naftë (kg)	Km	Mesat litër/100 km	Naftë (kg)	Km	Mesat litër/100 km			
Drejtoria e Arsimit AB...ES	150	635	23.6	3650	18036	20.2	20.3	7.8	+ 12.5

Burimi: Të dhëna të Bashkisë Shkodër, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga sa më sipër automjeti i Drejtorisë Ekonomike të Arsimit me targë AB...ES nuk ka plotësuar në praktikë specifikimet teknike të konsumit të karburantit prej 7.8 litër/100 km, por e ka tejkaluar ndjeshëm atë, duke arritur në 12.5 litra për 100 km, me pasoja mungesë efektiviteti në përdorimin e fondeve publike në vlerën gjithsej prej 531,861 lekë (3800 litra -1457 litra që do të duhej për 18671 km të përshkuara me normë konsumi 7.8 litra për 100 km = 2343 litra x 227 çmimin mesatar= 531,861 lekë)

Konkluzion: Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje Automjeti” me fond limit 6,073,333 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 09.09.2021 ka marrë pjesë, është kualifikuar dhe shpallur fitues vetëm një OE “K. G.” SHPK me ofertë 6,058,833 lekë, ka shfaqur mangësi:

- Specifikimet teknike të përgatitura nga Drejtoritë përkatëse përputhen plotësisht me ato të paraqitura nga ofertuesi i vetëm pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi për dy automjete, për atë të Drejtorisë së Policisë Bashkiake dhe Drejtorisë Ekonomike të Arsimit, nga 3 gjithsej;
- Në përcaktimin e fondit limit, si nga ana e preventivuesve ashtu edhe nga ana e komisionit përkatës nuk janë dokumentuar dhe argumentuar vlerat përkatëse, në kundërshtim me kërkesat pikës 2 të nenit 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 të ndryshuar;
- KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE i cili nuk i ka përmbushur kërkesat për kualifikim, duke vepruar në kundërshtim me pikën 2, të nenit 82 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 të ndryshuar;
- Nga përdorimi i automjetit nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit rezulton se ka tejkaluar ndjeshëm normativat e konsumit të karburantit në krahasim me ato të specifikimeve teknike për vitin 2021-2022 me 12.5 litra për 100 km më shumë, duke shkaktuar shpenzime të fondeve publike pa efektiv në vlerën prej 531,861 lekë.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/5, datë 08.03.2024 nga subjekti Bashkia Shkodër janë paraqitur observationet me shkresë nr. 973/6, datë 09.04.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Ndërsa, në procedurën e prokurimit të zhvilluar më datë 09.09.2021 operatori “. G...” SH. K ka paraqitur katalog malli për te tre automjetet, në ndryshim nga hera e parë e anuluar. Katalogët e paraqitur janë me të dhëna të sakta në përputhje me specifikimet teknike dhe kriteret e përcaktuara në DST, të firmosura dhe të vulosura nga ofertuesi.

Në përfundim, mendojmë se KVO ka vepruar drejt në kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorit ekonomik “K. G.” SHPK.

- Ofertat janë marrë të firmosura dhe të vulosura nga subjektet “K. G.”, “A.” dhe “P.” (bashkëlidhur këtij observacioni), pra janë të dokumentuara marrja e çmimeve të testimit të tregut me ofertat përkatëse nga subjektet dhe bazuar në këto çmime është hartuar proces-verbali i llogaritjes së fondit limit dhe testimit të tregut dhe preventivi, konform pikës 2 të nenit 59 të VKM Nr.914 date 29.12.2014, i ndryshuar.

- Proces-verbali i marrjes në dorëzim të autoveturës Volkswagen Cady 6+1 është bazuar në specifikimet teknike dhe nuk ka mospërputhje.

Në përcaktimin e konsumit të karburantit për cikël urban, extra urba dhe ciklin e kombinuar përkatësisht 6 litra, 3.9 litra dhe 4.7 litra për 100 km, kategorinë ambjentale Euro 6 dhe shpejtësinë maksimale 240 km/orë, si dhe të dhëna të tjera, komisioni është bazuar në certifikatën e konformitetit (përputhshmërisë) të lëshuar nga prodhuesi. Në këtë certifikatë janë të gjitha të dhënat e autovetures përfshirë edhe numrin e shasisë që përputhet me mjetin e marrë në dorëzim nga komisioni.

- Në lidhje me konstatimet për llogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike për automjetin për Policinë Bashkiake, nga komisioni i llogaritjes së fondit limit është bere procesi i testimit të tregut në tre operatore ekonomike që kanë si objekt veprimtarie tregtimin e automjeteve dhe duke marrë oferta në baze të specifikimeve teknike të përgatitura. Pavarësisht faktit që me udhëzim të Agjencisë së Prokurimeve Publike nuk është e domosdoshme administrimi i ofertave në mënyre shkresore pasi mund të ketë subjekte që nuk pranojnë të japin oferta në mënyrë shkresore ,bashkëlidhur do gjeni ofertat e marra dhe të administruara nga Policia Bashkiake. Ndërsa fakti që në specifikime teknike nuk është përcaktuar konsumi i karburantit mendojmë se kemi të bëjmë me një automjet të përdorur dhe janë kërkuar karakteristikat bazë që të çojnë në vlerësimin e çmimit të tregut, ndërsa sasia e konsumit i karburantit për automjetin behet në momentin që merret në dorëzim dhe mbahet procesverbali i konsumit nga një komision i veçantë i ngritur me urdhër të kryetarit.

- Në lidhje me proces-verbalin e llogaritjes së fondit limit nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit shpjegojmë se kjo llogaritje ka qene e kufizuar dhe e limituar nga fondi limit në dispozicion i miratuar nga Buxheti i Bashkisë Shkodër i cili ka qenë më i ulët se çmimet në treg për këtë lloj automjeti dhe në të tilla kushte është marrë eksperiencia e ngjashme ndër vite e Bashkisë Shkodër për të justifikuar llogaritjen e fondit limit.

- Në lidhje me konsumin e karburantit nga ky automjet, që në specifikime teknike është 7.8 l/100 km shpjegojmë se, duke u bazuar edhe në katalogun e prodhuesit ky harxhim është në kushte ideale me karburant ideal, makina duhet të jetë pa ngarkesë etj. Nga katalogu i prodhuesit jepen të dhënat teknike të harxhimit në rrugë urbane, ekstra urbane dhe të kombinuara ku konsumi i karburantit është më i madh se 7.8 l/100 km.

- Komisioni i marrjes në dorëzim ka verifikuar të dhënat teknike të përcaktuara në certifikatën e origjinës së mallit dhe katalogut të ofertuesit të ngarkuar në sistem për të parë përputhshmërinë e të dhënave teknike me ato të deklaruara në tender. Për të bërë matjen e konsumit real në kushte pune me ngarkesë të automjetit duhej ngritur një komision tjetër për të bërë matjen e harxhimit faktik të karburantit. Nuk është detyrë e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit për të bërë matjen dhe për sa kohë kjo detyrë nuk është e shprehur në urdhrin e brendshëm për marrjen në dorëzim të mallit.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti Bashkia Shkodër dërguar me shkresën nr. 973/6, datë 09.04.2024 grupi i auditimit gjykon se:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar lidhur me katalogët, sqarojmë se asnjë prej dokumenteve të paraqitura nga ofertuesi nuk plotësojnë kërkesat minimale të një katalogu, pasi nuk janë të emetuar nga prodhuesi ose shitës i autorizuar; nuk kanë të dhënat teknike për automjetet që oferton; nga dokumentet e hedhura në sistem për katalogë janë edhe në gjuhën angleze të pa përkthyer në gjuhën shqipe; nuk markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga automjetet që oferton sipas modelit të deklaruar dhe nuk markohen edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT; nuk përmbajnë karakteristikat teknike të çdo automjeti me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse automjeti i ofruar plotëson kërkesat e specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit; si dhe heq mundësinë e krahasimit të përputhshmërisë së specifikimeve teknike të markës dhe modelit të ofertuar të katalogut e automjeteve dhe specifikimeve teknike në DT.

- Në llogaritjen e fondit limit, nuk është ezauruar plotësisht dokumentimi dhe argumentimi i mënyrave të llogaritjes, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2 të nenit 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 të ndryshuar bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

- Në mungesë të një katalogu të mirëfilltë, komisioni i marrjes në dorëzim për automjetin Autoveturë Volkswagen Cady 6+1 nuk ka verifikuar konsumin e karburantit për cikël urban, extra urban dhe për ciklin e kombinuar; kategorinë ambientale; shpejtësinë maksimale etj., pjesë e specifikimeve teknike.

- Si pasojë e mungesës së katalogut dhe e verifikimit të konsumit mesatar, veprimtari e komisionit të marrjes në dorëzim ka qenë e mangët, duke sjellë për pasojë konsumin e karburantit tej normave në specifikimet teknike të ofertuesit.

Gjykojmë se nga Bashkia Shkodër nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

3. Për auditimin mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit publik me objekt “Blerje dru zjarri” 2021, si dhe zbatimi i kontratës përkatëse.

Për auditimin e kësaj procedure prokurimi u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë :

1. Dosja e dokumentacionit fizik të procedurës së prokurimit “Blerje dru zjarri” 2021;
2. Sistemi i Prokurimit Elektronik (SPE) të bashkisë Shkodër, për këtë procedurë prokurimi;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Për procedurën e prokurimit “Blerje dru zjarri” me fond limit 12,888,000 lekë pa TVSH, me afat për zbatimin e kontratës nga nënshkrimi deri më 31.12.2021. Kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “M. Sh. person fizik” me NIPT K.....Q, me ofertën ekonomike me vlerë prej 12,630,240 lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik “A.” SHPK me NUIS J.....Q, me ofertën ekonomike me vlerë prej 12,758,400 lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit nuk ka ofertues të skualifikuar dhe është identifikuar si oferta e suksesshme “M. Sh. person fizik” me ofertën më të ulët.

Nga auditimi në SPE, rezulton se:

Sipas DT, objekti i kontratës është blerje dru zjarri në sasinë 1 440 m³, në tenderin e datës 14.09.2021, ora 10:00 janë kualifikuar dy OE pjesëmarrës, duke shpallur fitues ofertën më të ulët.

Njësia e prokurimit përbëhet nga E.D., V.Sh. dhe D.K., ndërsa KVO me përbërje T.H., P.M dhe A.Z.

Sipas Shtojcës 5-Formulari i specifikimeve teknike, specifikimi i materialeve, “Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: *Bashkëlidhur DST: Çmimet e druve duhet të jenë të shprehura në m³ pa TVSH duke u kryer konvertimet e nevojshme në matjet gjatë furnizimit sipas volumit që kanë mjetet e transportit Gjithashtu, shitësi duhet të ketë lejen e shfrytëzimit pyjor konformë legjislacionit”, si dhe “Drutë të jenë ahu 50% dhe bunge 50% të sasisë së kërkuar. Të jenë të thata.”*

Sipas Shtojcës 7 Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, pika 2, Kriteret e veçanta të kualifikimit, çështja 2.3.3: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm që vërteton origjinën e mallit:

a. Ofertuesit duhet të paraqesin kontratën e furnizimit me dru nga subjekti shitës Bashki/Koncesionar shoqëruar me lejen e shfrytëzimit të pyllit dhe faturën tatimore të shitjes, ose kontratë furnizimi me këta të fundit shoqëruar me dokumentacionin e mësipërm (kontratë furnizimi, leje shfrytëzimi dhe faturë tatimore shitjet Bashki/Koncesionar), si dhe faturën tatimore të blerjes.

b. Nëse ofertuesit janë importues të druve të zjarrit nga jashtë duhet të paraqesin deklaratën doganore .Nëse nuk janë importues do të paraqesin kontrate furnizimi me importuesit shoqëruar dhe me faturën tatimore të blerjes, kjo në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të bindet në kapacitetet importuese të ofertuesit në mënyrë të garantohet realizimi me sukses i kontratës “.

Në plotësim, të këtyre kërkesave OE i shpallur fitues ka paraqitur në sistem dokumentacionin e mëposhtëm:

Të dhëna për dokumentet e paraqitura nga OE fitues.

Nr	Emërtimi	Lloji	Sasia m ³
1	Fatura doganore të vitit 2016	Ah	441
2	Kontratë për shfrytëzimin e lëndës drusore Bashkia Fushë - Arrëz me BOE “M. Sh.” dhe “L A.” SHPK, datë 14.10.2020: - Leja e shfrytëzimit nr.1, datë 14.10.2020; - Leje e shfrytëzimit nr.2, datë 09.11.2020;	Bungë Ah	201 520
3	Kontratë e Bashkisë Librazhd me “A.” SHPK datë 02.10.2019: për dru zjarri: pishë 109 m ³ dhe lis 957 m ³ ;	Ah	500
	Aneks kontratë e Bashkisë Librazhd me “A...” SHPK datë 28.07.2020 për kontratën e datë 28.07.2019, për shfrytëzimin e lëndës drusore, me afat deri më 23.03.2021; - Leje e shfrytëzimit nr.1, datë 28.07.2020 Ah 651.5 m ³ ;		
	Fatura Tatimore të shit-blerjes nga “A.” SHPK tek M. Sh., paraqitur 10 copë për dru zjarri sterë		
4	Kontratë furnizimi e M... Sh... nga “A... R...” SHPK datë 07.07.2020 për dru zjarri 1 300 m ³ , deri më datë 31.12.2020, e cila nuk i referohet asnjë leje shfrytëzimi; - Leje e shfrytëzimit nr.3 e BOE “A... R...” SHPK dhe “L... A...” SHPK, datë 20.12.2016 dhe datë 19.11.2017 për 7 536.6 m ³ dru zjarri ah; - Aneks-kontratë datë 29.12.2017 e bashkisë Fushë-Arrëz me subjektin “A... R...” SHPK për 6 956 m ³ dru zjarri ah, por pa leje shfrytëzimi;		
	Fatura Tatimore të shit-blerjes nga “A... R...” SHPK tek M... Sh..., paraqitur 11 copë të vitit 2020, nga të cilat dy janë për lëndë punimi 30 m ³ .	Ah	325

Burimi: Të dhëna të dosjes së tenderit të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga sa më sipër rezulton se OE “M... Sh... person fizik” i shpallur fitues ka deklaruar, se për këtë tender, disponon dru zjarri të importuara që nga viti 2016 në sasinë 441 m³, duke rrezikuar që këto të mos jenë cilësore sipas specifikimeve teknike që të mos ketë dru të kalbura gjatë furnizimit dhe të mos jenë me shenja të kalbësirës.

Kontrata për shfrytëzimin e lëndës drusore Bashkia Fushë - Arrëz me BOE “M... Sh...” dhe “L... A...” SHPK, datë 14.10.2020, si dhe dy leje shfrytëzimi për sasinë 201 m³ dru zjarri e

Ilojit bungë dhe 520 m³ e Ilojit ah, për të cilat nuk është e mundur të përcaktohet sasia që i përket secilit prej operatorëve, si dhe në se është zbatuar ose jo leja e shfrytëzimit.

Faturat tatimore me shitësin "A... R..." SHPK për 325 m³ dru zjarri të Ilojit ah, i referohen Lejes së shfrytëzimit nr.3 të BOE "A... R..." SHPK dhe "L... A...", ndërsa kontrata e furnizimit është vetëm me njërin prej tyre, pasi aneks kontrata nuk është shoqëruar me leje shfrytëzimi, si dhe 5 fatura tatimore të shitjes janë para datës së nënshkrimit të kontratës për këtë qëllim.

Bazuar në sa më sipër rezulton se OE "M... Sh... person fizik" i shpallur fitues nuk ka arritur të provojë në mënyrë të qartë dhe bindëse garantimin e sasisë së druve të zjarrit prej 1 440 m³, me kontratën e furnizimit me dru nga subjekti shitës Bashki/Koncesionar shoqëruar me lejen e shfrytëzimit të pyllit dhe faturën tatimore të shitjes, si dhe faturën tatimore të blerjes, sipas kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Veç sa më sipër, OE "M... Sh... person fizik" ka marrë pjesë dhe është shpallur fitues dhe në tenderin e vitit 2020, në të cilin ka ofertuar të njëjtat fatura tatimore të shit-blerjes nga "A... R..." SHPK të vitit 2020 për 325 m³; të njëjtat fatura doganore të vitit 2016 për 441 m³; të njëjtën kontratë furnizimi e M... Sh... nga "A... R..." SHPK datë 07.07.2020 për dru zjarri 1300 m³, deri më datë 31.12.2020 etj., çka tregon se kjo sasi e drurëve të zjarrit është ezauruar një vit më parë.

Gjithashtu, OE "M... Sh... person fizik" i shpallur fitues nuk ka arritur që drutë e furnizuara të jenë ahu 50% dhe bungë 50% të sasisë së kërkuar prej 1 440 m³, sipas specifikimit të materialeve.

KVO e përbërë nga T.H., P.M. dhe A.Z. ka vepruar në kundërshtim me pikën 2, të nenit 82 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 të ndryshuar. "Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.", pasi ofertuesi "M... Sh... person fizik" i kualifikuar dhe shpallur fitues nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentet e tenderit lidhur me cilësinë (që të mos jenë të kalbura), përbërjen strukturore, si dhe disponimin e sasisë së ezuaruar të një viti më parë.

Nga auditimi në SPE rezulton se OE "A..." SHPK me NUIS J.....Q ka paraqitur në ofertën e vet Kontratë me Bashkinë Librazhd me nr.5163 prot., datë 02.10.2019: për shitjen e lëndës drusore të dalë nga rrallimet lëndë ndërtimi dhe dru zjarri: pishë 109 m³ dhe lis 957 m³, e njëjta e paraqitur dhe nga OE "M... Sh... person fizik". Nga kjo rezulton se OE "A..." SHPK ka kryer ndërhyrje në ofertë dhe AK Bashkia Shkodër nuk ka vlerësuar nëse ky konstatim mund të shërbejë si tregues për ndërhyrje në oferta nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues dhe në vijim për të vepruar sipas kërkesave të nenit 81, pika 1 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 të ndryshuar me përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave në të cilat është përfshirë ofertuesi.

Duke qenë në kushte të tilla, KVO ka vepruar në kundërshtim të germës (b) të pikës 2 të nenit 93 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 të ndryshuar, pasi nuk i ka propozuar titullarit të AK anulimin e procedurës së prokurimit.

Si konkluzion, procedura e prokurimit me objekt: "Blerje dru zjarri" me fond limit me fond limit 12,888,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 14.09.2021 kanë marrë pjesë dy OE dhe është kualifikuar e shpallur fitues "OE M... Sh.... person fizik" me ofertën më të ulët 12,630,240 lekë pa TVSH, ka shfaqur mangësi:

- Disponimi i pothuaj 1/3 të druve të zjarrit të importuara që nga viti 2016, ka rrezikuar që këto të mos jenë cilësore sipas specifikimeve teknike që të mos ketë dru të kalbura gjatë furnizimit dhe të mos jenë me shenja të kalbësirës;
- OE i shpallur fitues nuk ka arritur të sigurojë që drutë e zjarrit të jenë sipas specifikimit të materialeve ahu 50% dhe bungë 50% të sasisë së kërkuar gjithsej prej 1 440 m³;
- OE i shpallur fitues disponimin e sasive së druve të zjarrit për vitin 2021 e ka ezauruar një vit më parë në kontratën e tenderit të vitit 2020, pasi ka ofertuar të njëjtat fatura tatimore të shit-blerjes; të njëjtat fatura doganore; si dhe të njëjtën kontratë furnizimi.

- OE "A..." SHPK pjesëmarrës i kualifikuar ka paraqitur në ofertën e vet të njëjtën kontratë që ka paraqitur dhe OE i shpallur fitues, dhe AK Bashkia Shkodër nuk ka vlerësuar nëse ky konstatim mund të shërbejë si tregues për ndërhyrje në oferta nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues dhe për të vepruar sipas kërkesave të nenit 81, pika 1 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 të ndryshuar me përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave në të cilat është përfshirë ofertuesi.

Në këto kushte KVO ka vepruar në kundërshtim me pikën 2, të nenit 82 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 të ndryshuar, pasi ofertuesi i kualifikuar dhe shpallur fitues "M... Sh... person fizik" nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentet e tenderit duhej skualifikuar, si dhe në kundërshtim të germës (b) të pikës 2 të nenit 93 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 të ndryshuar, pasi nuk i ka propozuar titullarit të AK anulimin e procedurës së prokurimit.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/5, datë 08.03.2024 nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 973/6, datë 09.04.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Nga shqyrtimi i kritereve kualifikuese, nuk përcaktohet që operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë dhe ta kenë gjendje sasinë prej 1 440 m³ ditën e hapjes së ofertave, por duhet të vërtetojnë se kanë kapacitetet teknike për të realizuar me sukses kontratën e cila është me afat zbatimi deri më 31.12.2021.

- OE "M... Sh..." PF në zbatim të kërkesës në DST, pika 5, ka paraqitur Akt-kontrollin datë 02.08.2021 lëshuar nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, nga verifikimi i të cilit rezultoi që gjendja e druve të zjarrit datë 02.08.2021, pra rreth 1 muaj nga data e zhvillimit të tenderit, pranë këtij subjekti është 1 470 m³, pra më e madhe se sasia e kërkuar në DST prej 1 440 m³. Gjithashtu bazuar në këtë akt-kontroll rezultoi se, e gjithë sasia është me dokumentacion origjinë malli dhe ndodhet në kushte teknike të rregullta sipas legjislacionit në fuqi.

- Pretendimi i juaj që operatori ekonomik nuk ka vertetuar që drute e zjarrit të jenë sipas specifikimit të materialeve ahu 50% dhe bunge 50% të sasisë së kërkuar nuk qendron për faktin që për sa kohë në kriteret e kualifikimit nuk është përcaktuar që ofertuesit duhet të disponojnë sasinë prej 1440 m³ ditën e hapjes së ofertave atëherë nuk kane detyrimin ligjor që të vërtetojnë me dokumentacion se disponojnë sasi drush ahu 50% dhe bunge 50%.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/6, datë 09.04.2024 grupi i auditimit gjykon se:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarohet se vetëm pamundësia e OE të shpallur fitues që nuk ka arritur të sigurojë drutë e zjarrit të jenë sipas specifikimit në DT të materialeve ahu 50% dhe bunge 50% të sasisë së kërkuar gjithsej prej 1 440 m³ është i mjaftueshëm për skualifikimin e OE, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 82 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 të ndryshuar.

Gjithashtu, paraqitja e së njëjtës kontratë nga dy OE pjesëmarrës në procedurë prokurimi është ndërhyrje në ofertë, në kuptimin dhe zbatimin e nenit 81, pika 1 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 të ndryshuar, që rezultoi me përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave në të cilat është përfshirë ofertuesi.

Gjykojmë se nga Bashkia Shkodër nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

Gjykojmë se nga Bashkia Shkodër nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

4. Për auditimin mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit publik me objekt "Rikonstruksion Rruga "Daniel Mozali" Loti II 2021

Për auditimin e kësaj procedure prokurimi u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Sistemi i Prokurimit Elektronik (SPE) të bashkisë Shkodër, për këtë procedurë prokurimi;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Objekti i kontratës "Rikonstruksion Rruga "Daniel Mozali" Loti II, me vlerë totale 7,811,219 lekë, data e tenderit 29.03.2021, data e lidhjes së kontratës 10.05.2021, kohëzgjatja në 4 muaj.

Në procedurën e prokurimit me objekt: "Rikonstruksion Rruga "Daniel Mozali" Loti II", me fond limit 7,811,219 lekë pa TVSH, me burim financimi buxheti i bashkisë viti 2021 sipas VKB nr.

63 datë 28.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021 - 2023 të Bashkisë së Shkodrës“ për investime.

Nga auditimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) rezulton se kanë marrë pjesë 3 OE:

- 1- “N...” SHPK me ofertë 6,207,233 leke pa TVSH;
- 2- “D... I...” SHPK me ofertë 6,790,140 leke pa TVSH;
- 3- “Rr... G...” SHPK me ofertë 7,441,820.4 lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar operatorët ekonomik si më poshtë:

1. “N...” SHPK për arsye se: nuk ka deklaruar kontratën me Bashkinë Roskovec “Zgjerim i rrugës Jagodin-Sukë-Strum, L=9.57 km” njoftim fituesi shpallur më datë 05.03.2021; nuk ka paraqitur dokumentacion se disponon murator, si dhe mungon dokumentacioni për betonierën;
2. “D... I...” SHPK, pasi nuk ka paraqitur vërtetimin për numrin mesatar të punonjësve për tre muajt e fundit, si dhe certifikatën e transportit për automjetin me targa AA...LX.

Nga sa më sipër AK ka identifikuar si ofertën më të suksesshme duke shpallur fitues: “Rr... G...” SHPK me vlerë 7,441,820.4 lekë pa TVSH.

Nga shqyrtimi në SPE i kësaj procedure prokurimi konstatohet se OE “D... I...” SHPK nuk ka paraqitur vërtetimin për numrin mesatar të punonjësve për tre muajt e fundit, por ka paraqitur listë-pagesat e dorëzuara në sigurimet shoqërore për muajt dhjetor 2020 dhe janar –shkurt 2021 me përkatësisht 85, 88 dhe 89 punonjës, si dhe vërtetimin se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datë 16.03.2021. Mbi këtë bazë AK është siguruar se OE plotëson numrin e kërkuar të punonjësve, si dhe nuk ka evazion fiskal dhe kontributiv, për ta vlerësuar dhe konsideruar si devijim të vogël që nuk prek thelbin e ofertës.

Edhe në rastin e mungesës së certifikatës së transportit për automjetin me targa AA...LX të këtij operatori, KVO duhej ta vlerësonte si devijim të vogël që nuk prek thelbin e ofertës, për më tepër që është certifikatë që lëshohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Sa më sipër nuk cenohet siguria e AK në realizmin e kontratës, nisur dhe nga fakti se diferenca e ofertës së OE të shpallur fitues me këtë OE është 651,680 lekë. KVO i përbërë nga T.M., P.M. dhe A.C. me veprimet dhe mosveprimet e tyre, ka sjellë për pasojë kryerjen e shpenzimeve pa efektivitet në vlerën 651,680 lekë.

OE i shpallur fitues “Rr. G.” SHPK ka deklaruar se disponon mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve të kësaj kontrate:

Të dhëna për disponimin e mjeteve nga OE fitues

NË PRONËSI				
Lloji i mjetit	Targa	Nr. lejes së qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1. Mjet transporti vetëshkarkues mbi 10 ton (kapac. mbajtes)	AB...AD	SHD086....	ËMAF02R232M14...	
2. Mjet transporti vetëshkarkues 3.5 – 7 ton (kapac. mbajtes)	AA...BF	SHF002....	ËDB6740421570....	Është edhe me vinç
3. Eskavator me goma	AC MT ...	SHD029....	117...	
4. Eskavator me goma	AC MT ...	SHD033....	718...	
5. Grejder				Kontrate shitblerjeje Nr. Rep 1624;Nr:Kol 457
6. Autobitumatriçe	AA 732 AF	SHF026....	ËDB6740421551....	
7. Asfaltoshtruese			5081....	Kontrate shitblerjeje Nr:Rep 135; Nr:Kol.75
8. Asfaltoshtruese				DEKL. DOG. R84138 DT:02/08/2018
9. Rrul kompresor për ngjeshje asfalti			10165012....	Kontrate shitblerjeje Nr. Rep 135 ; Nr.Kol 75
10. Rrul kompresor për ngjeshje asfalti				Dekl. Doganore R6396 Dt:06/2/2010
11. Autobot uji	AA... FL	SHD006....	ZCFC357010520....	
12. Autovinç	AA... KD	SHF069....	4430001....	

13. Rrul me vibrim				Faturë Nr:13 Dt: 17/02/14
14. Auto – betoniere	AC MT...	SHD029...	67...	
15. Betoniere				Faturë Nr:908 Dt:26/11/2014

Burimi: Të dhëna të dosjes së tenderit të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga shqyrtimi i pasqyrës së realizimit të prokurimeve 2021 dhe në SPE rezulton se më datë 28.12.2020 është zhvilluar tenderi me objekt: “Rikonstruksion Rruga “Daniel Mozali”, me vlerë totale përfundimtare të kontratës 9,612,953.28 lekë, dhe më datë të lidhjes së kontratës 01.02.2021, kohëzgjatje 4 muaj, pra deri më datë 30.05.2021.

Ndërkohë që tenderi me objekt: “Rikonstruksion Rruga “Daniel Mozali” Loti II” është zhvilluar më datë 29.03.2021, OE “Rr... G...” SHPK i shpallur fitues në këtë procedurë prokurimi ka deklaruar të njëjtat makineri të angazhuar në zbatimin e kontratës me objekt “Rikonstruksion Rruga “Daniel Mozali”, në kundërshtim me DT, Shtojca 11, 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 12.vii: “Operatori ekonomik ofertues (Administratori i shoqërisë ofertuese), duhet të paraqesë një deklaratë që makineritë e kërkuara në pikën 2.3.12, nuk janë të angazhuara në ndonjë kontratë/kontrata të tjera në fuqi, dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga Autoritetin Kontraktor Bashkia Shkodër, por vetëm për këtë objekt. Gjithashtu në deklaratë duhet të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qira. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjate vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjate zbatimit të kontratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa “a” të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për Prokurimin Publik”.

OE i shpallur fitues në deklaratën për angazhimin e makinerive të paraqitur më datë 29.03.2021, ka deklaruar se: “Mjetet dhe pajisjet teknike të deklaruar në këtë kontratë të nevojshme për realizimin e punimeve nuk janë të angazhuara në asnjë kontratë tjetër në fuqi dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, por vetëm për këtë objekt”, në një kohë që i ka pasur të deklaruar dhe të angazhuara në realizimin e kontratës “Rikonstruksion Rruga “Daniel Mozali”.

Gjithashtu, në kundërshtim me pikën 9, Shtojca 11, 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, të DT: “Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate. Bashkëlidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma.”, ka deklaruar se drejtuesi teknik A.M. është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate më 07.06.2021, në një kohë që këtë drejtues teknik e ka deklaruar dhe në tenderin e datës 29.03.2021 me objekt “Rikonstruksion Rruga “Daniel Mozali” Loti II.

Në këto kushte OE “Rr... G...” SHPK i ka të gjitha makineritë e deklaruar dhe të angazhuara në kontratat të tjera në fuqi. KVO e përbërë nga T.M., P.M. dhe A.C. ka vepruar në kundërshtim me pikën 3, të nenit 66 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”, pasi ka kualifikuar OE “Rr... G...” SHPK pa i përmbushur kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në kundërshtim të germës (b) të pikës 2 të nenit 93 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 të ndryshuar, KVO nuk i ka propozuar titullarit të AK anulimin e procedurës së tenderimit, pasi nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme.

Si konkluzion, në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion Rruga “Daniel Mozali” Loti IP”, me fond limit 7,811,219 lekë pa TVSH kanë marrë pjesë tre OE, nga të cilët dy janë skualifikuar.

Skualifikimi i OE “D... I...” SHPK për mungesë të vërtetimit për numrin mesatar të punonjësve për tre muajt e fundit, në një kohë që ka paraqitur listë-pagesat e dorëzuara në sigurimet shoqërore, si dhe mostrajtimin e mungesës së certifikatës së transportit si devijim të vogël që nuk prek thelbin e ofertës, ka sjellë për pasojë shpenzime pa efektivitet në realizimin e kësaj kontrate në vlerën vlerën 651,680 lekë.

OE “Rr... G...” SHPK është shpallur fitues me ofertën 7,441,820.4 lekë pa TVSH në kushtet e mosplotësimit të kërkesave në dokumentet e tenderit, pasi i ka të gjitha makineritë e deklaruara dhe të angazhuara në kontratat të tjera në fuqi, në kundërshtim me DT, Shtojca 11, 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 12.vii.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/5, datë 08.03.2024 nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 973/6, datë 09.04.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Shoqëria “D... I...” SHPK nuk i ka përmbushur dy kriteret pasi, nuk ka paraqitur dokumentin vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjësve të siguruar për secilën nga periudhat e mësipërme si dhe certifikatën e transportit për mjetin e marrë me qira me targa AA...LX.

Paraqitja e vërtetimit nr. T03717856, datë 16.03.2021 “Vërtetim për pagim detyrimesh”, nuk e ezauron aspak mungesën e paraqitjes së vërtetimit për pagesën e sigurimeve shëndetësore dhe që të vërtetojë se subjekti nuk ka detyrime për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Nga ana tjetër mosparaqitja e certifikatës së transportit nuk mundet kurrsesi të futet në kategorinë e devijimeve të vogla që nuk cenon thelbin e ofertës, pasi kjo është një kërkesë e qartë në kriteret e përcaktuara në DST që nuk len vend për asnjë interpretim tjetër.

- Nga verifikimi i makinerive të deklaruara nga shoqëria “Rr... G...” SHPK vërehet qartë se, numri i makinerive të deklaruara në fazën e parë është dyfishi i kapaciteteve të kërkuara nga AK, prandaj kjo shoqëri ka deklaruar në fazën e dytë një pjesë të makinerive që ndodhen në fazën e parë, por që janë dyfishi si p.sh. kamion vetëshkarkues mbi 10 ton 2(dy) copë, kamion vetëshkarkues 3.5-7 tone 2 (copë), rrul me vibrim 2 (copë), eskavatorë 2 (dy) copë etj. Pra, shoqëria plotëson kushtin kumulativ të disponimit të makinerive në total për dy objektet, pavarësisht faktit që ndodhen në të njëjtin vend.

Pra KVO, ka vepruar drejt duke kualifikuar operatorin ekonomik “Rr... G...” SHPK pasi plotëson të gjitha kriteret për kualifikim.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/6, datë 09.04.2024 grupi i auditimit gjykon se:

- Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarohet se, KVO, në zbatim të nenit 75, pika 4, paragrafi i parë, Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave dhe nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Gjithashtu, meqenëse qëllimi i prokurimit publik, midis të tjerave është të rrisë eficiencën dhe efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, duke u siguruar AK që kontrata realizohet në afat dhe me cilësi, duke nxitur pjesëmarrjen e OE, është në kompetencën e plotë të KVO, trajtimi si devijime të vogla, dhe kursimin e fondeve buxhetore.

- Referenca në DT, Shtojca 11, 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 12.vii që operatori ekonomik ofertues (Administratori i shoqërisë ofertuese), duhet të paraqesë një deklaratë që makineritë e kërkuara në pikën 2.3.12, nuk janë të angazhuara në ndonjë kontratë/kontrata të tjera në fuqi, dhe nuk janë të deklaruara në procedurat e shpallura fitues nga Autoritetin Kontraktor Bashkia Shkodër, por vetëm për këtë objekt, nuk lë hapsira për vlerësim të plotësimit kumulativ të disponimit të makinerive në total për dy objektet.

Gjithashtu, paraqitja e së njëjtës kontratë nga dy OE pjesëmarrës në procedurë prokurimi është ndërhyrje në ofertë, në kuptimin dhe zbatimin e nenit 81, pika 1 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 të ndryshuar, që rezulton me përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave në të cilat është përfshirë ofertuesi.

Gjykojmë se nga Bashkia Shkodër nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

5. Për auditimin mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit publik me objekt “Sistemin asfaltim rruga Oendër Mes – Kullaj faza III” 2021

Auditimi i kësaj procedure prokurimi u shqyrtua në Sistemi i Prokurimit Elektronik (SPE) të bashkisë Shkodër.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Në procedurën e prokurimit me objekt: "Sistemim asfaltim rruga Qendër Mes – Kullaj faza III" me fond limit 11,450,516 lekë pa TVSH, me burim financimi buxhetin e Bashkisë viti 2021 sipas VKB nr. 63 datë 28.12.2020 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021 - 2023 të Bashkisë së Shkodrës për investime, me datë të zhvillimit të tenderit 07.06.2021, kanë marrë pjesë:

- 1- "N..." SHPK me ofertë në vlerën 9,523,102 leke pa TVSH;
- 2- "Rr... G..." SHPK me ofertë në vlerën 9,627,749.90 leke pa TVSH;
- 3- "D... I..." SHPK i cili nuk ka paraqitur oferte.

Janë skualifikuar:

1. "D... I..." SHPK pasi nuk ka paraqitur dokumentacion kualifikues
2. "N..." SHPK pasi sipas KVO: Certifikata e transportit për mjetin me targa AA...XI, KO...B, AB...AM është për përdorim vetjak dhe nuk mund të jepet me qira për të tretë.

- Stafii drejtues është i angazhuar në një kontratë tjetër me Bashkinë Shkodër me objekt: Rikonstruksion rruga Freskej, sipas rekomandimeve të KLSH.

Në këto kushte AK ka identifikuar ofertën më të suksesshme "Rr... G..." SHPK me ofertë në vlerën 9,627,749.90 leke pa TVSH, vlerë e shpallur fituese.

Nga auditimi në SPE rezulton se OE i shpallur fitues "Rr... G..." SHPK, në plotësim të kërkesave të DT, Shtojca 11, 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 12: "Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit", ka plotësuar dhe nënshkruar deklaratën "Mbi disponimin e makinerive" si më poshtë:

Të dhëna për disponimin e mjeteve nga OE fitues

NË PRONËSI				
Lloji i mjetit	Targa	Nr. lejes së qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1. Mjet transporti vetshkarkues mbi 10 ton (kapac. mbajtes)	AB...AD	SHD086....	ËMAF02R232M14....	
2. Autovinç	AA...KD	SHF069....	4430001....	
3. Mjet transporti vetshkarkues 3.5 – 7 ton (kapac. mbajtes)	AA...BF	SHF002....	ËDB6740421570....	Eshte edhe me vinc
4. Eskavator me zinxhir				Dekl. Doganore R6946 Dt:01.10.2013
5. Rrul me vibrim				Faturë Nr:13 Dt: 17/02/14
6. Autobot uji	AA...FL	SHD006....	ZCFC357010520....	
7. Autobitumatriçe	AA...AF	SHF026....	ËDB6740421551....	
8. Asfaltoshtuese			5081....	Kontrate shitblerjeje Nr:Rep 135; Nr:Kol.75
9. Asfaltoshtuese				DEKL. DOG. R84138 DT:02/08/2018
10. Rrul kompresor për ngjeshje asfalti			10165012....	Kontrate shitblerjeje Nr. Rep 135 ; Nr:Kol 75
11. Rrul kompresor për ngjeshje asfalti				Dekl. Doganore R6396 Dt:06/2/2010
12. Auto – betoniere	AC MT ...	SHD029....	67...	
13. Betoniere				Faturë Nr:908 Dt:26/11/2014
14. Grejder				Kontrate shitblerjeje Nr. Rep 1624;Nr:Kol 457

Burimi: Të dhëna të dosjes së tenderit të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Gjithashtu, në deklaratën "Për angazhimin e makinerive" e plotësuar dhe e nënshkruar më datë 07.06.2021 nga përfaqësuesi i subjektit "Rr... G..." SHPK, midis të tjerave është cilësuar: "Mjetet dhe pajisjet teknike të deklaruara në këtë kontratë të nevojshme për realizimin e punimeve nuk janë të angazhuara në asnjë kontratë tjetër në fuqi dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, por vetëm për këtë objekt." Kjo deklaratë është plotësuar në zbatim të kërkesave të DT, Shtojca 11, 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 12.vii "Operatori ekonomik ofertues (Administratori i shoqërisë ofertuese), duhet të paraqesë një deklaratë që makineritë e kërkuara në pikën 2.3.12, nuk janë

të angazhuara në ndonjë kontratë/kontrata të tjera në fuqi, dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga Autoritetin Kontraktor Bashkia Shkodër, por vetëm për këtë objekt. Gjithashtu në deklaratë duhet të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qira. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për Prokurimin Publik".

Nga të dhënat mbi realizimin e investimeve për vitin 2021 dhe auditimi në SPE, rezulton se OE "Rr... G..." SHPK, ka qenë pjesëmarrës dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues në tenderin e datës 29.03.2021 me objekt: "Rikonstruksion Rruga "Daniel Mozali" Loti II, me vlerë totale 8,930,184.48 lekë, për të cilin ka lidhur kontratën përkatëse më 10.05.2021, me kohëzgjatje 4 muaj nga data e nënshkrimit.

Në deklaratën e disponimit të makinerive për këtë kontratë, rezulton se janë paraqitur të njëjtat makineri që janë paraqitur dhe në tenderin me objekt: "Sistemim asfaltim rruga Qendër Mes – Kullaj faza III", pasi në datën e zhvillimit të këtij tenderi 07.06.2021, OE "Rr... G..." SHPK i ka makineritë e angazhuara në zbatimin e kontratës "Rikonstruksion Rruga "Daniel Mozali" Loti II, të lidhur më 10.05.2021 me kohëzgjatje deri më datë 09.09.2021.

Gjithashtu, në kundërshtim me pikën 9, Shtojca 11, 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, të DT: "Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma.", ka deklaruar se drejtuesi teknik A.M. është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate më 07.06.2021, në një kohë që këtë drejtues teknik e ka deklaruar dhe në tenderin e datës 29.03.2021 me objekt "Rikonstruksion Rruga "Daniel Mozali" Loti II.

Në këto kushte OE "Rr... G..." SHPK i ka makineritë e deklaruar dhe të angazhuara në kontratat të tjera në fuqi, si dhe drejtuesi teknik është deklaruar i angazhuar në një kontratë tjetër me bashkinë Shkodër. KVO e përbërë nga T.M., P.M. dhe A.Sh. ka vepruar në kundërshtim me pikën 2, të nenit 82 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 të ndryshuar. "Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim...", pasi ka kualifikuar OE "Rr... G..." SHPK pa i përmbushur kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në të njëjtën kohë nuk ka përdorur të njëjtat standarde në vlerësimin e ofertave, pasi për të njëjtën mangësi ka skualifikuar një OE dhe nuk e ka shqyrtuar duke e kualifikuar operatorin tjetër ekonomik.

Në kundërshtim të germës (b) të pikës 2 të nenit 93 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 të ndryshuar, KVO nuk i ka propozuar titullarit të AK anulimin e procedurës së tenderimit, pasi nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme.

Si konkluzion, në procedurën e prokurimit "Sistemim asfaltim rruga Qendër Mes – Kullaj faza III" me fond limit 11,450,516 lekë pa TVSH, kanë marrë pjesë tre OE, dhe janë skualifikuar dy prej tyre, duke shpallur fitues OE "Rr... G..." SHPK me vlerën 9,627,749.90 leke pa TVSH. Nga auditimi në sistem rezulton se OE i kualifikuar dhe shpallur fitues i ka makineritë e deklaruar dhe të angazhuara në kontratat të tjera në fuqi, si dhe drejtuesi teknik është deklaruar i angazhuar në një kontratë tjetër me bashkinë Shkodër, në kundërshtim me pikën 9, Shtojca 11, 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, të DT. Në këtë mënyrë, nga KVO është kualifikuar dhe shpallur fitues OE i cili nuk përmbush të gjitha kërkesat e dokumenteve të tenderit, tenderi duhej të ishte propozuar nga KVO për anulimin e tij.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/5, datë 08.03.2024 nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 973/6, datë 09.04.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Konstatimi juaj qëndron dhe është i drejte pasi shoqëria “Rr... G...” SHPK ka deklaruar të njëjtat makineri dhe staf në objektin: Rikonstruksion rruga Daniel Mozali Faza e II-te, gjë që nuk është vënë re nga ne si KVO.

Theksojmë vetëm faktin që bazuar në informacionet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes së Investimeve punimet në objektin: “Rikonstruksion rruga Daniel Mozali Faza e II-te” nuk kane filluar deri më datë 07.06.2021, data e hapjes së ofertave.

Gjithashtu, shoqëria “Rr... G...” SHPK, duke u nisur nga të dhënat e deklaruara mbi kontratat në proces disponon një kapacitet kumulativ mjetesh dhe stafi teknik që mund të realizojë disa kontrata brenda një harku të caktuar kohor.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/6, datë 09.04.2024 grupi i auditimit gjykon se:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se, referenca në DT, Shtojca 11, 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 12.vii që operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë një deklaratë që makineritë e kërkuara, nuk janë të angazhuara në ndonjë kontratë/kontrata të tjera në fuqi, dhe nuk janë të deklaruara në procedurat e shpallura fitues nga Autoritetin Kontraktor Bashkia Shkodër, por vetëm për këtë objekt, nuk lë hapësira për vlerësim të plotësisht kumulativ të disponimit të makinerive në total për dy objektet.

Gjykojmë se nga Bashkia Shkodër nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

6. Mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit publik me objekt “Mirëmbajtje e skemës ujitëse” 2021

Auditimi i kësaj procedure prokurimi u shqyrtua në Sistemi i Prokurimit Elektronik (SPE) të bashkisë Shkodër.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Procedura e prokurimit: Kërkese për propozim, burimi i financimit buxheti i bashkisë viti 2021, me objekt “Mirëmbajtje e skemës ujitëse”, me fond limit 6,106,616 lekë pa TVSH, tenderi i zhvilluar më datë 26.04.2021.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1- OE “N...” SHPK, me NIPT L.....L me vlerën 5,001,100 lekë;
- 2- OE “N...” SHPK me NUIS J.....U me vlerën 5,097,910 lekë;
- 3- BOE “G...” SHPK me NUIS J.....J & “E...” SHPK NUIS J.....D me vlerë 5,203,910 lekë;
- 4- OE “D... I...” SHPK me NUIS K.....R me vlerë 6,001,600 lekë.

Nga KVO me përbërje: M.M., Xh.P. dhe A.S. janë skualifikuar OE:

- “N...” SHPK për arsye se: Z.N figuron punonjës shërbimi të ushqimit dhe jo mekanik siç kërkohet në DST; Automjetet me targa KO....B dhe AB...AM janë për përdorim vetjak dhe jo për të tretë me qira; G.M nuk plotëson kushtet për të qenë Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë.

- “N...” SHPK për arsye se: Dokumentacioni për të vërtetuar punët e ngjashme ka mangësi, pasi në kontratën me objekt: “Shërbime mirëmbajtje, ndërtime, rehabilitime të kanaleve ujitëse Dibër”, nuk janë të pasqyruara zërat konkret që ka marrë përsipër të realizojë shoqëria “N...”, në mënyrë që KVO të vlerësojë në mënyrë të drejte vlerën e punimeve të ngjashme; mjeti me targa ACMT... bazuar ne lejen e qarkullimit nuk është ekskavator me goma por minifadromë. Gjithashtu edhe bazuar ne aktin normative nr.336 date 23.12.2020 certifikata e kontrollit teknik i ka kaluar afati i vlefshmërisë përtej këtij akti etj.

- BOE “G...” SHPK & “E...” SHPK për arsye se: Në kontratën e bashkëpunimit midis palëve datë 24.04.2021 nuk janë përcaktuar elemente konkrete që marrin përsipër të realizojnë secila prej shoqërive pjesëmarrëse; Kontrata e shërbimit datë 08.06.2018 nuk është e shoqëruar me situacionin përkatës etj.

Oferta e OE “D... I...” SHPK me vlerë të përgjithshme prej 6,001,600 leke pa TVSH është identifikuar nga KVO si oferta e suksesshme.

Nga shqyrtimi në SPE konstatohet se, OE “N...” SHPK, në përmbushje të pikës 10 të kapacitetit teknik, për të pasur në stafin e tij 1 (një) punonjës mekanik, ka paraqitur kontratën individuale të punës të datës 04.01.2021, si dhe dëshminë nr.007593, për profesionin mekanik për Z.N., të cilin KVO e ka konsideruar punonjës shërbimi të ushqimit, referuar kodit të vendosur në listë-pagesë 5246.01, sipas “Strukturës së listës kombëtare të profesioneve”. Duhet theksuar se Klasifikimi i Listës Kombëtare të Profesioneve, e njohur shkurtimisht si “LKP”, zbatohet për mbledhjen, klasifikimin dhe publikimin e të dhënave statistikore zyrtare (pika 2 e VKM nr.514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, si dhe sipas DT “10. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të pasqyruar në listë-pagesa për të paktën muajin e fundit, të pajisur me kontratë pune (të vlefshme), ose të kontraktuar në rastin kur makineritë janë me qera për manovratorët, me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) të lëshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë”, dhe nuk përbën kusht skualifikimi kodit i listës kombëtare të profesioneve.

Nga shqyrtimi në SPE konstatohet se OE “N...” SHPK për automjetet me targa KO...B dhe AB...AM ka paraqitur kontratat noteriale të qirasë me subjektin “C... O...” SHPK dhe qiradhënësin O.P., të shoqëruar me dokumentet që vërtetojnë regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme), ashtu siç përcaktohet në DT, pika 12.3 e kreut 2.3-Kapaciteti teknik. Pra OE “N...” SHPK ka përmbushur kërkesat e veçanta të kapacitetit teknike dhe KVO ka vepruar në mënyrë të gabuar duke i konsideruar se janë për përdorim vetjak dhe jo për të tretë me qira.

Edhe OE i shpallur fitues ka paraqitur kontratë qiraje për automjetin me targë AA...AY, me dokumente shoqërues njëloj si OE “N...” SHPK dhe nga ana e KVO nuk është konsideruar për përdorim vetjak.

Sipas DT, për përmbushjen e kapacitetit teknik, pika 9: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjese të stafit të shoqërisë një person që përmbush kriterin për të qenë kordinator në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe që të disponoj dëshmi trajnimi si ”Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18.02.2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 ”Për miratimin e rregullores ”Për sigurinë në kantier”. Për specialistin e shoqërisë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për ”Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë” e dhëne nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj dhe kontrata e punës, si dhe duhet të jetë i përfshirë në liste pagesën e shoqërisë për të paktën muajin e fundit”. Në përmbushje të kësaj kërkesë të DT, OE “N...” SHPK ka paraqitur kontratën individuale të punës të datës 04.02.2020 me znj. G.M., me profesion inxhinierë ndërtimi, si drejtuese teknike, certifikatën e trajnimit “Përgjegjës për sigurinë në kantier dhe mbrojtjen e shëndetit” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18.02.2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 ”Për miratimin e rregullores ”Për sigurinë në kantier”, certifikatën e sigurimit teknik; është paraqitur në listë-pagesën e muajt të fundit 2142.29 –Inxhinier zbatimi në ndërtim. Pra, OE “N...” SHPK është skualifikuar padrejtësisht nga KVO, pasi i ka përmbushur kriteret e veçanta të kapacitetit teknik.

Bazuar në sa më sipër, KVO e përbërë nga z. M.M., z. Xh.P. dhe z. A.S., ka skualifikuar padrejtësisht OE “N...” SHPK, me ofertë 5,001,100 lekë, duke rritur shpenzimet e kësaj kontrate me 1,000,500 lekë (6,001,600 – 5,001,100).

Si konkluzion, në procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e skemës ujitëse”, me fond limit 6,106,616 lekë pa TVSH, tenderi i zhvilluar më datë 26.04.2021, në të cilën kanë marrë pjesë 4 OE, KVO skualifikuar në mënyrë të padrejtë OE “N...” SHPK me vlerën më të ulët ka përmbushur kërkesat e DT, pasi punonjësi me profesionin mekanik është me dëshmi dhe figuron në listë-pagesa; automjetet me targa KO...B dhe AB...AM janë për marrë me qira dhe

paraqitur në ofertë me dokumentacionin përkatës shoqërues, si dhe inxhinieri plotëson kushtet për të qenë Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë, në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit.

Veprimet dhe mosveprimet e KVO, duke skualifikuar padrejtësisht ofertën më të ulët kanë sjellë për pasojë shpenzime pa efektivitet në realizimin e kësaj kontrate në vlerën 1,000,500 lekë.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/5, datë 08.03.2024 nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 973/6, datë 09.04.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Nga verifikimi i kontratës së punës, neni 2 “Pershkrimi i punës” është cilësuar që punonjesi pranon të punoje në profesionin specialist sipas kualifikimeve që disponon por pa e cilesuar profesionin dhe punen që do të realizojë ne kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë” i ndryshuar.

Nga ana tjetër, kodi në listë pagesë të muajit mars 2021 te paraqitur nga shoqëria “N...” SHPK , për punonjesin Z.N. korrespondon me profesionin “Punonjës të shërbimeve të ushqimit” ne kundërshtim me kriterin e percaktuar ne DST per disponimin e një punonjesi mekanik, si dhe në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar”, i cili është i detyrueshëm për zbatim edhe nga personat fizikë dhe juridikë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, pra për të gjithë ofertuesit në procedurat e prokurimit si persona fizikë apo juridikë.

- Nga shqyrtimi i certifikatës së transportit nr.12 date 07.03.2017 për automjetin e marrë me qira me targa KO...B lëshuar nga Bashkia Korçë rezulton se është me objekt:Transport mallrash për llogari të vet, që bazuar në Ligjin Nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, neni 41, transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

E njëjta gjë dhe për certifikatën e automjetit me targa AB...AM.

- Për punonjësën N.V. i deklaruar si mekanik nga shoqëria “D... I...” SHPK, ka paraqitur kontratën e punës datë 01.01.2021 dhe në listë-pagesën e muajit mars kodi i punësimit përputhet listën kombëtare të profesioneve.

- Automjeti me targa AA...AY që shoqëria “D... I...” SHPK i paraqitur për plotesimin e kriterit të disponimit të mjetit Autovinç 5 ton theksojme se ky mjet i marrë me kontratë qiraje është automjet për përdorim të veçantë (APV) dhe nuk trajtohet me certifikatë transporti të mallrave.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/6, datë 09.04.2024 grupi i auditimit gjykon se:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se, Klasifikimi i Listës Kombëtare të Profesioneve, zbatohet për mbledhjen, klasifikimin dhe publikimin e të dhënave statistikore zyrtare dhe nuk është kriter i percaktuar në DT, që të shërbejë si shkak moskonsiderim i plotësimit të kriterit me pasojë skualifikimin e OE.

Gjithashtu, dhe për automjetet e marra me qira, nuk është kriter kualifikimi lloji i certifikatës, por certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme), gjë e cila është plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm.

Gjykojmë se nga Bashkia Shkodër nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

7. Mbi zbatimin e afateve kontraktuale “Rikonstruksioni i bllokut të pallateve “Mehmet Pashë Plaku” (përballë shkollës “Ali Laçej)” dhe “Sistemim asfaltim segmente rrugësh Rilindja - Demokracia-Hotit në Hot të Ri” 2021)

Për afatet e zbatimit të këtyre dy kontratave u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë :

1. Dokumentacioni i zbatimit të kontratës “Rikonstruksioni i bllokut të pallateve “Mehmet Pashë Plaku” (përballë shkollës “Ali Laçej)”;
2. Dokumentacioni i zbatimit të kontratës “Sistemim asfaltim segmente rrugësh Rilindja - Demokracia-Hotit në Hot të Ri”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

1. Nga shqyrtimi i kontratës me nr.13181/12 prot., datë 27.11.2020 me objekt “Rikonstruksioni i bllokut të pallateve “Mehmet Pashë Plaku” (përballë shkollës “Ali Laçej)” midis AK Bashkia Shkodër dhe OE “K... G... K...” SHPK me përfaqësues ligjor z. H.S., me fond të kontraktuar 4,616,151 lekë pa TVSH, me afat zbatimi 3 muaj nga dita që konstruktorit i jepet leja për të hyrë në kantier, rezulton se ka pasur kërkesë për shtyrje të punimeve më datë 22.02.2021 nga mbikëqyrësi dhe kontraktori, me nderprerjen e punimeve në këtë datë, në të cilën kërkohet shtyrja me 45 ditë, afat për të cilin ka qenë dakord dhe përfaqësuesi i Zyrës së ndjekjes së investimeve ing. R.G.

Në këtë kërkesë, midis të tjerave cilësohet se: *“...gjatë këtyre ditëve ka patur reshje të shumta të shiut dhe të shoqëruara më pas me temperature të ulëta, për pasojë nuk është e mundur të punohet në kushte normale për hedhjen e betonit dhe të shtresave asfaltike”*,

Sipas dokumentacionit “Ditarit të punimeve”, ditari në objekt i periudhës 01.12.2020 deri më 22.02.2021 koha ka qenë e mirë dhe nuk ka pasur as reshje shiu dhe as temperature të ulëta, të regjistruara në rubrikën e “Moti dhe temperatura” të Ditarit në objekt, i cili është nënshkruar nga Drejtuesi i punimeve ing. V.Ç., drejtuesi ligjor H.S. dhe mbikëqyrësi i punimeve “D...” SHPK ing. V.T.

Nga sa më sipër, konstatohet se, ndërprerja dhe shtyrja e afatit të kësaj kontrate nuk është e bazuar në dokumentim të kushteve atmosferike, sipas ditarit të punimeve, si dhe as në rastin e forcës madhore apo në interesin publik.

2. Nga shqyrtimi dosjes së zbatimit të kontratës “Sistemim asfaltim segmente rrugësh Rilindja - Demokracia-Hotit në Hot të Ri” Ref-72499-09-21-2020, me nr.13191/12 prot., datë 11.11.2020, midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe operatorit ekonomik “V...” SHPK Rilindja- Demokracia-Hotit në Hot të Ri”, me vlerë të kontratës 5,005,099.6 lekë pa TVSH, me afat 2 muaj nga dita që kontraktorit i jepet leja për të hyrë në kantier, rezulton se, më datë 20.01.2021 sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve i ka kërkuar bashkisë Shkodër ndërprerje dhe shtyrje të kontratës së punimeve *“...për një afat 30 ditor për arsye të kushteve atmosferike të papërshtatshme për hedhje asfalti (reshjeve të shiut dhe temperaturave të ulëta”*. Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Investimeve dhe Infrastrukturës z. A.L. ka vlerësuar të drejtë kërkesën e mësipërme për ndërprerjen e punimeve nga data 20.01.2021 deri më 18.02.2021 dhe miratimin e shtyrjes së afatit kohor të punimeve, mbarim të punimeve brenda datës 26.02.2021.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e zbatimit të kontratës të dokumenteve “Ditari i objektit”, të nënshkruar faqen e parë nga sipërmarrësi Drejtuesi ligjor i subjektit “V...” SHPK dhe mbikëqyrësit të punimeve “I... P...” SHPK me përfaqësues ligjor ing. S.K. dhe Drejtues teknik Ing. G.L., si dhe në çdo fletë nënshkruar nga Drejtuesi teknik i sipërmarrësit ing. J.D. dhe mbikëqyrësit ing. G.L. rezulton se, *në periudhën 27.11.2020 deri më datë 19.01.2021, moti ka qenë i mirë, kontraktori ka qenë dhe ka punuar në objekt normalisht me personelin teknik, specialistët dhe punëtorët, si dhe me makineritë dhe pajisjet përkatëse çdo ditë, pa pasur pengesa për shiun dhe temperaturat e ulëta. Duhet theksuar se megjithëse në formatin e të dhënave të ditarit të objektit kërkohet vendosja e temperaturave minimale dhe maksimale, ato nuk rezultojnë të plotësuara, çka nënkupton se me motin e mirë nuk ka pasur ngrica.*

Bazuar në sa më sipër konstatohet se, shtyrja e afatit të zbatimit të kësaj kontrate nuk është e bazuar në dokumentim të kushteve atmosferike, sipas ditarit të punimeve, si dhe as në rastin e forcës madhore apo në interesin publik.

Si konkluzion, nga shqyrtimi i zbatimit të afateve kontraktuale në dy kontrata të punimeve civile: *“Rikonstruksioni i bllokut të pallateve “Mehmet Pashë Plaku” (përballë shkollës “Ali Laçej)” dhe “Sistemim asfaltim segmente rrugësh Rilindja - Demokracia-Hotit në Hot të Ri”* në vitin 2021 ndërprerja dhe shtyrja e afatit të punimeve nuk është e bazuar në dokumentim të kushteve atmosferike, sipas ditarit të punimeve, si dhe as në rastin e forcës madhore apo në interesin publik.

8- Mbi zhvillimin e procedurës me objekt “Rikonstruksion i pjeshëm shkolla “Azem Hajdari” viti 2022.

Nga auditimi i dosjes së prokurimeve në formatin elektronik dhe dokumenteve të sjella nga operatori fitues rezultoi:

Me urdhrin e prokurimit nr. 885, datë 11.10.2022 nxjerrë nga titullari i autoritetit kontraktor z. B.S. është përcaktuar fondi limit 22,153,745 lekë pa t.v.sh. forma e procedurës e tenderit “E hapur” marrëveshje kuadër me mjete elektronike ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 886, datë 11.10.2022, Komisioni i vlerësimit të Ofertave, data **04.11.2022** hapja e tenderit, në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* kreu VII, neni 74 “ pika 2. *“Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të*

specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit/entit kontraktor krijon njësinë e prokurimit..” dhe neni 75 pika 1 “...1. Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit/entit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës, nëse nevojitet për objektin e prokurimit,.....”.

Nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit z. V.Sh. me procesverbalin e datës 07.10.2022 është hartuar dërguar Drejtorisë së Prokurimeve është përcjellë projekti, preventivi me vlerën 22,153,745 lekë pa TVSH.

Zërat e preventivit janë hartuar zërat referuar manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, të rishikuara, që do të përdoren në përcaktimin e fondit limit të objekteve në ndërtim, sipas tabelave që i bashkëlidhen VKM nr. 629, dt. 15.07.2015 i ndryshuar.

Një pjesë zërash të punimeve çmimet janë hartuar me analiza punimesh bashkëngjitur preventivit në përputhje me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

Nga Njësia e Prokurimit E.D., V.Sh., D.K., bazuar rekomandimeve të asistencës së APP-së sipas VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 78 pika 3 “Nëse gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, përpara publikimit të një procedure prokurimi, njësia e prokurimit ka nevojë për asistencë, komunikon me APP-në, për të marrë një mendim të specializuar mbi mënyrën e zbatimit të legjislacionit të prokurimit publik. Me qëllim dhënien e asistencës, ngritjen e kapaciteteve dhe sigurimin e mirëzbatimit të legjislacionit të prokurimit publik, APP, në koordinim me personin/at përgjegjës për prokurimin mund të asistojë këto të fundit gjatë përgatitjes të dokumenteve të tenderit në përputhje me dokumentet standarde të tenderit dhe rregullat e prokurimit publik. dërguar me e-mail në datë 19.10.2022 është mbajtur procesverbali për hartimin e dokumenteve përfundimtare të tenderit referuar urdhrit të prokurimit nr. 885, datë 11.10.2022 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarde të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit dhe data e hapjes së ofertave datë **04.11.2022** në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 78 pika 1. “Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit, njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit, sipas llojit të procedurës e tipit të kontratës” dhe 2. “Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit. Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit”.

Nga Njësia e Prokurimit E.D., V.Sh., D.K. bazuar rekomandimeve të asistencës së APP-së nr. 3873, datë 10.06.2021 janë hedhur në DST në formatin elektronik procesverbali i miratimit dhe argumentimit të specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta të pranimit me argumentet përkatëse sipas kërkesave të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 7, “Rregulla të përgjithshme për formën dhe mënyrën e shpalljes së njoftimeve” pika 3: “Hedhja e njoftimit të kontratës, dokumenteve të tenderit dhe procesverbalit të argumentimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit, në sistemin elektronik, bëhet nga vetë autoriteti/enti kontraktor”

Nga auditimi rezulton se në DST është kërkuar:

Pika 2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Referuar modelit të procesverbalit pune të saktësuar të rekomanduar nga APP me nr. 3872, datë 10.06.2021 hartimi i kësaj kërkesë ekonomike financiare duhet të formulohet si më poshtë:

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare _____, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve (shëno bazën ligjore), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Njësia e Prokurimit duhet të sqarojë se operatorët certifikojnë bilancet vetëm kur ata janë në kushtet që parashikon ligji nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" neni 41. "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabel ose shoqëri audituese:

c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

1. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

2. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

3. ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel".

Me nr. 15144/10, dt. 16.12.2022 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga Kryetari z. B.S. me nr. 15144/11, dt. 16.12.2022 mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 84 1. "Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit/entit kontraktor.

Kanë paraqitur ofertat 4 operatorë:

1-Operatori ekonomik "N..." SHPK vlerë të fortës 18,778,897 leke pa tvsh.

2-Operatori ekonomik "M... K... R... E..." SHPK vlerë të ofertës 20,474,042 leke pa tvsh

3- Bashkimi i operatorëve ekonomik "B..." SHPK & "N..." SHPK përfaqësuar me prokure të posaçme nga "B..." SHPK me vlerë të ofertës 21,833,955 lekë pa tvsh.

4-Operatori ekonomik "V... K..." SHPK vlerë të ofertës 22,148,296 leke pa tvsh.

Janë skualifikuar një operator si më poshtë:

1-Operatori ekonomik "N..." SHPK vlerë të ofertës 18,778,897 leke pa tvsh.

Për arsyen e mëposhtme:

Operatori ekonomik "N..." SHPK nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26, pika 6, ku përcaktohet se: "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin pasi gjatë shqyrtimit të këtij dokumentacioni rezulton:

-Referuar QKB Historik nuk ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Berat për vitin 2022.

-Nuk plotëson kriterin për disponimin në staf të inxhinierit elektronik ose ekuivalent pasi z.M. M. referuar diplomës së shkollës së lartë nuk është inxhinier elektronik apo ekuivalent por është informaticien.

- Certifikata e transportit për automjetin me targa AB...AM i marrë me qira është për transport për llogari të vet dhe jo transport për të tretë me qira.

Nga auditimi rezulton se:

Në DST është kërkuar 1(nje) inxhinier elektronik/informatik ose ekuivalent dhe operatori "N..." SHPK ka paraqitur dokumrntet sipas vetdeklarimit dhe sipas KVO se është i diplomuar informaticien dhe se plotëson kërkesën e DST.

Nga auditimi i ofertatave të ofertuesve të kualifikuara si të vlefshme, rezulton si më poshtë:

1. "M... K... R... E..." SHPK, me vlerë të ofertës 20,474,042 lekë pa TVSH.

Subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. 1534 datë 24.03.2022 nga Bashkia Tiranë se ka likuiduar detyrimet vendore për vitin 2022. Nuk ka paraqitur vërtetim nga Bashkia Tiranë për periudhën tjetër të vitit 2022 kur në extratin historik të subjektit rezulton se në datën 09.06.2022 "Kanë ndodhur ndryshimet e mëposhtme në Adresat e Aktivitetit: (Depozitim i vendimit datë 08.06.2022 për mbyllje dhe hapje adrese dytësore dhe përditësim të të dhënave të kontaktit) është Shtuar Adresa: "Tiranë; TIRANE; Tiranë; ; TIRANE; Rindërtim i Godinës së Fakultetit të Bioteknologjise dhe Ushqimit, UBT" është Hequr Adresa: "Tirane; TIRANE; Kamzë; KAMEZ; Rindërtim i Godinës se Fakultetit të Bioteknologjise dhe Ushqimit, UBT. Gjithashtu duhej të paraqitej edhe vërtetimi nga Bashkia Kamzë pasi adresa dytësore është mbyllur në datën 08.06.2022.

Sa konstatuar më lart operatori ekonomik "M... K... R... E..." SHPK, nuk ka plotësuar detyrimin për të paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, duke mos paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore që vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime.

Në kundërshtim me kërkesat e nenit 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, të ligjit nr.131/2015 "Për QKB" i ndryshuar, si dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 "Për QKR" i ndryshuar.

Midis operatorit "M... K... R... E..." SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Shkodër është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 690, datë 28.12.2022 për "Rikonstruksion i pjesshëm shkolla Azem Hajdari" me vlerën 20,474,042 lekë pa TVSH. (24,324,526 lekë me TVSH) me afat punimesh 2 muaj nga data e fillimit të punimeve.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/5, datë 08.03.2024 nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 973/6, datë 09.04.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Ne lidhje me problematikën e konstatuar nga ana juaj sqarohjmë se operatori ekonomik M... K... R... E... sh.p.k. ka paraqitur ne sistemin e APP, SPE vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore nga Bashkia Kamez nr.1535 prot date 18.05.2021(bashkëlidhur observacionit) dhe referuar ekstraktit te QKB është saktësuar adresa nga ; TIRANE; Kamez; ; KAMEZ; Rindërtime i Godinës se Fakultetit te Bioteknologjise dhe Ushqimit, UBT; ne "Tirane; TIRANE; Tirane; ; TIRANE; rindërtim i Godinës se Fakultetit te Bioteknologjise dhe Ushqimit, UBT; "(bashkëlidhur vendimi i asamblesë nr.45 prot date 08.06.2022) prandaj ndaj Bashkisë Kamze operatori ekonomik M... K... R... E... sh.p.k. nuk ka detyrime për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022.

Operatori ekonomik M... K... R... E... sh.p.k. ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore nga Bashkia Tirane nr.M1534 prot date 24.03.2022 ku ka selinë kryesore dhe ku ka adresën dytësore te deklaruar tek seksioni Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit TIRANE; Rindërtime i Godinës se Fakultetit te Bioteknologjise

dhe Ushqimit, UBT e cila është hapur me date 09/06/2022 dhe referuar ekstraktit të QKB është mbyllur me date 28/04/2023.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/6, datë 09.04.2024 grupi i auditimit gjykon se:

- *Sa janë konstatuar rezulton se operatori ekonomik "M... K... R... E..." SHPK, nuk ka plotësuar detyrimin për të paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, duke mos paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore që vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime.*

Argumenti se "punimet në këtë objekt nuk kanë përfunduar" nuk kanë të bëjnë me vërtetimin e Bashkisë pasi me çeljen e adresës dytësore lind detyrimi për taksat dhe tarifat dhe se bashkia në të gjitha rastet lëshon vërtetimin nëse kanë detyrime ose jo dhe në dokumentet e sjella nga operatori ky vërtetim mungon kur në ekstraktin historik kjo adresë dytësore figuron.

Gjykojmë se nga Bashkia Shkodër nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

9- Mbi zhvillimin e procedurës me objekt "Shërbime riparimi të akseve të rrugëve" viti 2022.

Nga auditimi i dosjes së prokurimeve në formatin elektronik dhe dokumenteve të sjella nga operatori fitues rezultoi:

Bazuar në urdhrin e titullarit nr. 53, datë 26.01.2022 referuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015 është llogaritur fondi limit prej **13,254,939** leke pa tvsh për procedurën: *Shërbime riparimi të akseve të rrugëve* i ndare në IV lote:

Loti i I-rë *"Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje ne segmentin "Ura Mesit-Prekal-Kir-Breglumi-Nderlyshaj-Thethe"* me fondin limit prej 3,317,856 leke pa tvsh.

Loti i II-të *"Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje të shtresave asfaltike dhe punime mbrojtëse të rritjes së sigurisë rrugore në Njësitë Administrative"* me fondin limit prej 5,983,513 leke pa tvsh.

Loti i III-të *"Shërbime riparim dhe mirëmbajtje me stabilizant të rrugëve të pa-asfaltuara Bashkia Shkodër"* me fondin limit 3,330,000 leke pa tvsh.

Loti i IV-te *"Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje në segmentin "Guri Mathes - Komuna Pog" dhe "Degezim Ndreaj - Komuna Shosh"* me fondin limit prej 623,570 leke pa tvsh.

Me urdhrin e prokurimit nr. 386, datë 10.05.2022 nxjerrë nga titullari i autoritetit kontraktor z. B.S. është përcaktuar fondi limit 13,254,939 lekë pa t.v.sh. për 4 lote, forma e procedurës e tenderit *"E hapur"* me mjete elektronike e argumentuar ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 387, datë 10.05.2022, Komisioni i vlerësimit të Ofertave, data **13.06.2022** hapja e tenderit, në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* kreu VII, neni 74 " pika 2. *"Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit/entit kontraktor krijon njësinë e prokurimit.."* dhe neni 75 pika 1 *"...1. Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit/entit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës, nëse nevojitet për objektin e prokurimit,....."*

Nga Njësia e Prokurimit E.D., A.S., D.K., në datë 10.05.2022 është mbajtur procesverbali për hartimin e dokumenteve përfundimtare të tenderit referuar urdhrin të prokurimit nr. 386, datë 10.05.2022 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kriteret e veçanta, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit dhe data e hapjes së ofertave datë **13.06.2022** në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* neni 78 pika 1. *"Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit, njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit, sipas llojit të procedurës e tipit të kontratës"* dhe 2. *"Hartimi i kërkesave për kualifikim, që*

lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit. Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit”.

Nga Njësia e Prokurimit janë hedhur në DST në formatin elektronik procesverbali i miratimit dhe argumentimit të specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta të pranimit me argumentet përkatëse sipas kërkesave të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 7, “Rregulla të përgjithshme për formën dhe mënyrën e shpalljes së njoftimeve” pika 3: “Hedhja e njoftimit të kontratës, dokumenteve të tenderit dhe procesverbalit të argumentimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit, në sistemin elektronik, bëhet nga vetë autoriteti/enti kontraktor”.

Nga auditimi rezulton se në DST për të 4 lotet është kërkuar:

Pika 2.2.Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe neni 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Referuar modelit të procesverbalit pune të saktësuar të rekomanduar nga APP me nr. 3872, datë 10.06.2021 hartimi i kësaj kërkesë ekonomike financiare duhet të formulohet si më poshtë:

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare _____, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve (shëno bazën ligjore), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Njësia e Prokurimit duhet të sqarojë se operatorët certifikojnë bilancet vetëm kur ata janë në kushtet që parashikon ligji nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” neni 41. “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:

c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

1. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

2. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

3. ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Me nr. 7378/11, dt. 12.07.2022 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga Kryetari z. B.S. me nr. 7378/11, dt. 12.07.2022 mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 84 1. “Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit/entit kontraktor.

Kanë paraqitur ofertat sipas lotëve operatorët si më poshtë:

Loti i I-rë: “Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje në segmentin “Ura Mesit-Prekal-Kir-Breglumi-Nderlysaj-Thethe” me fondin limit prej 3,317,856 leke pa tvsh.

1. Operatori ekonomik “N...” SHPK me vlerën e ofertës 2,616,200 lekë pa tvsh.
2. BOE “A... K...” me vlerën e ofertës 3,098,175 lekë pa tvsh.
3. BOE “Rr... G...” SHPK, me vlerën e ofertës 3,178,875 lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “N...” SHPK me vlerën e ofertës 2,616,200 lekë pa tvsh.
-Mungon vërtetimi i shlyerjes së detyrimeve të taksave vendore për Bashkinë Durrës sipas të dhënave të QKB.

Nga pjesëmarrësit janë kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE “A... K...” me vlerën e ofertës 3,098,175 lekë pa tvsh.
2. BOE “Rr... G...” SHPK, me vlerën e ofertës 3,178,875 lekë pa tvsh.

Është identifikuar si oferta e suksesshme BOE “A... K...” SHPK, “K... G...” SHPK me ofertën e paraqitur me vlerë totale prej **3,098,175** leke pa tvsh.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori i mësipërm “A... K...” SHPK për kërkesën ekonomike të mëposhtme:

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

OE “A... K...” SHPK ka paraqitur bilancet sipas viteve ku rezultojnë se raporti i aktivitetit me pasivitetin është si më poshtë:

Viti 2019 = 4,369,507 lekë,

Viti 2020 = - 347,371 lekë

Viti 2012 = 4,834,205 lekë.

Sa konstatuar më sipër rezultojnë se bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme,(2019-2020) kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, si rezultat operatori i mësipërm duhej të skualifikohej.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës (Lotit), që prokurohet dhe konkretisht **1,327,142** (Një milion e treqind e njëzet e shtate mijë e njëqind e dyzet e dy) leke. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me: a) faturat tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe kur në faturat tatimore nuk përfshihen të gjitha zërat e shërbimeve, ato duhet të

shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara; b) vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës

Mungon vërtetimi për shoqërinë “A... K...” SHPK, lëshuar nga Enti Publik, Bashkia Shkodër, për përmbushjen me sukses të kontratës “Riparim me stabilizant të rrugëve të pa shtruara” Bashkia Shkodër.

Midis BOE “A... K...” SHPK “K... G...” SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Shkodër është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 7378/13, datë 28.07.2022 për “Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje në segmentin “Ura Mesit-Prekal-Kir-Breglumi-Nderlytaj-Thethe” me vlerën 3.098,175 lekë pa TVSH. (3,717,810 lekë me TVSH) me afat punimesh deri 31.12.2022.

Loti i II-të: *“Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje të shtresave asfaltike dhe punime mbrojtëse të rritjes së sigurisë rrugore në Njësitë Administrative” me fondin limit prej 5,983,513 lekë pa tvsh.*

1. Operatori ekonomik “D... R...” SHPK me vlerën e ofertës 4,765,729 lekë pa tvsh.
- 2-Operatori ekonomik “A...” SHPK me vlerën e ofertës 5,088,669 leke pa tvsh.
- 3-Bashkimi i operatoreve ekonomik “Rr... G...” SHPK, me vlerën e ofertës 5,301,095 leke pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “D... R...” SHPK me vlerën e ofertës 4,765,729 lekë pa tvsh. për këto arsye: Nuk ka paraqitur shërbime të ngjashme pasi: *Mungon vërtetimi për shoqërinë D...R... sh.p.k, lëshuar nga Enti Publik, Drejtoria e Rajonit Verior, për përmbushjen me sukses të kontratës. Mungon dokumentacioni që vërteton se shoqëria D...R... sh.p.k plotëson kriteret për tu angazhuar si nenkontraktor, dokumentacion që lëshohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar si Autoriteti Kontraktor që ka organizuar procedure e prokurimit.*
- *Certifikata e transportit për mjetin me targa AA...OL i ka mbaruar afati i vlefshmërisë me date 18.03.2022. Polica e sigurimit për mjetin autobitumatrice me targa AA...YC I ka mbaruar afati i vlefshmërisë me datë 11.06.2022*

Nga pjesëmarrësit janë kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- 1-Operatori ekonomik “A...” SHPK me vlerën e ofertës 5,088,669 leke pa tvsh.
- 2-Bashkimi i operatoreve ekonomik “Rr... G...” SHPK, me vlerën e ofertës 5,301,095 lekë pa tvsh.

Është identifikuar si oferta e suksesshme operatori “A...” SHPK me vlerën e ofertës **5,088,669** leke pa tvsh.

Midis OE “A...” SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Shkodër është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 7378/14, datë 28.07.2022 për “Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje të shtresave asfaltike dhe punime mbrojtëse të rritjes së sigurisë rrugore në Njësitë Administrative” me vlerën 35,088,669 lekë pa TVSH. (6,106,403 lekë me TVSH) me afat punimesh deri 31.12.2022.

Loti i III-te *“Shërbime riparim dhe mirëmbajtje me stabilizant të rrugëve të pa-asfaltuara Bashkia Shkodër” me fondin limit prej 3,330,000 lekë pa tvsh.*

1. Operatori ekonomik “N...” SHPK me NIPT J.....U me vlerën e ofertës 2,975,000 lekë pa tvsh.
2. Operatori ekonomik “A... K...” SHPK me vlerën e ofertës 3,252,000 lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- 1.Operatori ekonomik “N...” SHPK me vlerën e ofertës 2,975,000 lekë pa TVSH për këto arsye: *Mungon vërtetimi i shlyerjes së detyrimeve të taksave vendore për Bashkinë Durrës Malësia e Madhe, Lezhë sipas të dhënave të QKB,*

Është identifikuar si oferta e suksesshme operatori “A... K...” SHPK me vlerën e ofertës **3,252,000** lekë pa tvsh.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori i mësipërm “A... K...” SHPK për kërkesën ekonomike të mëposhtme:

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatuueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

OE “A... K...” SHPK ka paraqitur bilancet sipas viteve ku rezultojnë se raporti i aktivitetit me pasivitetin është si më poshtë:

Viti 2019 = 4,369,507 lekë,

Viti 2020 = - 347,371 lekë

Viti 2012 = 4,834,205 lekë.

Sa konstatuar më sipër rezultojnë se bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme,(2019-2020) kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, si rezultat operatori i mësipërm duhej të skualifikohej.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës (Lotit), që prokurohet dhe konkretisht **1,332,000** (Një milion e treqind e tridhjetë e dymijë) lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me: a) faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe kur në faturat tatimore nuk përfshihen të gjitha zërat e shërbimeve, ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara; b) vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës

Mungon vërtetimi për shoqërinë “A... K...” SHPK, lëshuar nga Enti Publik, Bashkia Shkodër, për përmbushjen me sukses të kontratës “Riparim me stabilizant të rrugëve të pa shtruara” Bashkia Shkodër.

Midis OE “A... K...” SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Shkodër është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 7378/15, datë 28.07.2022 për “Shërbime riparim dhe mirëmbajtje me stabilizant të rrugëve të pa-asfaltuara Bashkia Shkodër” me vlerën 3,252,000 lekë pa TVSH. (3,902,400 lekë me TVSH) me afat punimesh deri 31.12.2022.

Loti i IV-të “Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje në segmentin “Guri Mathes - Komuna Pog” dhe “Degëzim Ndreaj - Komuna Shosh” me fondin limit prej 623,570 leke pa tvsh.

1.Operatori ekonomik “K. G.K.” SHPK me vlerën e ofertës 601,000 lekë pa tvsh.

Është identifikuar si oferta e suksesshme operatori “K. G. K.” SHPK me vlerën e ofertës **601,000** lekë pa tvsh.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës (Lotit), që prokurohet dhe konkretisht **249,428** (Dyqind e dyzet e nëntëmijë e katërqind e njëzet e tete) lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me: a) faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe kur në faturat tatimore nuk përfshihen të gjitha zërat e shërbimeve, ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara; b) vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.

Mungon vërtetimi për shoqërinë “K... G... K...” SHPK, lëshuar nga Enti Publik, Bashkia Shkodër, për përmbushjen me sukses të kontratës “Rikonstruksion Rruga e “Dalmaces” Bashkia Shkodër.

Midis OE “K... G... K...” SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Shkodër është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 7378/16, datë 28.07.2022 për “Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje ne segmentin "Guri Mathes - Komuna Pog" dhe "Degëzim Ndreaj - Komuna Shosh” me vlerën 601,000 lekë pa TVSH. (721,200 lekë me TVSH) me afat punimesh deri 31.12.2022.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/5, datë 08.03.2024 nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 973/6, datë 09.04.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

- Për sa u citua me lart rezulton se ne bilancet e viteve 201-2020-2021 te paraqitura nga shoqëria A... K... SHPK nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit te dy viteve të njëpasnjëshme, por ka raport negativ vetëm ne vitin 2020, gjë e cila nuk përmban shkak për skualifikimin e ofertuesit nga procedura e prokurimit.

- Ne lidhje me konstatimin se mungon vërtetimi për shoqërinë A... K... SHPK lëshuar nga Bashkia Shkodër për realizimin e kontratës me objekt: Riparim me stabilizant të rrugëve të pashtuara, Bashkia Shkodër, sqarojmë se në SPE ofertuesi në plotësim të kërkesës për shërbime të ngjashme ka ngarkuar dokumentet e mëposhtëm:

1-Kontrate shërbimi nr.5167/12 prot date 31.05.2021:”Riparim me stabilizant i rrugëve te paasfaltuara” me Bashkinë Shkodër

2-Procesverbal mbi përfundimin e punimeve nr.13293/2 prot date 03.08.2021

3-Procesverbal mbi marrjen ne dorëzim nr.13293 prot date 03.08.2021

4-Situacion përfundimtar nr.13293/1 prot date 03.08.2021

5-Procesverbal i marrjes ne dorëzim te shërbimit nr.8178 prot date 11.06.2020

Nga shqyrtimi ne tërësi i këtij dokumentacioni rezulton se kontrata me objekt: Riparim me stabilizant i rrugëve të paasfaltuara” me Bashkinë Shkodër është realizuar në afat dhe konform specifikimeve teknike dokumentuar me procesverbalin e marrjes në dorëzim të shërbimit nr.8178 prot datë 11.06.2020 i cili shërben edhe si dokument për të vërtetuar realizimin me sukses të kontratës.

Nga shqyrtimi ne tërësi i këtij dokumentacioni rezulton se kontrata me objekt: Rikonstruksion rruga e Dalmaces” me Bashkinë Shkodër është realizuar ne afat dhe konform specifikimeve teknike dokumentuar me aktkolaudimin dhe certifikatën e marrjes ne dorëzim te objektit te cilët shërbejnë edhe si dokument për te vërtetuar realizimin me sukses te kontratës.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/6, datë 09.04.2024 grupi i auditimit gjykon se:

- Sipas DST shtojca 8, pikës Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a)Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.

Ky dokument mungon dhe se nuk mund të zëvendësohet nga procesverbali i marrjes në dorëzim të shërbimit.

Gjykojmë se nga Bashkia Shkodër nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

10- Mbi zhvillimin e procedurës me objekt “Mirëmbajtje rrugë e trotuare në qytet”, viti 2022.

Nga auditimi i dosjes së prokurimeve në formatin elektronik dhe dokumenteve të sjella nga operatori fitues rezultoi:

Me urdhrin e prokurimit nr. 145, datë 07.03.2022 nxjerrë nga titullari i autoritetit kontraktor znj. V.A. është përcaktuar fondi limit 31,664,983 lekë pa t.v.sh. forma e procedurës e tenderit “E hapur” marrëveshje kuadër me mjete elektronike e argumentuar ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 146, datë 07.03.2022, Komisioni i vlerësimit të Ofertave, data **31.03.2022** hapja e tenderit, në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VII, neni 74 “ pika 2. “Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit/entit kontraktor krijon njësinë e prokurimit..” dhe neni 75 pika 1 “...1. Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit/entit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës, nëse nevojitet për objektin e prokurimit,.....”.

Nga Drejtoria e Shërbimeve publike dhe Ndjekjes së Investimeve në infrastrukturë me shkresën nr.295/b, datë 04.02.2022 drejtuar Nëpunësit Autorizues është kërkuar marrje angazhimi për kryerjen e shpenzimeve publike për “Mirëmbajtje rrugë e trotuare në qytet” sipas buxhetit të miratuar me fondin limit në vlerën 37,998,000 lekë me TVSH. Shoqëruar me preventivin e punimeve me çmime në vlerën 31,664,983 lekë pa TVSH dhe pa çmime për objektin të cilat janë përdorur referuar manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, të rishikuara, që do të përdoren në përcaktimin e fondit limit të objekteve në ndërtim, sipas tabelave që i bashkëlidhen VKM nr. 629, dt. 15.07.2015 i ndryshuar.

Një pjesë zërash të punimeve çmimet janë hartuar me analiza punimesh bashkëngjitur preventivit në përputhje me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

Nga Njësia e Prokurimit E.D., B.J., D.K., në datë 07.03.2022 është mbajtur procesverbali për hartimin e dokumenteve përfundimtare të tenderit referuar urdhrin të prokurimit nr. 145, datë 07.03.2022 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kriteret e veçanta, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit dhe data e hapjes së ofertave datë **08.04.2022** në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 78 pika 1. “Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit, njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit, sipas llojit të procedurës e tipit të kontratës” dhe 2. “Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit. Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit”.

Nga Njësia e Prokurimit bazuar rekomandimeve të asistencës së APP-së nr. 3873, datë 10.06.2021 janë hedhur në DST në formatin elektronik procesverbali i miratimit dhe

argumentimit të specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta të pranimit me argumentet përkatëse sipas kërkesave të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 7, “Rregulla të përgjithshme për formën dhe mënyrën e shpalljes së njoftimeve” pika 3: “Hedhja e njoftimit të kontratës, dokumenteve të tenderit dhe procesverbalit të argumentimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit, në sistemin elektronik, bëhet nga vetë autoriteti/enti kontraktor”

Nga auditimi rezulton se në DST është kërkuar:

Pika 2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2018, 2019 dhe 2020, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Referuar modelit të procesverbalit pune të saktësuar të rekomanduar nga APP me nr. 3872, datë 10.06.2021 hartimi i kësaj kërkesë ekonomike financiare duhet të formulohet si më poshtë:

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare _____, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve (shëno bazën ligjore), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Njësia e Prokurimit duhet të sqarojë se operatorët certifikojnë bilancet vetëm kur ata janë në kushtet që parashikon ligji nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” neni 41. “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:

c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

1. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

2. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

3. ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Me nr. 3722/10, dt. 04.05.2022 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga Kryetari z. B.S. me nr. 3722/11, dt. 04.05.2022 mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 84 l. “Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afatëve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit/entit kontraktor.

Kanë paraqitur ofertat 5 operatorë:

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1.Operatori ekonomik “ S... U...” SHPK, vlera e ofruar 23,219,375 lekë pa tvsh.

2.Operatori ekonomik “A... K...” SHPK, vlera e ofruar 25,096,365 lekë.

3.Operatori ekonomik “ K... K...” SHPK, vlera e ofruar 26,936,910 lekë pa tvsh

4.Operatori ekonomik “M...” SHPK, vlera e ofruar 26,932,950 lekë pa tvsh

5.Operatori ekonomik “K... G... K...” SHPK, vlera e ofruar 28,310,625 lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1.Operatori ekonomik “M...” SHPK, për këto arsye:

-Gabime aritmetike në masën + 4.76% në vlerën e ofertës dhe për këtë arsye oferta refuzohet. Ky konstatim bazohet ne VKM Nr. 285, datë 19.5.2021”Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 82,pika 3,shkronja c, ku thuhet se ofertat me gabime aritmetikore

refuzohen kur shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar

Nga auditimi i ofertave të ofertuesve të kualifikuara si të vlefshme, rezulton si më poshtë:

1. "S... U..." SHPK, me vlerë të ofertës **23,219,375** lekë pa TVSH si oferta me vlerën më të ulët.

Në DST është kërkuar:

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2021 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2021. *Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.*

Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

- *Subjekti nuk ka paraqitur vërtetimet nga Bashkia Durrës, Krujë dhe Vau Dejës se ka likuiduar detyrimet vendore për vitin 2021 kur në extratin historik të subjektit rezulton se në datën 21.09.2021 "Kanë ndodhur ndryshimet e mëposhtme në Adresat e Aktivitetit: **është Shtuar Adresa: "Durrës "Rikonstruksioni i Rrugës Tepelenë, Krujë, Rikonstruksioni i Rrugës së Ukëve, Tapizë, Nikël; Vau Dejës," Hidrocentrali i Vaut të Dejës";***

Sa konstatuar më lart operatori ekonomik "S... U..." SHPK nuk ka plotësuar detyrimin për të paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, duke mos paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore që vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime.

Në kundërshtim me kërkesat e nenit 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenit 43, neni 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, të ligjit nr.131/2015 "Për QKB" i ndryshuar, si dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 "Për QKR" i ndryshuar.

Midis operatorit "S... U..." SHPK dhe autoritetit kontraktor Bashkia Shkodër është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 3722/13, datë 16.05.2022 për "Mirëmbajtje rrugë e trotuare në qytet" me vlerën 7,739,792 lekë pa TVSH. (9,287,750lekë me TVSH) me afat punimesh deri 31.12.2022.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/5, datë 08.03.2024 nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 973/6, datë 09.04.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

- Sa konstatohet se Shoqëria S... U... SHPK e cila është shpallur fituese në këtë procedure prokurimi referuar të dhënave në ekstraktin historik nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore nga Bashkia Durrës, Bashkia Krujë dhe Bashkia Vau i Dejës sqarojmë se:

Në lidhje me këtë problematike të konstatuar nga ana juaj sqarojmë se operatori ekonomik S... U... SHPK ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore nga Bashkia Shkodër ku ka selinë kryesore dhe Bashkia Tirane ku ka adresën dytësore të deklaruar tek seksioni Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit

Ndërsa persa i përket hapjes së adresave dytësore me date 21.09.2021 nga shoqëria S... U... SHPK, KVO ka konstatuar se kjo shoqëri së pari e ka respektuar detyrimin ligjor për të hapur adresë dytësore në vendet ku kryen punime ndërtimi dhe së dyti punimet në këto objekte nuk kanë përfunduar deri më datë 08.04.2022 data e hapjes së ofertave të procedurës së prokurimit objekt auditimi dhe janë ende në proces, dhe duke e konsideruar pagesën e detyrimeve vendore brenda afatit ligjor të parashikuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/6, datë 09.04.2024 grupi i auditimit gjykon se:

- Sa janë konstatuar rezultatet se operatori ekonomik "S... U..." SHPK, nuk ka plotësuar detyrimin për të paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, duke mos paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore që vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime. Argumenti se "punimet në këtë objekt nuk kanë përfunduar" nuk kanë të bëjnë me vërtetimin e Bashkisë pasi me çeljen e adresës dytësore lind detyrimi për taksat dhe tarifatat dhe se bashkia në të gjitha rastet lëshon vërtetimin nëse kanë detyrime ose jo dhe në dokumentet e sjella nga operatori ky vërtetim mungon kur në ekstraktin historik kjo adresë dytësore figuron..

Gjykojmë se nga Bashkia Shkodër nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

11- Mbi zhvillimin e procedurës me objekt "Blerje dru zjarri", viti 2022.

Nga auditimi i dosjes së prokurimeve në formatin elektronik dhe dokumenteve të sjella nga operatori fitues rezultoi:

Bazuar në urdhrin e titullarit nr. 01, datë 05.01.2022 'për ngritjen e grupit të ounës për përgatitjen e specifikimeve teknike, testimin të tregut, llogaritjes së fondit limit, hartimit të preventivave marrjes në dorëzim të mallrave shërbimeve, ndjekjes së zbatimit të kontratave për procedurat e prokurimit publik" nga grupi i punës bazuar në çmimin mesatar bazuar në testimin e tregut. është llogaritur fondi limit prej **14,586,104** leke pa tvsh për procedurën: "Blerje dru zjarri"

Me urdhrin e prokurimit nr. 651, datë 21.07.2022 nxjerrë nga titullari i autoritetit kontraktor z. B.S. është përcaktuar fondi limit 14,583,104 lekë pa t.v.sh. forma e procedurës e tenderit "E hapur" me mjete elektronike e argumentuar ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 652, datë 21.07.2022, Komisioni i vlerësimit të Ofertave, data **10.08.2022** hapja e tenderit, në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" kreu VII, neni 74 " pika 2. "Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit/entit kontraktor krijon njësinë e prokurimit.." dhe neni 75 pika 1 "...1. Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhr të veçantë të titullarit të autoritetit/entit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës, nëse nevojitet për objektin e prokurimit,.....".

Nga Njësia e Prokurimit E.D., B.F., D.K., në datë 22.07.2022 është mbajtur procesverbali për hartimin e dokumenteve përfundimtare të tenderit referuar urdhrin të prokurimit nr. 651 datë 21.07.2022 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kriteret e veçanta, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit dhe data e hapjes së ofertave datë **10.08.2022** në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 78 pika 1. "Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit, njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit, sipas llojit të procedurës e tipit të kontratës" dhe 2. "Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit. Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit".

Nga Njësia e Prokurimit janë hedhur në DST në formatin elektronik procesverbali i miratimit dhe argumentimit të specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta të pranimit me

argumentet përkatëse sipas kërkesave të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 7, “Rregulla të përgjithshme për formën dhe mënyrën e shpalljes së njoftimeve” pika 3: “Hedhja e njoftimit të kontratës, dokumenteve të tenderit dhe procesverbalit të argumentimit të specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta të pranimit, në sistemin elektronik, bëhet nga vetë autoriteti/enti kontraktor”

Nga auditimi rezultoi se në DST është kërkuar:

Për pikën 2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2019, 2020 dhe 2021 ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe neni 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Referuar modelit të procesverbalit pune të saktësuar të rekomanduar nga APP me nr. 3872, datë 10.06.2021 hartimi i kësaj kërkesë ekonomike financiare duhet të formulohet si më poshtë:

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare _____, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve (shëno bazën ligjore), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Njësia e Prokurimit duhet të sqarojë se operatorët certifikojnë bilancet vetëm kur ata janë në kushtet që parashikon ligji nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” neni 41. “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:

c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

1. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

2. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

3. ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Me nr. 11755/8, dt. 11.08.2022 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga Kryetari z. B.S. me nr. 11755/9, dt. 11.08.2022 mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 84 l. “Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit/entit kontraktor.

Kanë paraqitur ofertat një operator i cili është shpallur edhe fitues si më poshtë::

1. Personi fizik M... Sh... me vlerën e ofertës 14,126,230 lekë pa TVSH.

Nga auditimi i procedurës rezultoi se:

Për pikën 2.3. Kapaciteti teknik është kërkuar:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate në një vlerë prej 5,833,241 (Pesë milion e tetëqind e tridhjetë e tremijë e dyqind e dyzet e një) lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti

Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.

Në formatin elektronik nga operatori është paraqitur kontrata e furnizimit nr. 235, datë 11.09.2020 me Bashkinë Shkodër me vlerën 11,299,600 lekë pa TVSH e cila nuk ndodhet në dosjen e dorëzuar nga operatori si dokument provues pjesë e ofertës në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Neni 26, pika 6. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Midis PF M... Sh... dhe autoritetit kontraktor Bashkia Shkodër është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 287/7, datë 24.08.2022 për “Blerje dru zjarri” me vlerën 14,126,230 lekë pa TVSH. (16,951,476 lekë me TVSH) me afat dorëzimi deri 31.12.2022.

2.5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Bashkia Shkodër ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor miratuar me Vendim nr.9, datë 28.12.2020, “Për rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor” Bashkia Shkodër, të miratuar me Vendim nr. 5, datë 16.10.2016 të Këshillit Kombëtar të Territorit.

Referuar sistemit elektronik të aplikimit në kuadër të lejeve ndërtimit, e-Leje dhe sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Shkodër, në vitin 2021, është miratuar dhënia e 34 lejeve dhe në vitin 2022 janë miratuar 35 leje.

Ecuria e procesit të lejeve 2021-2022.

Lloji i lejes	Total		Miratuar		Refuzuar		Në proces	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
Leje zhvillimi – Bashki	46	63	34	35	10	28	-	-
Leje ndërtimi për objekt të ri mbi 250m ²	12	23	7	15	5	8	-	-
Leje ndërtimi për objekt të ri deri 250m ²	17	33	8	12	9	21	-	-
Leje ndërtimi për shtesë në objekt ekzistues deri në 250 m ²	28	23	15	10	13	13	-	-
Leje ndërtimi për shtesë në objekt ekzistues mbi 250 m ²	4	2	2	2	2	-	-	-
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	294	237	158	120	136	117	-	-
Rikonstruksion pa ndryshim funksioni	40	46	22	15	18	31	-	-
Rikonstruksion me ndryshim funksioni	-	3	-	2	-	1	-	-
Çertifikatë përdorimi	44	38	26	25	18	13	-	1
Ndryshim projekti gjatë zbatimit	30	25	19	12	11	13	-	-
Ndryshim funksioni	16	12	5	3	11	9	-	-
Njoftim fillim punimesh	3	2	-	-	3	2	-	-
Leje infrastrukture	16	6	4	2	12	2	-	-
Leje ndërtimi për prishje të ndërtimit ekzistues	4	7	1	-	3	7	-	-
Leje për shtyrje afati të lejes së ndërtimit	13	5	12	-	1	5	-	-

Burimi: Të dhëna nga Bashkia Shkodër, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Në periudhën 2021-2022 evidentohet se leje ndërtimi për objekt të ri me sipërfaqe mbi 250 m² janë miratuar 7 në vitin 2021 dhe 15 leje në vitin 2022, ndërsa leje ndërtimi për objekt të ri me sipërfaqe deri në 250 m² janë miratuar 8 leje në vitin 2021 dhe 12 leje në vitin 2022.

Konstatohet se 1 (një) certifikatë përdorimi vijon të mbetet në proces gjatë vitit 2022. Procesi i aplikimit për pajisje me certifikatë përdorimi, të objektit “Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m²” për objektin: “Shtesë anësore 7.8 m² (shkallë) + shtesë kati me mbulesë solete (146.48 m²) me subjekt ndërtues shoqëria “N...” SHPK dhe pronar/zhvillues L.L. me nr. 6375 prot., ka kryer aplikimin fillestar për certifikatë përdorimi në datë 22.04.2022, miratimi i aplikimit për certifikatë përdorimi nga drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit është bërë në 25.10.2022 dhe pagesa nga zhvilluesi është kryer në 25.10.2022. Aplikimi për marrje të certifikatës së përdorimit vijon të mbetet në proces, për arsye se zhvilluesi nuk ka kryer pagesën për taksat të një tjetër objekti, në adresë “Shkodër, ndërtesa 03450020; Nd.7; H.1; PULT; PLAN 4010, Shkodër”, nuk i është lëshuar certifikata e përdorimit e objektit “Shtesë anësore 7.8 m² (shkallë) + shtesë kati me mbulesë solete (146.48 m²)” nga Drejtoria e të Ardhurave, me arsyetimin se është debitor në Bashkinë Shkodër për taksat e papaguar për një tjetër objekt në vlerën 18,454 lekë, ndërkohë që nga DPKZHT i është miratuar marrja e certifikatës së përdorimit për objektin që zhvilluesi ka aplikuar.

Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, janë konstatuar mangësi në dokumentacionin e lejeve të miratuara nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Shkodër, të evidentuara si në vazhdim.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e-leje dhe në databazën e vendosur në dispozicion nga drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit është konstatuar se lejet e ndërtimit të miratuara janë shqyrtuar me afate të tej zgjatuara ditësh pune duke mos respektuar afatin maksimal prej 60 ditësh pune për miratimin e lejes së ndërtimit si më poshtë vijon: 19245 “A... SHPK”, 5721 “M.L.”, 6549 “M.B.”, 5722 “A.M.”, 17578 “D.P., R.P., L.P.”, 18009 “S.Y”, 18282 “J.L., K.L.”, 1268 “R.K.”, 2392 “L.B.”, 1181 “P.D. dhe Z.D.”, 199 “B.M.”, 1543 “F.K.”, 2391 “A.V., B.Q., A.T.”, 2787 “V.D.”, 40 “S.H., S.H.”, 3924 “D.K., E.G.”, 2853 “E.Gj.”, 3089 “Z.H.”, 2786 “V.D.”, 5109 “R.O., M.O.”, 3923 “F.H., K.H.”, 9421 “D.Xh.”, 8648 “A.B.”, 10594 “Xh.K.”, 13442 “N.D.”.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 44, pika 2 të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar: “Autoriteti përgjegjës vendos për lejen e ndërtimit brenda 60 ditëve nga dorëzimi i aplikimit për leje ndërtimi. Rregullorja e zhvillimit mund të përcaktojë afate më të shkurtra apo procedura të diferencuara për pajisjen me leje ndërtimi, për punime me impakt të ulët në territor apo për investime strategjike për vendin”.

Gjithashtu, rezulton se Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Shkodër nuk është plotësuar me stafin e nevojshëm, gjë që ka ndikuar në funksionimin normal të kësaj Drejtorie.

Nga sa më sipër, DPKZHT në Bashkinë Shkodër nuk është mbështetur në afatet e përcaktuara në kuadrin ligjor për shqyrtimin e kërkesave të subjekteve aplikuese për leje ndërtimi, duke shfaqur neglizhencë nga ana e tyre në zbatimin e detyrave funksionale.

Për të shqyrtuar dhe analizuar tipologji të ndryshme të lejeve të miratuara për vitin 2021 dhe 2022, janë përzgjedhur për të audituar në mënyrë të rastësishme objektet e mëposhtme:

Lejet e miratuara 2021-2022 të shqyrtuara gjatë auditimit.

Nr.	Nr. Prot	Objekti	Zhvilluesi	Data e miratimit të lejes	Preventivi
1	14106	Banim dhe shërbime 7 kate	P... A... SHPK	12.10.2021	153,842,745
2	10552	Ndertese banimi 7 kate + bodrum	M... K... SHPK	13.09.2021	97,592,090
3	24053/5	Objekt banimi & shërbime 7 kate + bodrum	“G...” SHPK.	25.03.2022	121,036,536
4	9955/5	Objekt banimi & shërbime 7 kate+bodrum	A... S... SHPK	18.10.2022	233,552,769

5	21226/5	Ndërtim i ri, pallat (1 kat parking, 1 kat shërbime dhe 6 kate banim)	H... E...	1.3.2022	182,338,221
6	2486	Godinë banimi dhe shërbime 7 kate + bodrum	A... Z... SHPK dhe "A... S..." SHPK	03.03.2022	113,333,024
7	18415/4	Ndërtesë 7 kate + bodrum, (1 kat shërbime + 6 kate banim)	F... SHPK.	20.01.2022	53,534,736
8	15919/5	Objekt banimi & shërbimi 7 kate + bodrum	S... SHPK	11.01.2022	86,063,897
9	1183/4	Objekt banimi dhe shërbimi 1, 6, 7	A... E..." SHPK (ndryshuar emri ne A... I... SHPK)	25.03.2022	379,988,142
10	13368/4	Banesë 2 kat	T.Sh.	08.10.2021	5,820,000

Burimi: Të dhëna nga Bashkia Shkodër, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Miratimi i lejeve të ndërtimit mbi lartësinë e përcaktuar në Planin e Detajuar Vendor.

Dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga DPKZHT dhe të dhënat në sistemin *e-Leje*, si projekti arkitektonik, relacioni teknik i projektit të propozuar, plani i vendosjes së strukturave i miratuar nuk është në përputhje me lartësinë e përcaktuar në Planin e Detajuar Vendor të Bashkisë Shkodër, sipas nënjësisë strukturore, pasqyrohen në tabelën përmbledhëse si më poshtë vijon.

Lejet e miratuara me lartësi mbi ato të përcaktuara në Planin Vendor.

Zhvilluesi	Nën njësia strukturore	Lartësia max. sipas nënjësisë strukturore	Lartësia max. në dokumentacionin e subjektit	Lartësia max. në Leje Ndërtimi të miratuar
P... A... SHPK	SH010.UB-13	23 m	23.6 m	23 m
M... K... SHPK	SH015.UB-1	23 m	23.6 m	23 m
G... SHPK.	SH015.UB-2	23 m	23.5 m	23.5 m
A... S... SHPK	SH010.UB	23 m	23.5 m	23.5 m
F... SHPK.	SH005.UB-R1	23.6 m	23.6 m	23.625

Burimi: Të dhëna nga Bashkia Shkodër, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

- Leje nr. 14106/4 prot., datë 12.10.2021, zhvilluesi P... A... SHPK, "Banim dhe shërbim 7 kate", në nën njësinë SH010.UB-13 sipas Planit të Detajuar Vendor (PDV) lartësia maksimale është 23 m, në papajtueshmëri në dokumentacionin e përcjellë nga subjekti në planin e vendosjes, relacionin teknik të projektit, në projektin arkitektonik është 23.6 m dhe leje e ndërtimit 14106/4 është e miratuar për 23 m.
- Leje nr. 10552/6 prot., datë 13.09.2021, zhvilluesi M... K... SHPK, "Ndërtesë banimi 7 kate + bodrum", në nën njësisë strukturore SH015.UB-1, lartësia maksimale sipas PDV është 23m ndërkohë në dokumentacionin e sjellë nga subjekti është 23.6 m dhe leje e ndërtimi është miratuar për 23m, vihet re mospërputhje e lartësisë së dhënë në papajtueshmëri në dokumentacionin e shqyrtuar.
- Leje nr. 24053/5 prot., datë 25.03.2022, zhvilluesi G... SHPK, "Objekt banimi & shërbime 7 kate + bodrum", nën njësia strukturore SH015.UB-2, lartësia e maksimale 23m nuk është respektuar në lejen e ndërtimit të miratuar.
- Leje nr. nr. 9955/5 prot., datë 18.10.2022, zhvilluesi, A... S... SHPK, "Objekt banimi & shërbime 7 kate+bodrum", leja është miratuar në papajtueshmëri me lartësinë maksimale të nën njësisë strukturore referuar Planit të Detajuar Vendor, ku 23m është lartësia e specifikuar ndërkohë leje e miratuar është 23.5m.
- Leje ndërtimi, nr. 18415/4 prot., datë 20.01.2022, zhvilluesi F... SHPK, "Ndërtesë 7 kate + bodrum, (1 kat shërbime + 6 kate banim)", nën njësia strukturore SH005.UB-R1, leja e miratuar është më e lartë se lartësia maksimale e lejuar sipas PDV.

Nga sa më sipër, konstatohet se mosrespektim i përcaktimeve të vendosura në PDV sipas njësisë strukturore, ka ndikuar në shkeljen ligjore të mbrojtjes së territorit, për shkak të neglizhencës së strukturave të bashkisë në zbatimin e detyrave funksionale në respektim të ligjit përkatës.

Nuk është aplikuar nënshkrimi i kontratës mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale.

Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, në zbatim të Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, neni 19, pika 1, ka vijuar praktikën e pranimit të deklaratës noteriale nga subjektet që kanë aplikuar për leje ndërtimi me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 m² për të siguruar kalimin pa shpërblim të paktën 3% të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm në favor të banesave sociale, duke zëvendësuar kështu kontratën që duhet të ishte nënshkruar midis palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të ndërtesave sociale. Në deklaratën noteriale, të paraqitur nga subjekti, “P... A...” SHPK dhe “G...” SHPK, rezulton se nënshkrimi i deklaratave noteriale është kryer pas marrjes së miratimit të lejes.

Në tabelën më poshtë janë të pasqyruara objektet e miratuara për periudhën 2021 -2022, me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 m², që kanë dorëzuar deklarata noteriale:.

Lejet ndërtimore me sipërfaqe mbi 2 000 m²

Nr	Nr. Prot	Dt. e Miratimit të Lejes	Zhvilluesi	Objekt	Sip. Totale Ndërtimi m ²	Dt. e Deklaratës Noteriale
1	14106/4	12.10.2021	P... A... SHPK	Banim dhe shërbime 7 kate	4 713	09.11.2021
2	1183/4	25.03.2022	A... E... SHPK (ndryshuar emri ne A... I... SHPK. me NIPT. M.....I)	Objekt banimi dhe shërbimi 1, 6, 7 kat me podrum	11 480.13	09.02.2022
3	2486	03.03.2022	A... Z... SHPK. dhe A... S... SHPK	Godinë banimi dhe shërbime 7 kate + bodrum	3 446.2	23.02.2022
4	24053/5	25.03.2022	G... SHPK.	Objekt banimi & shërbime 7 kate + bodrum	3 708	22.02.2023
5	9955/5	18.10.2022	A... S... SHPK	OBJEKT BANIMI & SHERBIME 7 KATE+BODRUM	6 966.3	03.10.2022
6	21226/5	1.3.2022	H... E...	Ndërtim i ri, pallat (1 kat parking, 1 kat shërbime dhe 6 kate banim)	5 586	15.02.2022

Burimi: Të dhëna nga Bashkia Shkodër, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Veprimet e mësipërme nuk janë sipas kërkesave të Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, i ndryshuar, neni 19, pika 1, e cila përcakton: “Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t’u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.

Miratimi i lejeve të ndërtimi në kundërshtim me kuadrin ligjor të sipërcituar, për të siguruar kalimin pa shpërblim të paktën 3 përqind të sipërfaqes funksionale në favor të fondit publik të banesave sociale, ka ndikuar në mungesën e zbutjes së problemit social të strehimit në bashkinë Shkodër. Kjo tregon se strukturat përkatëse të bashkisë kanë nënvlerësuar çështjet sociale të strehimit të banorëve të saj, nëpërmjet mungesës së zbatimit rigoroz të kuadrit ligjor në fushën e strehimit social.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/5, datë 08.03.2024 nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 973/6, datë 09.04.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Sa i takon ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", neni 19, pika 1, "Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të paktën 3 përqind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t'u dhënë në sipërfaqe ndërtimor të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Paluajtshme".

Në interpretim të dispozitës ligjore të sipërcituar, Bashkia Shkodër gjatë procedurës së shqyrtimit të lejeve të ndërtimit ka siguruar kalimin pa shpërblim të të paktën 3 përqind të sipërfaqes funksionale, ndërmjet deklaratave të depozituara nga subjekti zhvillues.

Në momentin e përfundimit të punimeve, përpara miratimit të certifikatës së përdorimit do nënshkruhet mes palëve kontrata për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, kontratë e cila do regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Theksojmë se, të gjithë këto objekte aktualisht janë në proces ndërtimi.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 973/6, datë 09.04.2024 grupi i auditimit gjykon se:

Në lidhje me observacionin e bërë nga subjekti i audituar Bashkia Shkodër, shprehemi se kontrata për kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, duhet të nënshkruhet kur subjekti aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi, siç është kërkuar edhe në listën e dokumentacionit të kërkuar nga Bashkia Shkodër drejtuar subjektit aplikues për t'u pajisur me leje ndërtimit.

Gjykojmë se nga Bashkia Shkodër nuk janë sjellë argumente të genësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

Mungon vërtetimi risku nga organi kompetent që lëshon lejen për objektet e miratuara me leje ndërtimi, mungon mendimi i të gjithë autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve, mangësi në dokumentacionin shoqëruar të projektit ndërtimor.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar për lejet e miratuara, ka rezultuar se asnjë objekt që është pajisur me leje nga Bashkia Shkodër nuk është pajisur me një vërtetim për riskun nga organi kompetent që lëshon lejen, bazuar në VKM nr. 1162, datë 24.12.2020, "Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi".

Në sistemin e-Leje dhe nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga DPKZHT, rezulton se mungon studimi me të dhëna inxhiniero-sizmologjike dhe gjeologjike në dosjet e mëposhtme:

- Zhvilluesi, M... K... SHPK, nr. 10552/6 prot., datë 13.09.2021, nuk u gjet relacion i studimit me të dhëna inxhiniero-sizmologjike dhe gjeologjike për projektin, "Ndërtesë banimi 7 kate + bodrum";
- Zhvilluesi, P... A... SHPK, nr. 14106/4 prot., datë 12.10.2021, "Banim dhe shërbime 7 kate",
- Zhvilluesi, G... SHPK., nr. 24053/5 prot., datë 25.03.2022, nuk u gjet relacion i studimit me të dhëna inxhiniero-sizmologjike dhe gjeologjike për projektin, "Objekt banimi & shërbime 7 kate + bodrum";
- Zhvilluesi, A... S... SHPK, nr. 9955/5 prot., datë 18.10.2022, "Objekt banimi & shërbime 7 kate+bodrum",
- Zhvilluesi, F... SHPK, nr. 18415/4 prot., datë 20.01.2022, për objektin "Ndërtesë 7 kate + bodrum, (1 kat shërbime + 6 kate banim);
- Zhvilluesi, S... SHPK, nr. 15919/5 prot., datë 11.01.2022, "Objekt banimi & shërbimi 7 kate + bodrum";
- Zhvilluesi, H... E..., nr. 21226/5 prot., datë 1.3.2022, "Ndërtim i ri, pallat (1 kat parking, 1 kat shërbime dhe 6 kate banim);
- Zhvilluesi, "A... E..." SHPK (ndryshuar emri ne A... I... SHPK me NIPT M.....I), nr. 1183/4 prot., datë 25.03.2022, "Objekt banimi dhe shërbimi 1, 6, 7"
- Zhvilluesi, T.Sh., nr.13368/4 prot., objekt, "Banesë 2 kat".

Mangësitë e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 1162, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi”, pika 10: “Vlerësimi i organit kompetent për lëshimin e vërtetimit të riskut do të bazohet në dokumentacionin e nevojshëm të paraqitur nga pala kërkuese, siç është parashikuar në shtojcën 1, të këtij vendimi, ekspertizën e organeve të tjera, në rast se është kërkuar, si dhe në studimet për zonën ku do të zhvillohet projekti, për secilën fushë të sipërpërmendur”.

Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore në lidhje me detyrimin e subjekteve ndërtimore për të paraqitur dokumentacionin për t’u pajisur me vërtetim risku nga organi kompetent ndikon në garantimin e qëndrueshmërisë dhe bazamentit ku do të mbështetet ndërtimi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës së ndjekur për miratimin e lejeve është konstatuar se nuk është kërkuar mendimi i të gjithë autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve për t’u siguruar se projekti, për të cilin kërkohet pajisja me leje nuk ndërhyt apo pengon zhvillimin. Nuk është kërkuar mendim për të marrë siguri të plotë mbi respektimin e distancave nga linjat e tensionit të lartë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), për subjektet si më poshtë vijon:

- Zhvilluesi, P... A... SHPK, nr. 14106/4 prot., datë 12.10.2021, “Banim dhe shërbime 7 kate”, nuk është kërkuar mendim i Operatori i Sistemit të Transmetimit, në vazhdim (OST);
- Zhvilluesi, M... K... SHPK, nr. 10552/6 prot., datë 13.09.2021, “Ndërtesë banimi 7 kate + bodrum”, nuk është kërkuar mendim i OST;
- Zhvilluesi, A... S... SHPK, nr. 9955/5 prot., datë 18.10.2022, “Objekt banimi & shërbime 7 kate+bodrum”, nuk është kërkuar mendimi Drejtorisë Vendore ASHK Shkodër dhe mendim i OST;
- Zhvilluesi, G... SHPK., nr. 24053/5 prot., datë 25.03.2022, “Objekt banimi & shërbime 7 kate + bodrum”, nuk është kërkuar mendim, OST;
- Zhvilluesi, H... E..., nr. 21226/5 prot., datë 1.3.2022, “Ndërtim i ri, pallat (1 kat parking, 1 kat shërbime dhe 6 kate banim), Drejtoria Vendore ASHK Shkodër dhe nuk është kërkuar mendim i OST;
- Zhvilluesi, S... SHPK, nr. 15919/5 prot., datë 11.01.2022, “Objekt banimi & shërbimi 7 kate + bodrum”, nuk është kërkuar mendim i OST;
- Zhvilluesi, “A... E...” SHPK (ndryshuar emri ne A... I... SHPK me NIPT M.....I), nr. 1183/4 prot., datë 25.03.2022 nuk është kërkuar mendim i OST.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 10/1 të Rregullores - Dokumentacioni për pajisjen me leje zhvillimi: “Dokumentet e vetme që duhet të paraqesë pronari ose zhvilluesi për t’u pajisur me leje zhvillimi janë:

- a) kërkesa për leje, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në këtë rregullore dhe në sistemin elektronik të lejeve;
- b) prokura ose autorizimi, në emër të personit fizik apo juridik, në rast se kërkesa paraqitet nga një përfaqësues i pronarit ose zhvilluesit;
- c) dokument që vërteton të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim dhe, nëse ka, kopje të marrëveshjeve për pronën;
- ç) planin e rlevimit të pronës, në shkallë 1:500, nga topograf i licencuar;
- d) projekt idenë arkitektonike të zhvillimit;
- dh) kopje të licencës së topografit dhe projektuesit, sipas shkronjave “ç” dh “d”;
- e) mandatpagesën e tarifës së aplikimit, nëse parashikohet.”

Mos marrja e mendimit nga të gjithë autoritetet të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit që është në papajtueshmëri me kriteret ligjore, ndikon në krijimin e kushteve për një zhvillim të pakontrolluar duke cenuar sigurinë territoriale, për neglizhencë të strukturave përkatëse në Bashkinë Shkodër në zbatimin e detyrave të tyre funksionale.

Mangësitë e mësipërme vijnë për shkak të neglizhencës së punonjësve të DPKZHT në Bashkinë Shkodër.

Projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqëruar

- Zhvilluesi, P... A... SHPK, nr. 14106/4 prot., datë 12.10.2021, “*Banim dhe shërbime 7 kate*”, nuk u gjet vërtetimi i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ekstrakt historik zhvilluesit të projektit dhe ka parregullsi në dokumentin e “*Deklarata e përgjegjësisë profesionale*” për arkitektin, Dh. J., pasi në përmbajtje të saj është “*Ekspert privat zjarrfikës*” dhe në nënshkrimin e dokumentit është emër i K.J., si dhe mungojnë kontrata e bashkëpunimit midis E... SHPK dhe P... A... SHPK;
- Zhvilluesi, M... K... SHPK, nr. 10552/6 prot., datë 13.09.2021, “*Ndërtesë banimi 7 kate + bodrum*”, nuk u gjet vërtetimet e regjistrimit në QKB, raport i auditimit të energjisë, nuk gjendet dokumentacion justifikues midis profesionistëve siç është kontrata e punës;
- Zhvilluesi, G... SHPK., nr. 24053/5 prot., datë 25.03.2022, “*Objekt banimi & shërbime 7 kate + bodrum*”, dokumenti i policë për sigurimin e përgjegjësisë profesionale për inxhinierin e ndërtimit- drejtimi strukturist dhe për inxhinierin e ndërtimit – profili infrastrukturë e transportit, është jashtë afatit të periudhës së sigurimit, 26.02.2021 – 26.02.2022, ndërkohë leje e miratuar është në 25.03.2022, në dokumentin e prokurës së posaçme për autorizimin e aplikuesit nuk janë plotësuar të gjitha informacionet, nuk u gjet një kontratë midis E... SHPK dhe G... SHPK për hartimin e projektit hidroteknik, relacionit Teknik për instalime hidrosanitare, si dhe policë për sigurimin e përgjegjësisë profesionale për arkitekt ka përfunduar përpara miratimit të lejes. Plani i rievimit i listuar në dokumentacionin plotësues në shkresën 17026/2 prot., si dhe licenca e topografit të certifikuar nuk u gjet në dosjen e zhvilluesit, si dhe raporti teknik i vlerësimit të ndikimit në mjedis.
- Zhvilluesi, S... SHPK, nr. 15919/5 prot., datë 15919/5, “*Objekt banimi & shërbimi 7 kate + bodrum*”, nuk u gjet raporti teknik i vlerësimit të ndikimit në mjedis
- Zhvilluesi, H... E..., nr. 21226/5 prot., datë 1.3.2022, “*Ndërtim i ri, pallat (1 kat parking, 1 kat shërbime dhe 6 kate banim)*”, ekstrakt i QKB për zhvilluesin e projektit, policë për sigurimin e përgjegjësisë profesionale e inxhinierit të ndërtimit – profiki infrastrukturë e transportit është jashtë periudhës së sigurimit në datën e marrjes së lejes, formulari për arkitektët dhe inxhinierë civilë i sigurimit të përgjegjësisë profesionale ka përfunduar përpara marrjes së lejes, në 25 janar 2022, miratimi i lejes është në datë 01.03.2022, dokumenti i pronësisë nuk gjendet i azhurnuar brenda 3 muajve të fundit nga data e aplikimit
- Zhvilluesi, A... S... SHPK, nr. 9955/5 prot., datë 18.10.2022, “*Objekt banimi & shërbime 7 kate+bodrum*”, plani i rievimit nga topograf i licencuar, i listuar në shkresën nr. 4451/2 prot., datë 13.06.2022 nuk u gjet në dosje si dhe mungon ekstrakti i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit zhvillues të projektit.
- Zhvilluesi, A... Z... SHPK. dhe “A... S...” SHPK, nr. 2486 prot., datë 03.03.2022, objekt “*Godinë banimi dhe shërbime 7 kate + bodrum*”, periudha e mbulimit të policës për sigurimin e përgjegjësisë profesionale ka përfunduar përpara marrjes së lejes për inxhinier ndërtimi-profilin infrastrukturë e transportit, në datë 26.02.2022 ndërkohë leje është miratuar në 03.03.2022, si dhe nuk u gjet në dosje ekstrakti i QKB për të dhënat e subjektit zhvillues të projektit.
- Zhvilluesi, H... E..., nr. 21226/5 prot., datë 1.3.2022, “*Ndërtim i ri, pallat (1 kat parking, 1 kat shërbime dhe 6 kate banim)*”, nuk u gjet dokumenti i pronësisë”.
- Zhvilluesi, T.Sh., nr. 13368/4 prot., ka dorëzuar elektronikisht aplikimin në datë 03.08.2021 dhe është miratuar leja në datë 08.10.2021, “*Banesë 2 kat*”, e nënshkruar elektronikisht nga Drejtoria Vendore Shkodër, 11.03.2021, bazuar në kërkesën e bërë nga Bashkia Shkodër referuar bazës ligjore për pajisjen me leje ndërtimi duhet dokumenti i pronësisë nuk gjendet i azhurnuar brenda 3 muajve të fundit nga data e aplikimit për zhvilluesit.

Mangësitë e mësipërme të dokumentacionit shoqërues të projektit ndërtimor janë në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar si dhe të Ligjit nr. 10440, datë 07.07.2021, “*Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*”.

Mangësitë në dokumentacionin shoqëruar ndikojnë në garantimin e cilësisë së ndërtimit sipas standardeve të sigurisë. Konstatohet se shkak për një mangësi të tillë është mungesa e vlerësimit të kompletit të dokumenteve nga ana e nëpunësve të DPKZHT në Bashkinë Shkodër. Nuk janë respektuar afatet e shqyrtimit të kërkesave për pajisjen me certifikatë përdorimi, si dhe ka mangësi në dokumentacionin përkatës të aplikuesit për këtë certifikatë.

Në vitin 2021 janë pajisur me certifikatë përdorimi 26 subjekte dhe në vitin 2022 janë miratuar 25 subjekte me certifikatë përdorimi.

Në sistemin e-leje dhe në databazën e vendosur në dispozicion nga drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit është konstatuar se 78,4 % e certifikatave të përdorimit të miratuara janë shqyrtuar me afate të tej zgjatuara ditësh pune duke mos respektuar afatin maksimal prej 30 ditësh pune për miratimin e lejes së ndërtimit si mëposhtëm vijon:

24230 "S...", 23789 "A.U.", 23648 "A.L.", 23647 "L.D.", 20391 "B.S.", 20240 "V... H... K... L...", 7035 "B.A.", 2788 "A... S...", 1901 "A.K.", 24599 "A.K.", 24597 "C... C...", 24596 "C... C...", 24332 "M.R.", 11182 "A...", 11091 "F.H.", 10733 "Z.V.", 10146 "H.L.L.", 3670 "Sh... T...", 9772 "M.Sh.", 13585 "S...", 18843 "V... M... 2008", 17023 "A.L.I.", 12002 "V... M... 2008", 3194 "A.H.", 1399 "F... M...", 33 "S.M.", 19833 "A.M.", 11061 "A.G.", 10269 "I.M.", 6326 "N.N.Z.K Sh.", 6324 "D.H.", 5720 "M...", 5426 "A.M. ", 5337 "M...", 5201 "A.C.", 5198 "V.B.", 4949 "M.Sh.", 18607 "N.L.", 16141 "Gj.Sh.", 15763 "L.P."

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e VKM Nr. 408 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, neni 27, pika 7: "Brenda 10 ditëve pune, nga paraqitja e raportit të vlerësimit dhe, në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë pune, nga data e dorëzimit të procesverbalit të kolaudimit, sipas rastit, kryetari i bashkisë apo sekretariati i KKT-së vendos:

a) lëshimin e certifikatës së përdorimit të objektit, që vërteton përfundimin e punimeve në përputhje me kushtet e lejes së ndërtimit, ose të deklaratës paraprake për kryerje punimesh, si dhe zbatimin e kriterëve të dokumenteve të planifikimit e të kontrollit të zhvillimit;

b) për lëshimin e aktit të konstatimit të mospërputhshmërisë, në rastet kur konstatohet mospërputhje e punimeve të kryera, i cili jep sugjerimet dhe afatin kohor dhe, nëse afati kohor nuk respektohet, sanksionet për sigurimin e përpunshmërisë nga zhvilluesi".

DPKZHT në Bashkinë Shkodër nuk ka respektuar afatet e përcaktuara në kuadrin ligjor për shqyrtimin e kërkesave të subjekteve aplikuese për pajisjen me leje ndërtimi, duke shfaqur neglizhencë në funksionimin e tyre nga ana e strukturave përkatëse në bashkinë Shkodër.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të miratimit të certifikatës së përdorimit për vitin 2021 dhe 2022, janë konstatuar miratime që nuk janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, pasi ka mungesa në dokumentacionin e vendosur në dispozicion si më poshtë vijon:

1. Njoftim fillim punimesh:

- Leje Nr. 3194 prot., "Objekt polifunksional, 2 kat shërbime+1kat banim+1 kat papafingo", investitor A.H., Sipërmarrës: V... C... 2016,
- Zhvilluesi "C... C..." SHPK, për objektin "Godinë banimi dhe shërbime 1 dhe 7 kat me 1 kat parkim nëntokë", ka kryer aplikimin për lëshimin e certifikatës së përdorimit, nr. 24597 prot.,
- Leje nr. 5201 prot., objekt "Banesë 2 kate" nga subjekti "K... SHPK", zhvilluesi A.C.;
- Leje nr. 3194 prot., datë 23.02.2021 "Objekt polifunksional, 2 kat shërbime+1kat banim+1 kat papafingo", investitor A.H., Sipërmarrës: V... C... 2016,
- Leje nr.458, datë 01.11.2019, për objektin "Banesë individuale 2 kat dhe parkim" ndërtuar nga "subjekti zbatues "B... K...", zhvillues Z.V.

2. Vërtetim mbi lidhjet e objektit me infrastrukturën inxhinierike ujësjellës-kanalizime, rezulton se janë ngarkuar libreza nga OSHEE, por nuk është e mundur të verifikohet se kjo kontratë vijon të jetë aktive për lejet si më poshtë:

- Leje nr. 3194 prot., datë 23.02.2021 "Objekt polifunksional, 2 kat shërbime+1kat banim+1 kat papafingo", investitor A.H., Sipërmarrës: V... C...,
- Leje nr.458, datë 01.11.2019, për objektin "Banesë individuale 2 kat dhe parkim" ndërtuar nga "subjekti zbatues "B... K...", zhvillues Z.V.

3. Mungon licenca e zhvilluesit që ushtron veprimtari ndërtuese zbatimi

- Zhvilluesi, Shoqëria “M...” SHPK dhe “S...” SHPK, nr. 5720 prot., për objektin “*Godinë banimi e shërbimi, 1 dhe 6 kate + podrum*”, mungon licencë e shoqërisë “M...” SHPK,
- 4. Deklarata e përputhshmërisë nga subjekti që ka kryer punimet me normat dhe standardet e sigurisë në fuqi, e lëshuar nga subjekti që ka kryer punimet, referuar VKM Nr. 408, datë 13.05.2015, mungojnë deklaratat e përputhshmërisë në dosjet e shqyrtuara si më poshtë:
 - Leje nr. 5201 prot., objekt “*Banesë 2 kate*” nga subjekti “K... SHPK”, zhvilluesi A.C.; në listën përmbledhëse të dokumenteve të ngarkuara elektronikisht, vihet re se një dokument i emërtuar “*deklarata e përputhshmërisë*” është ngarkuar në sistem por nuk gjendet në dosje.

Mungesa e dokumentacionit është në kundërshtim me përcaktimet e VKM Nr. 408 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 27, pika 7; neni 27/1 - Mbikëqyrja e punimeve dhe neni 27/2- Mbikëqyrja e punimeve, Dokumentet për pajisjen me certifikatë përdorimi.

DPKZHT në Bashkinë Shkodër ka miratuar certifikata përdorimi edhe në rastet kur dokumentacioni nuk është i plotë, që ndikon në mosdhënien e sigurisë së plotë se, objekti është ndërtuar sipas kriterëve ligjore, duke cenuar standardet e zhvillimit të kontrolluar të territorit si dhe sigurisë së ndërtimit, për neglizhencë të nëpunësve të strukturave përkatëse të bashkisë Shkodër.

2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV)

Struktura e IMTV ka mungesa të punonjësve të kualifikuar për kryerjen me cilësi të inspektimit në fushën e mbrojtjes së territorit (ndërtimit), me pasoja mangësi në llogaritjen e vlerës së gjobës, si dhe nuk raporton periodikisht çdo tre muaj në IKMT.

Struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të Bashkisë Shkodër, e cila vepron në bazë të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*” të ndryshuar, për vitin 2021 është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak (VKB) nr. 2 datë 05.01.2021, i ndryshuar “*Për miratimin e strukturës të nëpunësve dhe punonjësve të administratës dhe të institucioneve në varësi të Bashkisë Shkodër*”, dhe për vitin 2022 është miratuar me VKB nr. 01 datë 05.01.2022, i ndryshuar.

Struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit 2021-2022.

Nr.	Funksioni sipas Strukturës	Emër Mbiemër	Arsimi	Data e Fillimit	Data e Largimit
1	Kryeinspektor	G.I.	MSC Juridik	07.10.2016	
2	Specialist	T.Sh.	MSC Juridik	21.08.2015	
3	Specialist	Xh.M.	MP Juridik	03.01.2008	
4	Specialist	E.K.	Bachelor Juridik	28.04.2017	
5	Specialist	P.V.	Bachelor Juridik	03.08.2021	
6	Inspektor	E.V.	MSC Inxhinieri Mjedisi	26.12.2017	
7	Inspektor	M.N.	MSC Gjeologji miniera	14.09.2016	
8	Inspektor	K.V.	MSC Juridik	07.04.2021	
9	Inspektor	D.L.	Bachelor Juridik	02.08.2021	
10	Ndihmës inspektor	A.Z.	MSC Akademi rendit publik	07.06.2017	
11	Ndihmës inspektor	B.S.	I mesëm prof ndertim	14.09.2016	
12	Ndihmës inspektor	A.P.	I mesëm i përgjithshëm	26.10.2016	
13	Ndihmës inspektor	M.H.	I mesëm profesional	21.08.2015	
14	Ndihmës inspektor	A.P.	I mesëm profesional	12.04.2021	
15	Ndihmës inspektor	B.Z.	Bachelor menaxhim biznesi	02.08.2021	01.07.2022
16	Ndihmës inspektor	O.Gj.	I mesëm i përgjithshëm	04.07.2022	
17	Ndihmës inspektor	A.D.	I mesëm profesional	02.08.2021	

Burimi: Të dhëna të Bashkisë Shkodër

Sipas të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe IMTV rezultojnë se në strukturë janë 17 punonjës, nga të cilët 1 Kryeinspektor, 4 specialistë, 4 inspektor dhe 8 ndihmës inspektorë. Arsimimi i kryeinspektorit dhe inspektorëve është në përputhje me

kërkesat e ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007, i ndryshuar, por mungojnë punonjës me arsim të lartë të nevojshëm profesional në fushat e inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, hidrogeologjisë referuar përcaktimeve të këtij ligji në nenin 11. Sipas këtij neni: *“Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.”*

Nga tabela e mësipërme konstatohet se vetëm njëri prej zyrtarëve të kësaj strukture është me arsim të mesëm profesional ndërtimi, dhe janë kryesisht të fushës juridike dhe me arsim të mesëm 8 prej tyre. Mungesa e punonjësve me arsim të lartë të nevojshëm sipas kriterëve ligjore, është bërë pengesë në vendosjen e masave administrative në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 107/2014, *“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”*, i ndryshuar, neni 52, *“Kundërvajtje administrative”*, pika 1/e dhe “ë”, në të cilën përcaktohet: *“kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500 000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera; ë) kryerja e ndryshimeve në projekt apo e punimeve në shkelje të kushteve të lejes”*, si dhe pika 2 e po këtij neni: *“Vlera e punimeve të kryera pa leje, sipas pikës 1, shkronjat “e” dhe “ë”, të këtij neni, llogaritet sipas kostos mesatare të ndërtimit, të përcaktuar me udhëzim të Këshillit të Ministrave.”*

Kjo pasi është konstatuar se, në asnjë rast nuk është dokumentuar në se vlera e masës administrative është e barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, sipas përcaktimeve ligjore, kjo me qëllim maksimizimin e të ardhurave nga vjelja e gjobave dhe mbrojtjen e territorit. Megjithëse rezulton se ka pasur një numër të konsiderueshëm korrespondencash shkresore midis IMT-së dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për të pasur në përbërje të strukturës specialist preventivues në fushën e ndërtimit, nuk është ndërmarrë asnjë procedurë konkrete në periudhën 2021 - 2022.

Gjithashtu, nga auditimi është konstatuar se, ka mungesa në përgatitjen dhe raportimin e të dhënave statistikore tek Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) çdo tre muaj për vitin 2021 – 2022, e provuar kjo me dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion. IMTV nuk ka vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 i ndryshuar, neni 5, germa “f” ku cilësohet se IMTV: *“përgatit dhe i jep të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, sipas shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, të këtij neni.”*

Në tabelën e mëposhtme është listuar informacioni i përcjell nga IMTV Bashkia Shkodër drejtuar IKMT-së:

Informacioni i përcjell	Data e dërgimit të informacionit për IKMT
Të dhëna statistikore për vitin 2021	04.02.2022
Të dhëna statistikore për vitin 2022	16.01.2023
Të dhëna statistikore për periudhën janar- qershor 2021	09.07.2021

Një situatë e tillë e mungesës së rekrutimit të punonjësve të kualifikuar është si rezultat i mungesës së vlerësimit nga ana e Bashkisë Shkodër, si dhe neglizhencë e IMTV për raportim tek IKMT.

IMTV nuk ka mbuluar me kontroll të gjitha lejet e miratuara, si dhe ka mungesë bashkëveprimi midis strukturave vendore të mbrojtjes së territorit dhe atyre të planifikimit, kontrollit dhe zhvillimit të territorit.

Për periudhën objekt auditimi, është evidentuar se ka mungesë bashkëveprimi midis strukturave vendore të kontrollit dhe mbrojtjes së territorit, IMTV dhe Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (DPKZHT). IMTV nuk ka kryer kontrole të mjaftueshme mbi zbatimin e punimeve në objektet e lejeve ndërtimi për të kontrolluar nëse objekti po ndërtohet në përputhje me kërkesat e lejes së ndërtimit e të projektit teknik. Nga shqyrtimi i akteve të kontrollit të miratuara të IMTV nga kryeinspektori për kontrollet e ushtruara në objektet e pajisura me leje ndërtimi, rezulton se nuk janë kryer akte kontrolli për

të gjithë lejet e ndërtimit të miratuar për periudhën 2021-2022. Nga 34 leje të miratuara nga DPKZHT në vitin 2021 janë kryer vetëm 7 akt kontrolli dhe 2 raste të evidentuara me gjobë. Në vitin 2022, nga 35 leje të miratuara janë kryer 29 akte kontrolli për leje të lëshuara në këtë periudhë, dhe në 1 objekt janë kryer 2 akt kontrolli brenda vitin 2022.

Një veprim i tillë është në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, i ndryshuar neni 12, pika 10, në të cilin përcaktohet: “...krahas verifikimit në vend të situatës ndërtimore, të inspektojnë, të kërkojnë dhe të kryejnë të gjitha verifikimet e nevojshme pranë autoritetit përkatës të planifikimit, të cilët janë të detyruar të krijojnë të gjitha lehtësitë për verifikimin e dokumentacionit të nevojshëm, si dhe të japin të gjitha shpjegimet përkatëse dhe çdo dokumentacion të kërkuar. Në rast se në përfundim të inspektimit, sipas kësaj pike, konstatohen shkelje, kryeinspektori/ inspektorët e IKMT-së marrin masat përkatëse të parashikuara në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

IMTV nuk ka hartuar në mënyrë periodike planet mujore të punës, si dhe nuk ka ezauruar të gjitha procedurat për të marrë masat e nevojshme për ndëshkimin e kundërvajtësve sipas përcaktimeve ligjore.

Referuar dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion rezulton se mungon programi mujor për muajin shkurt si dhe mungon plani vjetor për vitin 2022, në kundërshtim me përcaktimet e Rregullores së brendshme “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shkodër” e miratuar me Vendim nr. 96, datë 20.03.2017, pika 1, nën-pika b/ii , ku cilësohet se, kryeinspektori harton planin vjetor e mujor, si dhe kryen dërgimin e tyre për informacion në strukturat përgjegjëse për harmonizimin e inspektimit.

Veprimtaria e IMTV për vitin 2021 dhe vitin 2022.

Nr.	Lloji i aktit	2021	2022
1	PV/Akte kontrolli	7	29
2	PV/Akte konstatimi	111	85
3	Vendime gjobe	71	46
4	Vendime pezullimi	96	81
5	Vendime prishje	87	73
6	PV ekzekutimi të prishjeve	2	1
7	Kallëzime penale	76	64
8	Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv	35	31
8.1	Vendime për titull ekzekutiv nga gjykata	33	31
8.2	Ekzekutim i vendimit për titull ekzekutiv nga përmbartuesi	0	0
9	Informacion periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT	0	0
10	Plane vjetore të punës të miratuara nga k/inspektori	1	0
11	Plane mujore të punës të miratuara nga k/inspektori	12	11

Burimi: Të dhëna të Bashkisë Shkodër

Bazuar në informacionin e përcjellë nga struktura e IMTV, për vitin 2021 rezultoi se janë mbajtur 7 proces verbale akte kontrolli, 111 procesverbale konstatimi të ndërtimeve pa leje, 96 vendime pezullimi të punimeve, 87 vendime për prishje të ndërtimit të paligjshëm, si dhe në asnjë rast nuk ka patur kërkesë për heqje licence profesionale personale dhe profesionale të shoqërisë. Ndërsa për vitin 2022 rezultoi se janë mbajtur: 29 proces verbale akte kontrolli, 85 procesverbale konstatimi për ndërtimeve pa leje, 81 vendime pezullimi të punimeve, 73 vendime për prishje të ndërtimit të paligjshëm, dhe asnjë kërkesë për heqje licence profesionale personale dhe licence profesionale të shoqërisë. Nga 87 vendime prishje në vitin 2021, rezulton se janë ekzekutuar 2 vendime si dhe në vitin 2022 janë marrë 73 vendim për prishje nga të cilat është ekzekutuar 1 vendim, kjo si pasojë e mungesës së mjetit.

Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore Shkodër nuk ka ezauruar të gjitha masat në rastin e konstatimit të shkeljeve ligjore, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, i ndryshuar, neni 5, germa “c” e cila përcakton: “paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale,

personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të ndërtimit;”

IMTV ka ekzekutuar vetëm 3 vendime për prishjen e objekteve pa leje për periudhën 2021-2022, në mungesë të makinerive për prishjen e këtyre objekteve. Bazuar në korespondencën e IMTV Bashkia Shkodër me Drejtorinë Rajonale të IKMT, i ka kërkuar mbështetje në mënyrë të përsëritur, për ekzekutimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje, kërkesë të cilës IKMT, ka shprehur pamundësinë për të ardhur në ndihmë me mjete. Nga 87 vendime për prishje të marra në vitin 2021, janë ekzekutuar 2 vendime dhe nga 73 vendime për prishje të objekteve të ndërtuara pa leje është ekzekutuar 1 vendim.

Mos ndjekja e të gjitha procedurave për ndëshkimin e kundërvajtjeve ndikon parandalimin e ndërtimeve jo të ligjshme si dhe në zhvillimin e kontrolluar të territorit, duke shfaqur neglizhencë nga ana e Bashkisë Shkodër.

Masat administrative të vendosura nga struktura e IMTV për shkeljet e konstatuar kanë nivel të ulët arkëtimi.

Sipas të dhënave nga Drejtoria e të Ardhurave mbi realizimin e të ardhurave të Bashkisë Shkodër, duke ju referuar vendosjes dhe arkëtimin të gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit (IMTV), krahasuar me të dhënat dhe IMTV, për periudhën 2021 – 2022, rezulton një nivel shumë i ulët i arkëtimin të tyre.

Të dhëna mbi gjobat e vendosura nga IMT dhe të arkëtuara 2021 – 2022

Nr.	Viti	Nr. Subjek.	Vlera e Gjobës	Arkëtuar				Debitor	% Realizim
				Gjoba	Kamat vonesa	Totali	Nr Pers		
1	2021	75	123,150,000	3,062,000	30,000	3,092,000	33	120,058,000	2,5%
2	2022	46	121,824,000	1,550,000	180,000	1,730,000	14	120,094,000	1,4%
Shuma		121	244,974,000	4,612,000	210,000	4,822,000	47	240,152,000	2.0%

Burimi: Të dhëna të Bashkisë Shkodër

Nga analizimi i të dhënave të IMTV-së dhe të Drejtorisë së të Ardhurave, në vitin 2021 janë vendosur 75 gjoba, gjithsej në vlerën 123,150 mijë lekë dhe janë arkëtuar 3,092 mijë lekë ose 2.5 %, ndërsa në vitin 2022, janë vendosur 46 gjoba dhe janë arkëtuar 1.27% e vlerës së gjobës, pra 1,730 mijë lekë.

Nga sa më sipër rezulton se në vitin 2022 ka një përgjysmim të numrit të gjobave, ndonëse në vlerë janë të përafërta me ato të vitit 2021 nga IMTV për shkeljet e konstatuar, dhe po në të njëjtën linjë rezulton dhe niveli i përgjysmuar i arkëtimeve.

Bazuar në këto të dhëna, rezulton se vlera e gjobave të pa paguara për periudhën 2021-2022 është 240,152 mijë lekë, duke sjellë të ardhura të munguara të paplanifikuara për buxhetin e Bashkisë Shkodër, në këtë vlerë.

IMTV për të realizuar vjeljen e gjobave, ka nisur me vonesë procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ, duke ju drejtuar Gjykatës Administrative për kthimin e aktit të gjobave në titull ekzekutiv për 35 gjoba në 2021 dhe 31 gjoba në 2022. Pas marrjes së titullit ekzekutiv, për ekzekutimin e kundërvajtjes administrative, bazuar në nenet 9, 22, 30 të Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2021, “Për kundërvajtjet administrative” i ndryshuar, IMTV i është drejtuar strukturave të ekzekutimit me forcë të detyrimit, shërbimit përmbarimor, pasi nuk ka në përbërje të saj struktura të ekzekutimit.

Megjithëse shërbimi përmbarimor nuk ka ekzekutuar asnjë titull ekzekutiv për periudhën 2021 - 2022, strukturat e bashkisë nuk kanë kryer veprime të mëtejshme për të përshpejtuar arkëtimin e gjobave të vendosura, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, i ndryshuar neni 31, pika 5: “Kur gjoba dhe detyrimet e tjera të parashikuara në vendimin për kundërvajtjen administrative nuk paguhen ose nuk nxirren dot nga paga, ato nxirren duke vënë sekuestro mbi pasurinë e të dënuarit për kundërvajtje administrative, qoftë edhe sikur ajo të ndodhet në dorën e personave të tjerë.”

Duhet theksuar se, krahas të ardhurave të munguara për bashkinë, mungesa e marrjes së masave për arkëtimin e gjobave të vendosura në mbrojtje të territorit, ulë efektivitetin e zbatimit të ligjeve dhe të veprimtarisë së IMTV të bashkisë, duke shfaqur neglizhencë nga ana e Bashkisë Shkodër në këtë drejtim.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetja nga auditimi:

- Nga Bashkia Shkodër nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit (afat 5 vjeçar), sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.

- Nuk janë përcaktuar qartë proceset e punës apo mënyra e analizimit të riskut ku të përcaktohen hapat konkret në eliminimin e plotë të tij, apo përditësimit referuar Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK- së dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

- Konstatohet se nuk janë dokumentuar takimet periodike (1 herë në dy muaj) të Koordinatorit të Riskut me drejtorët e drejtorive përkatëse të institucionit.

- Në Bashkinë Shkodër mungojnë e rregullat e shkruara në lidhje me procedurën që ndiqet për lëvizjet e stafit dhe mungesa e pasqyrimin të këtyre ndryshimeve si risqe në regjistrin e riskut të institucionit.

Nga auditimi konstatohen raste të mangësive apo mbivendosjes së detyrave përkatëse sipas pozicioneve të punës në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Shkodër.

- Me krijimin e Drejtorisë së Administrimit të Sistemeve, Menaxhimit të ZIN, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit (e cila ishte më parë në nivel sektori) nuk rezultojnë të jetë përditësuar Rregullorja e Brendshme për të pasqyruar ndryshimin përkatës. Gjithashtu, referuar veprimtarisë së GMS, në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisioneve e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë.

Sa më lart referuar nenit 20 të Ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit, ku përfshihet edhe struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrës, hierarkisë dhe rregullave të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 17-20, të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër të marrë masa për (i) hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut ku të identifikohen, analizohen, vlerësohen risqet që mund të ndikojnë në aktivitetin dhe përmbushjen e objektivave të institucionit, (ii) rishikimin periodik dy herë në vit të Regjistrin të Riskut (iii) si dhe të marrë masa për përditësimin e Rregullores së Brendshme, në përputhje me strukturën organizative, duke paraqitur në mënyrë të plotë e të saktë detyrat specifike të punonjësve, duke bërë edhe përditësime të vijueshme në rastet e ndryshimit të strukturës.

Në vijimësi

2. Gjetja nga auditimi: Nga krahasimi i vlerave të tavaneve buxhetore të miratuara me VKB nr. 19, datë 25.03.2021 dhe vlerave të parashikuara për vitin 2022 në PBA 2022-2024 miratuar me VKB nr. 3, datë 05.01.2022, rezultojnë diferenca me tavanet në vlerën totale prej 265,205 mijë lekë për 18 Programe buxhetore në kundërshtim me përcaktimet e pikës 126 të Udhëzimit të MF nr. 23, datë 22.01.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; pikën 20 të Udhëzimit nr. 8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-38, të Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtorja e Analizës dhe e Programimit Buxhetor në bashkëpunim me Ekipet e Menaxhimit të Programeve të marrin masa për planifikimin e shpenzimeve të programeve të PBA brenda tavaneve të miratuara paraprakisht dhe në raste të veçanta të

tejkalimit të tyre për shkak të kërkesave buxhetore shtesë që mund të vijnë si rezultat i arsyeve të qenësishme, të analizohet e dokumentohet arsyetimi përkatës.

Në vijimësi

3. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se gjatë vitit 2022, në sistemin e thesarit, janë shlyer përtej afatit 30 ditor në total 79 fatura me vlerë 173,341,439 lekë. Nga kjo vlerë rezulton se 130,033,614 lekë (ose 75% e vlerës së të gjithë faturave të paguara me vonesë) janë për llogari të investimeve të trupëzuara dhe pa trupëzuara (230 dhe 231), ndërsa pjesa tjetër prej 37,307,825 lekë (ose 25%) janë paguar për llogaritë 602. Pra, me fondet buxhetore të vitit 2022, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale, ku janë paguar 46 fatura të lëshuara në vitin 2020 dhe 2021, me vlerë 120,442,889 lekë.

Referuar Raportit të Monitorimit të Buxhetit të përgatitur nga Bashkia Shkodër e të dërguar pranë MFE stoku i detyrimeve të prapambetura më datë 31.12.2022 paraqitet në vlerën 571,032 lekë në sistemin SIFQ, të klasifikuara si shpenzime korrente, në proces gjyqësor dhe duke mos pasqyruar detyrime të prapambetura për shpenzimet kapitale.

Nga analiza e të dhënave të faturave të paguara përmes Thesarit dhe sistemit SIFQ, rezulton se për shpenzime kapitale (investime) gjatë vitit 2022 ka minimalisht 121,800,310 lekë detyrime të prapambetura (të pashlyera në kohë, të cilat përfaqësojnë faturime të vitit 2021 dhe vitit 2022, të papaguara deri në Dhjetor 2022). Këto detyrime duke u shtuar së bashku me detyrimet e prapambetura të tipit shpenzime korrente (deklaruar nga Bashkia Shkodër në Raportin në fjalë), arrijnë vlerën totale prej minimalisht 122,371,342 lekë. Statusi i gjendjes financiare nga Bashkia Shkodër është përlllogaritur sipas raportit Stoku i Detyrimeve/Shpenzime totale të miratuara të NJVQV, duke rezultuar në vlerën 0.02%. Statusi financiar i njëjësive të vetëqeverisjes vendore llogaritet sipas neneve 55, 56, 57, 58, 59 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si përqindjen e detyrimeve të papaguara ndaj të tretëve, mbi shpenzimet vjetore të miratuara. Nga përlllogaritjet e grupit të auditimit, raporti i cili vlerëson gjendjen financiare do të paraqitet në vlerën 3.82%, edhe pse nuk e ndryshon statusin e gjendjes financiare të Bashkisë Shkodër e cila paraqitet si “pa probleme financiare”, megjithatë mund të ndryshojë renditjen e saj në listën e bashkive sipas statusit. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-38, të Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Bashkia Shkodër të marrë masa për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura në raportimet periodike në MFE, me qëllim pasqyrimin e saktë të vlerës së detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

4. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se referuar të dhënave të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës dhe Drejtorisë së të Ardhurave, rezulton se në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër kryejnë aktivitet të tregtimit të karburantit gjithsej 43 subjekte. Nga këto, për vitin 2022 kanë licencë aktive për tregtimin e karburanteve 15 subjekte që operojnë në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër, ku vetëm gjatë vitit 2022 janë lëshuar 6 licenca të reja. Pjesa e mbetur prej 28 subjektësh, nuk kanë licencë aktive për tregtim, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, Kreu II, pika 1, germa b.

Nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës në 30.03.2022 dhe 24.16.2022 janë dërguar njoftimet drejt subjekteve të palicencuara për t’u paraqitur pranë zyrave të Bashkisë Shkodër për të aplikuar për pajisjen me licencën e tregtimit me pakicë të karburanteve, dhe për dijeni edhe drejt Inspektoriatit Shtetëror Teknik Industrial. Gjithashtu, u janë dërguar shkresa Policisë Bashkiake dhe Drejtorisë së të Ardhurave në Bashkinë Shkodër, lidhur me ndjekjen e rrugëve ligjore deri në pajisjen me licencë të 28 subjekteve të cilët nuk janë paraqitur pranë Bashkisë Shkodër edhe pas njoftimit të tyre. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-38, të Raportit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial të marrin masa për pajisjen me licencën përkatëse të subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e tregimit të naftës në kushtet kur ato plotësojnë specifikimet teknike, dhe mbylljen

e aktivitetit në rastet e kundërta, me qëllim ofrimin e sigurisë potenciale për pika të licencuara që përmbushin kriteret e sigurisë për tregtimin e karburanteve.

Në vijimësi

5. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se lidhur me mënyrën e aplikimit të taksës së ndërtesës, referuar Paketës Fiskale në fuqi përgjatë vitit 2022 (miratuar me VKB nr. 25, datë 20.12.2019, “Për taksat dhe tarifatat në Bashkinë Shkodër”, përditësuar me Vendimin nr. 02, datë 05.01.2022), rezulton se për përllogaritjen e saktë të saj mungojnë të dhënat dhe hartat për sipërfaqet nga ASHK. Në mungesë të këtyre të dhënave, është vendosur një sipërfaqe standarde prej 100 m² mbi të cilën janë aplikuar tarifatat (çmim/m²) për familjet. Një përllogaritje e tillë favorizon disa familje dhe penalizon familje të tjerë, pasi në varësi të llojit dhe vitit të ndërtimit, sipërfaqja mund të jetë më e vogël apo më e madhe, sidomos për ndërtimet të cilat nuk janë identifikuar saktë, duke ndikuar rrjedhimisht në saktësinë e përllogaritjes së këtyre të ardhurave që në planifikim e më pas në realizim. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në nenin 20, pika 2 dhe nenin 22, pika 1 e po këtij ligji. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-38, të Raportit të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me drejtoritë e tjera përkatëse në Bashkinë Shkodër dhe me institucione si Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të marrë masa për saktësimin e të dhënave lidhur me sipërfaqet e pronësisë së ndërtesave (objekt banimi dhe të tjera), me qëllim përllogaritjen e saktë të taksës së ndërtesës që në fazën e planifikimit e më pas të realizimit.

Në vijimësi

6. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se Zëri “Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore” paraqitet me një mosrealizim prej 15,510 mijë lekë (realizuar vetëm 6,226 mijë lekë nga planifikimi prej 21,736 mijë lekë), ose me realizim 29%. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për tokën bujqësore nga Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP, për vitin 2022 rezulton se në territorin e Bashkisë Shkodër dhe NJA të saj, janë gjithsej 16,043 Ha tokë bujqësore e boniteteve të ndryshme, por vetëm 14,017 Ha rezultojnë me dokument (certifikatë) pronësie. Diferenca prej 2,026 Ha nuk rezulton të planifikohet si burim të ardhurash për shkak të mangësive/mosekzistencës së dokumenteve të pronësisë, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 dhe neni 24. Referuar planifikimit, rezulton se janë planifikuar të ardhura nga taksa bujqësore në nivelin prej 21,736,120 lekë, sipas të dhënave të Drejtorisë së të Ardhurave. Ndërkohë, për totalin e sipërfaqes së tokës bujqësore, do të duhej të ishin planifikuar 24,700,060 lekë. Mangësitë/mungesa e dokumentacionit të pronësisë së tokës bujqësore i ka shkaktuar Bashkisë Shkodër një vlerë të munguar në planifikim prej 2,963,940 mijë lekë. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-38, të Raportit të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me drejtoritë e tjera përkatëse në Bashkinë Shkodër dhe me institucione si Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të marrë masa për saktësimin e të dhënave lidhur me sipërfaqet e pronësisë së tokës bujqësore dhe pajisjen me certifikatë pronësie të individëve, me qëllim përllogaritjen e saktë të taksës së tokës bujqësore që në fazën e planifikimit e më pas të realizimit.

Në vijimësi

7. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se referuar të dhënave të Drejtorisë së të Ardhurave mbi kontratat familjare të lidhura me Ujësjetës Kanalizime SHA, rezulton se janë 45,086 kontrata të lidhura, ndërkohë paguajnë tarifa vendore 4,563 familje; pra në total janë 49,649 familje të taksuara. Ndërkohë, referuar të dhënave nga Gjendja Civile, në territorin e Bashkisë Shkodër dhe NJA të saj, rezultojnë 65,117 familje. Nga krahasimi i të dhënave, rezulton një diferencë prej 15,468 familje të pataksuara. Nga mungesa e të dhënave të sakta lidhur me familjet dhe individët banorë të territorit administrativ të Bashkisë Shkodër si dhe referuar mosidentifikimit dhe llogaritjes së detyrimit për disa nga taksat/tarifatat e parashikuara në Paketën Fiskale të përditësuar (taksë ndërtesë 29 lekë / 100 m², taksë truall 0.42 lekë/m², tarifë pastrim/gjelbërim/ndriçim 3450 + 600 + 1500 lekë/familje) për vitin 2022, përfaqësohet paraqitet një vlerë e paplanifikuar dhe rrjedhimisht e paarkëtuar prej 85,970 mijë lekë. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-38, të Raportit të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me drejtoritë e tjera përkatëse në Bashkinë Shkodër dhe me institucione të tjera, të marrë masa për saktësimin e të dhënave lidhur me familjet dhe individët e taksueshëm për taksat dhe tarifat vendore.

Në vijimësi

8. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 468 “*Debitorë të ndryshëm*” të pasqyrave financiare të Bashkisë Shkodër për vitin 2022, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Shkodër për arkëtim ndaj të tretëve, është në vlerën 1,699,833,317 lekë.

- Detyrimet mbi 5 vjet, nga viti 2006 deri 2018 janë në vlerën 837,388,471 lekë ose 49.3% të vlerës së debitorëve për vitin 2022 të cilat kanë plotësuar afatin 5 vjeçar të parashkrimit pasi nuk ka ndonjë dokumentacion nga Bashkia mbi fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese si ankimimi i detyrimit tatimor; kontrolli ose hetimi zyrtar nga administrata tatimore ose objekt i një çështjeje penale në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, Neni 100 “*Parashkrimi i së drejtës për fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese*” 1 dhe 2.

- Debitorë në vlerën prej 704,798,020 lekë janë gjoba nga IKMT, policia bashkiake dhe kamatvonesat ose 41.5 % të totalit viti 2022 të cilat nuk janë paraqitur në llogarinë 709 “*Kamatvonesat*” në kundërshtim me udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 5, llogaria 709 “*kamatvonesat*” sipas strukturës kamatvonesat dallohen më vete për sistemin tatimor dhe më vete për sistemin doganor. (*Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 38-39, të Raportit të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi:

- Bashkia Shkodër të iniciojë fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese si ankimimi i detyrimit tatimor; kontrolli ose hetimi zyrtar nga administrata tatimore ose objekt i një çështjeje penale për arkëtimin e detyrimeve që kanë të tretët ndaj Bashkisë dhe për ato detyrime cilat kanë plotësuar afatin 5 vjeçar dhe nuk ka dokumente mbi fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese të konsiderojë procedurat për parashkrimin e së drejtës për fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese.

- Drejtoria e Financës për vitin 2023 të marrin masat për pasqyrimin e kamatvonesave në llogarinë 709 “*Kamatvonesat*” sipas strukturës më vete për sistemin tatimor dhe më vete për sistemin doganor.

Në vijimësi

9. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit ka rezultuar se:

- Nuk ezaurohen plotësisht dhe në mënyrë të dokumentuar dhe të argumentuar alternativat në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë, në kundërshtim me nenin 76 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, si në rastin e procedurave së prokurimit me objekt “*Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë Shkodër*” viti 2021 dhe “*Blerje automjete*” viti 2021.

- Janë shfaqur mangësi në hartimin e kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, dhe informacion tjetër specifik i nevojshëm, në argumentimin teknik, të cilat kanë të bëjnë me harmonizimin e specifikimeve teknike të dokumenteve të tenderit dhe disponimit të fuqisë punëtore dhe makineri-pajisjeve nga ana e OE për realizimin e kontratës sipas specifikimeve teknike në rastin e tenderave me objekt: “*Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë Shkodër*” viti 2021; “*Blerje automjete*” viti 2021; “*Rikonstruksion i pjesshëm shkolla “Azem Hajdari” viti 2022; “Shërbime riparimi të akseve të rrugëve” viti 2022; “Mirëmbajtje rrugë e trotuare në qytet” viti 2022; “Blerje dru zjarri” viti 2022.*

- KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE në kushtet që nuk kanë përmbushur të gjitha kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 82 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar; si në rastin e procedurës së prokurimit me objekt: “*Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë Shkodër*” viti 2021; “*Blerje automjete*” viti 2021; “*Blerje dru zjarri*” viti 2021, OE i shpallur fitues nuk ka arritur të sigurojë strukturën e druve të zjarrit që të jenë sipas specifikimit të materialeve; me objekt “*Sistemin asfaltim rruga Qendër Mes – Kullaj faza III*”

2021; “Rikonstruksion i pjesshëm shkolla “Azem Hajdari” viti 2022. “Shërbime riparimi të akseve të rrugëve” viti 2022. “Mirëmbajtje rrugë e trotuare në qytet”, viti 2022.

- KVO, gjatë vlerësimit të ofertave nuk ka mbajtur në konsideratë garantimin e Autoritetit kontraktor në realizimin në afat dhe me cilësi të kontratës, mundësi pjesëmarrjeje të biznesit formal, përzgjedhjen e OE që plotëson të gjitha kërkesat e tenderit, dhe duke vlerësuar e trajtuar devijime të vogla, mangësitë që nuk prekin thelbin e ofertës, me qëllim rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike si në rastin e procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksion Rruga “Daniel Mozali” Loti II 2021; në procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e skemës ujitëse” 2021.

- Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje dru zjarri” viti 2021, dy OE pjesëmarrës të kualifikuar kanë paraqitur në ofertën e vet të njëjtën kontratë që ka paraqitur dhe KVO nuk ka vlerësuar nëse ky konstatim mund të shërbejë si tregues për ndërhyrje në ofertë nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues dhe për të vepruar sipas kërkesave të nenit 81, pika 1 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 të ndryshuar me përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave në të cilat është përfshirë ofertuesi. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4, faqe 39-85, të Raportit të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në përlllogaritjen e vlerësimit të kontratës, dokumentimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave.

Në vijimësi

10. Gjetja nga auditimi: Gjatë zbatimit (monitorimit) të kontratës me objekt “Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë Shkodër”, me nr.11392/9 prot., datë 08.11.2021 kanë rezultuar mangësi në dokumentimin e monitorimit të saj, pasi zyrtarët përgjegjës nuk kanë verifikuar në mënyrë të dokumentuar zbatimin e grafikëve të punimeve mujore për realizimin e proceseve të punës, si dhe nuk kanë raportuar çdo javë tek supervizori, informacion me shkrim, për ecurinë e realizimit të grafikut të punimeve. Njësia e monitorimit të shërbimeve publike/ Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe ndjekjes të investimeve të infrastrukturës nuk ka të dokumentuar grafikun e ndërhyrjeve gjatë gjithë vitit etj., në kundërshtim me Shtojcën 7 - Formulari i termave të referencës, pika 4-Monitorimi dhe raportimi i shërbimit të dokumenteve të tenderit. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4, faqe 39-85, të Raportit të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër të marrë të gjithë masat e nevojshme për plotësimin me dokumentacion dhe dokumentimin në vijimësi të monitorimit të zbatimit të kësaj kontrate për sasinë dhe cilësinë e shërbimit, përmes supervizorit, specialistëve dhe inspektorëve në terren, si dhe njësisë së monitorimit të shërbimeve publike.

Brenda 6 mujorit të parë 2024 dhe në vijimësi

11. Gjetja nga auditimi: Grupi i auditimit mori në shqyrtim zbatimin e kontratave për objekte civile (infrastrukturë rrugore) të filluara në vitin 2020 dhe të përfunduara në vitin 2021 dhe 2022, të cilat rezultojnë 86 copë gjithsej. Nga këto 24 kontrata ose 28 % e tyre nuk janë përfunduar në afat, por janë nënshkruar zgjatje të afateve të kontraktimit me marrëveshje midis kontraktorit, mbikëqyrësit dhe investitorit (Bashkia Shkodër).

Pavarësisht, zbatimit të kriterëve ligjore në shtyrjen e afatit të zbatimit të kontratave për punime civile (infrastrukturë rrugore) duhet mbajtur në konsideratë që, veprime të shpeshta të kësaj natyre, jo vetëm që vonojnë procesin e zhvillimit të zonave përkatëse, por nga ana e tjetër cenojnë dhe procedurën e prokurimit të zhvilluar, lidhur me përcaktimin e afatit të zbatimit të kontratës.

Nga shqyrtimi i zbatimit të afateve kontraktuale në dy kontrata të punimeve civile: “Rikonstruksioni i bllokut të pallateve “Mehmet Pashë Plaku” (përballë shkollës “Ali Laçej)” dhe “Sistemim asfaltim segmente rrugësh Rilindja - Demokracia-Hotit në Hot të Ri” në vitin 2021 rezulton se ndërprerja dhe shtyrja e afatit të punimeve nuk është e bazuar në dokumentimin e kushteve atmosferike, sipas ditarit të punimeve dhe as në rastin e forcave madhore apo në interesin publik, siç përcaktohet në kushtet kontraktore. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4, faqe 39-85, të Raportit të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër, të marrë të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e procedurave të prokurim publik të cilat përkojnë me kohë të përshtatshme me objektin e prokurimit, si dhe të argumentojë teknikisht afatin real të zbatimit të kontratave në procedurën e prokurimit, për të vijuar më pas me dokumentimin e rrethanave objektive dhe të domosdoshme për ndërprerje dhe zgjatje të afatit të zbatimit të kontratave për punime civile, infrastrukturë rrugore.

Në vijimësi

12. Gjetja nga auditimi: Referuar sistemit elektronik të aplikimit në kuadër të lejeve ndërtimit, *e-Leje* dhe sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) në Bashkinë Shkodër, në vitin 2021 rezulton se janë miratuar 34 leje dhe për vitin 2022 janë miratuar 35 leje.

Në periudhën 2021-2022 rezulton se për ndërtimet objekte të rinj me sipërfaqe mbi 250 m² për vitin 2021 janë miratuar 7 leje dhe 15 leje në vitin 2022, ndërsa leje ndërtimi për objekt të ri me sipërfaqe deri në 250 m² janë miratuar 8 leje në vitin 2021 dhe 12 leje në vitin 2022.

Konstatohet se 1 (një) certifikatë përdorimi vijon të mbetet në proces gjatë vitit 2022, për arsye se zhvilluesi nuk ka kryer pagesën për taksa të një tjetër objekti, ndërkohë që nga DPKZHT i është miratuar marrja e certifikatës së përdorimit për objektin që zhvilluesi ka aplikuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e-leje dhe në databazën e vendosur në dispozicion nga drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit është konstatuar se lejet e ndërtimit të miratuara janë shqyrtuar me afate të tej zgjatuara ditësh pune duke mos respektuar afatin maksimal prej 60 ditësh pune për miratimin e 25 lejeve të ndërtimit, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 44, pika 2 të ligjit nr. 107/2014.

Gjithashtu, rezulton se Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Shkodër nuk është plotësuar me stafin e nevojshëm, gjë që ka ndikuar në funksionimin normal të kësaj Drejtorie. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.5, faqe 85-93, të Raportit të Auditimit).*

12.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme për plotësimin e strukturës organike të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, dhe në vijim të merren masa për shqyrtimin e kërkesave të lejeve të ndërtimit brenda afateve ligjore, në funksion të zhvillimit të territorit sipas kuadrit përkatës rregullator.

Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2024 dhe në vijimësi

13. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi dokumentacionit të paraqitur nga DPKZHT dhe të dhënat në sistemin *e-Leje*, si projekti arkitektonik, relacioni teknik i projektit të propozuar, plani i vendosjes së strukturave i miratuar, rezultojnë se, 5 leje ndërtimi nuk janë në përputhje me lartësinë e përcaktuar në Planin e Detajuar Vendor (PDV) të Bashkisë Shkodër, sipas nën njësisë mbi lartësinë e përcaktuar në Planin e Detajuar Vendor. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.5, faqe 85-93, të Raportit të Auditimit).*

13.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme për miratimin e lejeve të ndërtimit sipas përcaktimeve në njësitet strukturore të PDV, si dhe të kryejë përditësimin e këtij plani në përputhje me ndryshimet e aplikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor.

Në vijimësi

14. Gjetja nga auditimi: DPKZHT, ka vijuar praktikën e pranimit të deklaratës noteriale nga subjektet që kanë aplikuar për leje ndërtimi me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 m² për të siguruar kalimin pa shpërblim të paktën 3% të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm në favor të banesave sociale, duke anashkaluar kontratën që duhet të ishte nënshkruar midis palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të ndërtesave sociale.

Nga auditimi rezultojnë 6 leje ndërtimore me sipërfaqe mbi 2 000 m², për të cilat nga ana e DPKZHT janë pranuar deklarata noteriale, për të kaluar pa shpërblim 3% të sipërfaqes funksionale në favor të banesave sociale, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, i ndryshuar, neni 19, pika 1. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.5, faqe 85-93, të Raportit të Auditimit).*

14.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe nënshkrimin e kontratave përkatëse për të siguruar kalimin pa shpërblim të 3% të sipërfaqes

funkcionale në favor të banesave sociale, duke garantuar zbatimin rigoroz të ligjit, në shërbim të zbutjes problemeve sociale të strehimit.

Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2024 dhe në vijimësi

15. Gjetja nga auditimi: Referuar dokumentacionit të shqyrtuar për lejet e miratuara, ka rezultuar se objektet që janë pajisur me leje nga Bashkia Shkodër nuk shoqërohen me vërtetimin për riskun nga organi kompetent që lëshon lejen, bazuar në VKM nr. 1162, datë 24.12.2020, “*Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi*” gjë që ndikon në garantimin e qëndrueshmërisë dhe bazamentit ku do të mbështetet ndërtimi.

Gjithashtu, në sistemin e-Leje dhe nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga DPKZHT, rezulton se në 9 dosje mungon studimi me të dhëna inxhiniero-sizmologjike dhe gjeologjike, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 1162, datë 24.12.2020, “*Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi*”, pika 10.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës së ndjekur për miratimin e lejeve është konstatuar se nuk është kërkuar mendimi i të gjithë autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve për t’u siguruar se projekti, për të cilin kërkohet pajisja me leje nuk ndërhyt apo pengon zhvillimin, në respektimin e distancave nga linjat e tensionit të lartë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) për 7 raste, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 10/1 të Rregullores - Dokumentacioni për pajisjen me leje zhvillimi.

Projekti ndërtimor nuk është i plotë, pasi ka mangësi në dokumentacionin shoqëruar i konstatuar në 9 raste, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar si dhe të Ligjit nr. 10440, datë 07.07.2021, “*Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*”. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.5, faqe 85-93, të Raportit të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër, DPKZHT të marrë masat e nevojshme për plotësimin e dosjeve të lejeve me vërtetimin për riskun, si dhe për plotësimin me dokumentacionin studimor me të dhëna inxhiniero-sizmologjike dhe gjeologjike, të mendimeve të të gjithë autoriteteve, si dhe të projektit ndërtimor, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor përkatës.

Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2024

16. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se për vitin 2021 janë pajisur me certifikatë përdorimi 26 subjekte kurse për vitin 2022 janë miratuar certifikata përdorimi për 25 subjekte. Në sistemin e-leje dhe në databazën e vendosur në dispozicion nga drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit është konstatuar se 78,4 % e certifikatave të përdorimit të miratuara janë shqyrtuar me afate të tej zgjatua duke mos respektuar afatin maksimal prej 30 ditësh pune për miratimin e lejes së ndërtimit, në kundërshtim me përcaktimet e VKM Nr. 408 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 27, pika 7.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të miratimit të certifikatës, janë konstatuar mungesa në dokumentacionin e nevojshëm si: *njoftimi fillim punimesh në 5 raste, vërtetimi mbi lidhjet e objektit me infrastrukturën inxhinierike ujësjellës-kanalizime 2 raste, licenca e zhvilluesit që ushtron veprimtari ndërtuese zbatimi në një rast, deklarata e përputhshmërisë nga subjekti që ka kryer punimet me normat dhe standardet e sigurisë në fuqi në një rast etj.*, në kundërshtim me përcaktimet e VKM Nr. 408 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 27, pika 7; neni 27/1 “*Mbikëqyrja e punimeve*” dhe neni 27/2- “*Mbikëqyrja e punimeve*”, “*Dokumentet për pajisjen me certifikatë përdorimi*”. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.5, faqe 85-93, të Raportit të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër, struktura përkatëse të marrë masat e nevojshme për shqyrtimin e kërkesave për pajisje me certifikatë përdorimi sipas afateve të përcaktuara referuar kuadrit ligjor, si dhe pajisjen e tyre vetëm nëse dokumentacioni i sjellë nga subjekti është i plotë dhe në përputhje me kriteret ligjore.

Në vijimësi

17. Gjetja nga auditimi: Në strukturën e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit (IMTV) mungojnë punonjës me arsim të lartë të nevojshëm profesional në fushat e inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve,

hidrogeologjisë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 11 të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” të ndryshuar, duke sjellë për pasojë mangësi në llogaritjen e vlerës së gjobës si dhe nuk raportohet periodikisht çdo tre muaj në IKMT, kjo pasi, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion është konstatuar se vlera e gjobës nuk është llogaritur mbi bazën e vlerës së punimeve të kryera pa leje.

Gjithashtu, IMTV nuk ka përgatitur dhe raportuar të dhënat statistikore tek Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) çdo tre muaj, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, neni 5, germa “f”. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6, faqe 93-97, të Raportit të Auditimit).

17.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër të marrë masat e nevojshme për plotësimin e strukturës së IMTV me inspektorë me arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e inxhinierisë së ndërtimit, etj., për të rritur cilësinë kontrollit në territor, si dhe për vendosjen e masave administrative në përputhshmëri me vlerën e punimeve të kryera për shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative.

Gjithashtu, të merren masat e nevojshme për përgatitjen dhe raportimin e të dhënave statistikore çdo tre muaj mbi aktivitetin e IMTV pranë IKMT.

Brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2024 dhe në vijimësi

18. Gjetja nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, është evidentuar se ka mungesë bashkëveprimi midis strukturave vendore të kontrollit dhe mbrojtjes së territorit (IMTV) dhe Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (DPKZHT), duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” të ndryshuar neni 12, pika 10.

Gjithashtu, IMTV nuk ka kryer kontrole të mjaftueshme mbi zbatimin e punimeve në objektet me leje ndërtimi për të kontrolluar nëse objektet ndërtohen në përputhje me kërkesat e lejeve të ndërtimit e të projektit teknik. Nga shqyrtimi i akteve të kontrollit të miratuara të IMTV nga kryeinspektori për kontrollet e ushtruara në objektet e pajisura me leje ndërtimi, rezulton se nuk janë kryer akte kontrolli për të gjithë lejet e ndërtimit të miratuar për periudhën 2021-2022. Nga 34 leje të miratuara nga DPKZHT në vitin 2021 janë kryer vetëm 7 akt kontrolli dhe 2 raste të evidentuara me gjobë. Në vitin 2022, nga 35 leje të miratuara janë kryer 29 akte kontrolli për leje të lëshuara në këtë periudhë, dhe në 1 objekt janë kryer 2 akt kontrolli brenda vitin 2022. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6, faqe 93-97, të Raportit të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: IMTV të rrisë numrin e kontrolleve mbi lejet e miratuara, si dhe gjatë kësaj veprimtarie për mbrojtjen e territorit, të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë, duke kryer të gjitha verifikimet e nevojshme të dokumentacionit pranë DPKZHT, për të marrë shpjegimet përkatëse që ndihmojnë në saktësimin e shkeljeve dhe ndalimin e ndërhyrjeve të paligjshme në territor.

Në vijimësi

19. Gjetja nga auditimi: IMTV nuk ka hartuar programin mujor për muajin shkurt, si dhe planin vjetor 2022, në kundërshtim me përcaktimet e Rregullores së brendshme “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shkodër” e miratuar me Vendim nr. 96, datë 20.03.2017, pika 1, nënpika b/ii, ku cilësohet se, kryeinspektori harton planin vjetor e mujor, si dhe kryen dërgimin e tyre për informacion në strukturat përgjegjëse për harmonizimin e inspektimit.

IMTV për vitin 2021 rezultoi se ka mbajtur 7 proces verbale akte kontrolli, 111 procesverbale konstatimi të ndërtimeve pa leje, 96 vendime pezullimi të punimeve, 87 vendime për prishje të ndërtimit të paligjshëm, si dhe në asnjë rast nuk ka pasur kërkesë për heqje licence profesionale personale dhe profesionale të shoqërisë. Po ashtu, për vitin 2022 rezultoi se janë mbajtur: 29 proces verbale akte kontrolli, 85 procesverbale konstatimi për ndërtimeve pa leje, 81 vendime pezullimi të punimeve, 73 vendime për prishje të ndërtimit të paligjshëm, dhe asnjë kërkesë për heqje licence profesionale personale dhe licence profesionale të shoqërisë.

Nga 87 vendime prishje në vitin 2021, rezulton se janë ekzekutuar 2 vendime si dhe në vitin 2022 janë marrë 73 vendim për prishje nga të cilat është ekzekutuar 1 vendim, kjo si pasojë e mungesës së mjetit. Në këtë mënyrë, IMTV nuk ka ezauruar të gjitha masat në rastin e

konstatimit të shkeljeve ligjore, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” të ndryshuar, neni 5, germa “c”.

IMTV ka ekzekutuar vetëm 3 vendime për prishjen e objekteve pa leje për periudhën 2021-2022 nga 160 vendime gjithsej, për mungesë të makinerive për prishjen e këtyre objekteve, me gjithë kërkesat e vazhdueshme për mjete që i ka bërë IKMT, e cila është shprehur për pamundësinë për të ardhur në ndihmë me mjete. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6, faqe 93-97, të Raportit të Auditimit).

19.1 Rekomandimi: IMTV të marrë masa për hartimin e planeve vjetore dhe mujore të punës, si dhe të aplikohen të gjitha masat ndëshkuese ndaj kundërvajtësve, duke ndjekur të gjitha procedurat sipas parashikimeve ligjore për ekzekutimin e vendimeve të marra për prishjen e objekteve pa leje ndërtimi, duke thelluar bashkëpunimin me IMTV.

Në vijimësi

20. Gjetja nga auditimi: Sipas të dhënave nga Drejtoria e të Ardhurave mbi realizimin e të ardhurave të Bashkisë Shkodër, duke ju referuar vendosjes dhe arkëtimit të gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit (IMTV), krahasuar me të dhënat dhe IMTV, për periudhën 2021 – 2022, rezulton një nivel shumë i ulët i arkëtimit të tyre.

Kështu, janë vendosur gjoba në 121 subjekte gjithsej me vlerë gjithsej 244,974 mijë lekë dhe janë arkëtuar gjithsej 4,822 mijë lekë, përfshirë dhe kamatëvonesa 210 mijë lekë, ose janë arkëtuar gjithsej 2% e vlerës së gjobave gjithsej. Mos arkëtimi për pasojë, jo vetëm që ka sjellë mungesë të të ardhurave të paplanifikuar për buxhetin e Bashkisë Shkodër, por ka ulur ndjeshëm efektivitetin e zbatimit të ligjeve dhe të veprimtarisë së IMTV të bashkisë në drejtim të mbrojtjes së territorit.

Megjithëse shërbimi përmbarimor nuk ka ekzekutuar asnjë titull ekzekutiv për periudhën 2021 - 2022, strukturat e bashkisë nuk kanë kryer veprime të mëtejshme për të përshpejtuar arkëtimin e gjobave të vendosura, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” i ndryshuar neni 31, pika 5. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6, faqe 93-97, të Raportit të Auditimit).

20.1 Rekomandimi: IMTV të bashkëpunojë me Drejtorinë Juridike për të siguruar zbatimin e procedurës së mbledhjes me forcë të detyrimit për gjobat e vëna në bazë të akteve të kontrollit për bërë të mundur arkëtimin e gjobave me pasojë rritjen e të ardhurave të bashkisë dhe për të rritur efektivitetin e veprimtarisë së Inspektoratit në drejtim të mbrojtjes së territorit.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

1. Gjetja nga auditimi: Nga krahasimi i sipërfaqeve të gjelbër të inventarizuara në vitin 2021, sipas Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Shkodër nr. 266, datë 17.03.2021, konkretizuar me procesverbalin me nr.1048/6 prot., të datës 23.03.2021 në të cilin janë vlerësuar të gjitha sipërfaqet ekzistuese funksionale të gjelbërta në Shkodër, me të dhënat Raportit teknik të vitit 2018- rezultatet e inventarizimit të dala nga Urdhri i Kryetarit të Bashkisë Shkodër nr. 752, datë 06.10.2017 “Për inventarizimin e sipërfaqeve të gjelbërta dhe gjelbërimit rrugor”, rezulton një sipërfaqe prej 13,035 m² e cila në mars të vitit 2021 nuk është në eficiencë. Në këto kushte, pagesat e kryera kontraktorit “M...” SHPK sipas kontratës me nr. 6612/14 prot., datë 28.06.2018, për vitin e fundit të operimit të saj për sipërfaqen e gjelbëruar prej 13 035 m² e cila nuk rezulton në eficiencë për këtë vit, për shumën 3,327,988 lekë me TVSH konsiderohen dëm ekonomik.

- Duke i konsideruar mbjellje të reja 840 copë drurë dekorativë në lulishte dhe 515 drurë dekorativë të gjelbërimit rrugor Tipi 1 (0-5 m), rezulton se mbjelljet gjithsej në periudhën 2018 - 2021 janë 1 355 copë nga 1 381 copë të paguara, pra 26 copë më pak (1 381 - 1 355). Në këtë mënyrë kontraktorit “M...” SHPK ka përfituar padrejtësisht për shërbim të pakryera në mbjelljen e pemëve (26 x 10,710 lekë/copë=278,460 + TVSH 20%) për kontratën e periudhës 2018-2021 me nr.6612/14 prot., datë 28.06.2018, vlerën prej 334,152 lekë me TVSH, e cila përbën dëm ekonomik.

Në zbatimin e kontratës me nr.6612/14 prot., datë 28.06.2018, me objekt “Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë Shkodër”, kontraktori “M...” SHPK, ka përfituar padrejtësisht

3,662,140 lekë për shërbime të pakryera. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4, faqe 39-85, të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Shkodër të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej **3,662,140 lekë** të përfituar padrejtësisht nga kontraktori “M...” SHPK për shërbime të pakryera gjatë zbatimit të kontratës me nr.6612/14 prot., datë 28.06.2018, me objekt “Ofrimi i shërbimit të gjelbërimit në Bashkinë Shkodër”.

Brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2024

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2022, është kryer likuidimi për një vendim gjyqësor për largim të padrejtë nga puna, në vlerën 924,000 lekë si shpenzim për ekzekutim të vendimit gjyqësor dhe 110,880 lekë si tarifë përmbartimore fikse. Si rrjedhojë e vendimit gjyqësor për largim të padrejtë nga puna, pagesa prej 1,034,880 lekë (*shpenzime për ekzekutim të vendimit gjyqësor dhe tarifë përmbartimore fikse*), përbën shpenzim pa ekonomikitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2019 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” në pikën 60, si dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” në Kreun II, neni 8. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-38, të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër të marrë masa për analizimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore, si dhe të shmangë largimet e padrejta nga puna, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Në vijimësi

2. Gjetja nga auditimi: Bashkia Shkodër ka blerë për Drejtorinë Ekonomike të Arsimit automjetin me targë AB...ES, me 0 km dhe me normë të harxhimit të karburantit prej 7.8 litër për 100 km sipas specifikimeve teknike dhe ofertës së paraqitur, e konfirmuar nga komisioni i marrjes në dorëzim me procesverbalin e datës 13.10.2021.

Grupi i auditimit kërkoj të dhëna mbi km e përshkuara dhe konsumin e karburantit nga automjeti i Drejtorisë Ekonomike të Arsimit me targë AB...ES në vitin 2021 dhe 2022 dhe rezultojnë të konsumuara 3 800 litra karburant dhe 18 671 km të përshkuara me një normë mesatare konsumi prej 20.3 litra/100 km ose + 12.5 litra më shumë, me pasoja mungesë efektiviteti në përdorimin e fondeve publike në vlerën gjithsej prej 531,861 lekë. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4, faqe 39-85 të Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër të marrë të gjithë masat e nevojshme për verifikimin e automjeteve të blera për plotësimin e specifikimeve teknike lidhur me konsumin mesatar të karburantit, me qëllim administrimin dhe menaxhimin me efektivitet të shpenzimeve publike, duke e shtrirë një veprimtari të tillë dhe në automjetet aktuale në përdorim të bashkisë, lidhur me normat reale të konsumit të karburantit.

Në vijimësi

3. Gjetja nga auditimi:

- Në procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e skemës ujitëse”, me fond limit 6,106,616 lekë pa TVSH, i zhvilluar më datë 26.04.2021, në të cilën kanë marrë pjesë 4 OE, KVO ka skualifikuar në mënyrë të padrejtë OE “N...” SHPK me vlerën më të ulët, i cili ka përmbushur kërkesat e DT.

Kjo pasi, punonjësi me profesionin mekanik është me dëshmi dhe figuron në listë-pagesa; automjetet me targa KO...B dhe AB...AM janë për marrë me qira dhe paraqitur në ofertë me dokumentacionin përkatës shoqërues, si dhe inxhinieri plotëson kushtet për të qenë Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë, në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit. Veprimet dhe mosveprimet e KVO, duke skualifikuar padrejtësisht ofertën më të ulët

kanë sjellë për pasojë shpenzime pa efektivitet në realizimin e kësaj kontrate në vlerën 1,000,500 lekë.

- Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion Rruga “Daniel Mozali” Loti II”, me fond limit 7,811,219 lekë pa TVSH kanë marrë pjesë tre OE, nga të cilët dy janë skualifikuar. Skualifikimi i OE “D... I...” SHPK me ofertë më ulët për mungesë të vërtetimit për numrin mesatar të punonjësve për tre muajt e fundit, në një kohë që ka paraqitur listë-pagesat e dorëzuara në sigurimet shoqërore, si dhe mostrajtimin e mungesës së certifikatës së transportit si devijim të vogël që nuk prek thelbin e ofertës, ka sjellë për pasojë shpenzime pa efektivitet në realizimin e kësaj kontrate në vlerën 651,680 lekë. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4, faqe 39-85 të Raportit të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve të përfshirë në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim që gjatë vlerësimit të ofertave të mbajnë në konsideratë garantimin e Autoritetit kontraktor në realizimin në afat dhe me cilësi të kontratës.

Në vijimësi

D. TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2022, bazuar në të dhënat e sistemit të taksave dhe tarifave vendore, Policia Bashkiake ka vendosur 1,004 gjoba në vlerë totale 1,287 mijë lekë. Nga këto gjoba të vendosura, janë arkëtuar 645 mijë lekë, ose ndryshe 29% e tyre. Arkëtimet e gjobave të vendosura ndaj individë përfaqësojnë 17% të gjobave të vendosura ndaj tyre, ndërsa arkëtimet nga bizneset përfaqësojnë 45% të gjobave të tyre. Në këtë kuadër, paraqitet një nivel i ulët i arkëtimit të tyre, pra nuk janë marrë masa shteruese për arkëtimin e gjobave të papaguara. Mbështetur në nenin 13 të Ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar, pasi për shkeljet e vërejtura punonjësit e policisë së bashkisë duhej të gjobisnin personat përgjegjës dhe kundërvajtësit të paguajnë gjobën në referencë pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, si dhe Kreun IV.3.8 në Paketën Fiskale të Bashkisë Shkodër. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-38, të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtuesi i Policisë Bashkiake në bashkëpunim me Drejtorin e Drejtorisë së të Ardhurave të marrin masa shteruese duke ndjekur rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e gjobave të papaguara të Policisë Bashkiake.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga analizimi i të dhënave, konstatohet se gjatë vitit janë krijuar më shumë debitorë të rinj (në vlerë) sesa janë pakësuar, duke arritur të mblidhen më pak të ardhura dhe të gjenerohen detyrime nga ana e subjekteve biznese apo familje. Shtesa më e madhe e detyrimeve është nga familjarët, të cilët përbëjnë 55.25% të vlerës totale të debitorëve. Nga auditimi konstatohet se për vitin 2022 janë krijuar debitorë të rinj si biznese në vlerë 122,377 mijë lekë ndërsa progresivi i debitorëve biznese deri në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 759,818 mijë lekë. Sa i takon individëve/familjarëve rezulton se gjatë vitit 2022 janë krijuar debitorë të rinj në vlerën 178,946 mijë lekë dhe progresivi i debitorëve deri më 31.12.2022 paraqitet në vlerë 938,121 mijë lekë. Në total, debitorët deri në 31.12.2022 të të dyja kategorive (biznese dhe individë) paraqiten në vlerë totale 1,697,939 mijë lekë.

Nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave nuk janë marrë masa shteruese për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura ndër vite të debitorëve referuar Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 4, neni 34. neni 12 i Ligjit nr. 168/2017 “Për financiar e Vetëqeverisjes Vendore”. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-38, të Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave të marrë masa për të analizuar gjitha rastet e evidentuara për debitorët e të gjithë taksave dhe tarifave të analizuara përgjatë këtij Projekt Raport Auditimi (duke filluar nga taksa e ndërtesës e deri tek gjobat e IMTV) me qëllim marrjen e masave shteruese dhe ndjekjen e të gjithë rrugëve administrative dhe ligjore për arkëtimin e tyre si dhe shmangien e krijimit të debitorëve të rinj.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

1. Gj. P., Drejtor i Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, përgjegjësi i grupit të auditimit;
2. B. Z., Drejtor i Departamentit të Kontrollit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve të Auditimit;
3. Xh. N., audituese;
4. B. H., audituese.

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

K. GJ.

KONTROLLI I LARTË I SHETIT